

UNIVERSITETI I EJL

УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈИЕ

SEE UNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK

ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

LAW FACULTY

STUDIMET PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

DREJTIMI: E DREJTA KUSHTETUESE DHE ADMINISTRATIVE

TEZA:

**ASPEKTET KRAHASIMORE TË GJYQËSISË KUSHTETUESE TË
MAQEDONISË SË VERIUT, KOSOVËS DHE SHQIPËRISË ME
VËSHTRIM TË POSAÇËM NË MBROJTJEN E LIRIVE DHE TË
DREJTAVE TË NJERIUT**

Kandidati:
Nderim JASHARI

Mentori:
Prof. Dr. Jeton SHASIVARI

Shkup , Shtator 2020

Deklaratë

Unë, Nderim Xh. Jashari deklaroj me përgjegjësi morale dhe penale se punimi i tezës së magjistraturës me titull „**ASPEKTET KRAHASIMORE TË GJYQËSISË KUSHTETUESE TË MAQEDONISË SË VERIUT, KOSOVËS DHE SHQIPËRISË ME VËSHTRIM TË POSAÇËM NË MBROJTJEN E LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT**” është punim autentik i punuar nga unë dhe për të gjitha referencat dhe citimet nga interneti janë të shënuara me fusnota. Këtë punim mund të shfrytëzojë Universiteti i Evropës Jug-Lindore për qëllime studimi.

Nderim Jashari ID 128142

Falenderim

Punimin ia përkushtoj familjes sime, Gentit dhe Lorinës, bashkëshortes, nënës dhe Babait Xhemë që ka bërë përpjeke që nga vitet e 80-ta që ne të shkollohemi duke vuajtur burgjeve dhe luftoi vetëm e vetëm që të jemi të lirë.

Një faleminderim të veçantë mentorit të punimit Prof. Jeton Shasivari si dhe profesorit të nderuar Prof. Visar Morina, të gjithë kolegëve të grupit tonë si dhe profesorëve të Fakultetit Juridik të drejtimit: E drejta kushtetuese dhe administrative të UEJL-së.

PËRMBAJTIJA

Abstrakt.....	6
Abstract.....	7
Абстракт.....	8
Hyrje	9
Qëllimi i hulumtimit	10
Hipotezat	11
Metodologjia e hulumtimi	12
Rëndësia e hulumtimit	12

KAPITULLI I PARË

1.GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

1.1 Historiku dhe krijimi Gjykatës Kushtetuese.....	13
1.2 Pozita e Gjykatës Kushteuse	13
1.3 Përbërja dhe zgjedhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese - përparësitë dhe mangësitë	14
1.4. Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese, me theks në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit	15
1.5. Efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.....	18

KAPITULLI I DYTË

2. GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

2.1 Historiku , krijimi i Gjykatës Kushtetuese	27
2.2 Përbërja,organizimi dhe funksionimi i Gjykatës Kushtetuese.....	29
2.3 Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese me theks të veçant në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit	33
2.4 Kontrolli abstrakt i kushtetutëshmëris	33
2.5 Kontrolli kushtetues i projekt-amandamenteve kushtetuese	35
2.6 Konflikti për kompetencë	36

2.7 Kërkesa individuale dhe shkelja e Kushtetutës nga Presidentit i Republikës.....	37
---	----

KAPITULLI I TRETË

3. GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRIS

3.1 Historiku dhe krijimi i Gjykatës Kushtetuese.....	47
3.2 Përbërja dhe pozita e Gjykatës Kushtetuese	49
3.3 Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese, me theks në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit	51
3.4 Vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese	53
3.4.1 Vënia në lëvizje përmes autoriteteve publike	55
3.4.2 Vënia në lëvizje përmes gjykatave të zakonshme	57
3.4.3 Vënia në lëvizje përmes kërkesave individuale	58
3.5 Reformat në drejtësi dhe Gjykata Kushtetuese me theks në vettingun e gjyqtarëve kushtetues	61

KAPITULLI I KATËRT

4. ASPEKTET KRAHASUESE TË MBROJTJES SË LIRIVE DHE TË DREJTAVE THEMELORE TË NJERIUT DHE TË QYTETARIT NGA GJYKATAT KUSHTETUESE TË MAQEDONISË SË VERIUT, KOSOVËS DHE SHQIPËRISË

4.1. Aktivizmi gjyqësor i Gjykatës Kushtetuese të RMV-së në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit – analiza e jurispodencës kushtetuese	68
4.2. Aktivizmi gjyqësor i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit – analiza e jurispodencës kushtetuese	79
4.3. Aktivizmi gjyqësor i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit – analiza e jurispodencës kushtetuese.....	85
4.4. Ndikimi i jurispodencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në konsolidimin e gjyqësisë kushtetuese në Maqedoninë e Veriut, Kosovë dhe Shqipëri në lëmin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit.....	89
KONKLuzionET DHE REKOMANDIME.....	99
SHTOJCA	105
BIBLIOGRAFIA.....	112

ABSTRAKTI

Tema të cilën e kam zgjedhur ta punoj, ka të bëjë me gjyqësinë kushtetuese, ku shumë pak është bërë një hulumtim nga ana e studiuesve në shqip për këtë lëmi të së drejtës. Ky studim besoj që në të ardhmen sa do pak tu shërbejë studiuesve të ri për këtë lëmi.

Gjyqësia kushtetuese paraqet një ndër institucionet më të rëndësishme në ato shtete ku e zbatojnë mbrojtjen e kushtetutshmërisë nga një organ i vetëm, pra Gjykata Kushtetuese.

Sot, njihen dy forma të kontrollit dhe mbrojtjes së kushtetutshmërisë edhe atë: nga ana e gjykatave të rregullta-Gjykata Supreme dhe njihet si modeli Amerikan dhe modelin e centralizuar që realizohet nga një organ i vetëm: Gjykata Kushtetuese dhe njihet si modeli Evropian.

Të trija vendet e rajonit: Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Shqipëria aplikojnë formën e kontrollit dhe mbrojtjes në mënyrë të centralizuar nga Gjykata Kushtetuese. Gjyqësia kushtetuese është në kuadër të sistemit juridik të po atij vendi ku vendimet e saj janë të zbatueshme dhe të pa apelueshme.

Si organ që miraton vendime përfundimtare në jurisprudencën e këtyre vendeve të rajonit kryen edhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit, ku vendimet e saj në qoftë se janë në dëm të individit ka të drejtë ankese përpara Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut-GJEDNJ.

Fjalët kyçe: gjyqësia kushtetuese, Gjykata Kushtetuese, mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit, aktivizmi gjyqësor, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

ABSTRACT

The topic in which I have chosen to work has to do with the constitutional judiciary, where very little research has been done by scholars in Albanian on this area of law. I believe that this study will serve young researchers in this field in the future.

Constitutional justice is one of the most important institutions in those states where they apply the protection of constitutionality by a single body, the Constitutional Court.

Today, two forms of constitutional control and protection are recognized: by the regular courts-Supreme Court which is known as the American model and the centralized model implemented by a single body: the Constitutional Court which is known as the European model.

All three countries in the region: North Macedonia, Kosovo and Albania apply the form of control and protection centrally by the Constitutional Court. Constitutional justice is within the legal system of the same country where its decisions are enforceable and unappealable.

As a body that adopts final decisions in the jurisprudence of these countries in the region, it also protects human and civil rights and freedoms, where its decisions, if to the detriment of the individual, have the right to appeal before the European Court of Human Rights-ECHR.

Keywords: constitutional judiciary, Constitutional Court, protection of human and civil rights and freedoms, judicial activism, European Court of Human Rights.

АПСТРАКТ

Темата на која избрав да работам има врска со уставното судство, каде што многу малку истражување на Албански е направено од научници од оваа област на правото. Верувам дека оваа студија ќе им служи на младите истражувачи од оваа област во иднина.

Уставната правда е една од најважните институции во оние држави каде тие ја применуваат заштитата на уставноста од страна на едно тело, Уставниот суд.

Денес се препознаваат две форми на уставна контрола и заштита: од страна на редовните судови, Врховниот суд познат како: Американскиот модел и централизираниот модел, кој го спроведува едно тело: Уставниот суд кој е познат како Европски модел.

Сите три земји во регионот: Северна Македонија, Косово и Албанија ја применуваат формата на контрола и заштита централно од Уставниот суд. Уставната правда е во рамките на правниот систем на истата земја каде нејзините одлуки се применливи и необжалливи.

Како орган што донесува конечни решенија во јурисприденцијата на овие земји во регионот, тој ги штити и човековите и граѓанските права и слободи, каде што нејзините одлуки, ако се на штета на поединецот, тие имаат право да се жалат пред Европскиот суд за човекови права-ЕСЧП.

Клучни зборови: уставно судство, Уставен суд, заштита на човекови и граѓански права и слободи, судски активизам, Европски суд за човекови права.

Hyrje

„Nëse një gjykatë ka pushtetin e shfuqizimit të ligjit, atëherë ajo është e autorizuar të vendos një normë të përgjithshme, sepse shfuqizimi i ligjit ka të njëjtin karakter të përgjithshëm sikurse miratimi i ligjit”

Hans Kelzen

1.Lënda e hulumtimit

Paraqitja e Gjykatave Kushtetuese zanafillën e saj e ka pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Ideatori i saj është profesori i Drejtës Kushtetuese Hans Kelzen që ishte edhe hartues i Kushtetutës së Austrisë në vitin 1920 .Në Kushtetutën e shtetit Austriak për herë të parë kishte paraparë mbrojtjen e kushtetutshmërisë nga ana e organit të posaçëm që ishte i ndarë nga ana e pushtetit gjyqësor dhe njihet si Gjykata Kushtetuese. Pas Luftës së Dytë Botërore krijimi i Gjykatave Kushtetuese i ka paraprirë një lëvizje e shteteve evropiane për të ngritur vetëdijësimin për nevojën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave fundamentale, veçanërisht të atyre politike. Ndarja e Evropës në bllokun e Lindjes dhe të Perëndimit shënoi ndarje të thellë ideologjike dhe politike, përfshi këtu, por duke mos kufizuar në liritë dhe të drejtat e njeriut . Fatëkeqësisht, cenimi dhe shkelja e këtyre lirive dhe të drejtave vazhdoi të manifestohet në shtetet e Evropës Lindore ku sistemet moniste dhe diktatoriale ndoqën një politikë të ashpër dhe sistematike në kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Pas rënies së Murit të Berlinit , pas viteve 90 të shekullit të kaluar shumica e këtyre shteteve që kishin sistem monist, kaluan në sistem demokratik-pluralist, shumë partiak dhe hartuan kushtetuta të reja me frymë demokratike dhe që parashihnin në kuadër të sistemit politik ndarjen e pushteteve si dhe përqafuan modelin kelzian për Gjykatën Kushtetuese. Njihet dy kontrole kushtetuese: Kontrolli i centralizuar, ku i tërë kontrolli kushtetues është përcaktuar në një organ—Gjykata Kushtetuese apo siç njihet kontrolli evropian; dhe Kontrolli i decentralizuar ku çdo gjykatës ka të drejtë të iniciojë nismën për përputhshmërinë e ligjeve me kushtetutën apo siç njihet ndryshe: Kontrolli amerikan i kushtetutshmërisë. Gjyqësia Kushtetuese është degë e ndarë nga gjyqësia e zakonshme në vendet e rajonit të Europës JugLindore, është pra, kategori kushtetuese, ku mbrohet kushtetutshmëria e ligjeve, akteve tjera nënligjore në pajtim me Kushtetutën. Rëndësia e posaçme e Gjykatave Kushtetuese në rajonin që jetojmë ne, është mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe mos tejkalimi i kompetencave të organeve shtetërore në dëm të qytetarëve.

2. Qëllimet e hulumtimit

Të tre shtetet si: Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Shqipëria pothuajse kanë një të kaluar të përbashkët që ishin nën regjimin monist dhe kalimi nga sistemi politik monist në sistemin demokratik-pluralist dhe shumë partiak, ka kaluar një periudhë të tranzicionit gati 30 vjeçar dhe akoma nuk janë

rezultatet që kishin pritur për demokratizimin e këtyre vendeve në shumë aspekte si në gjyqësorë, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejtat e qytetarëve jo shumicë në vend (kjo vlen për RMV), dhe në shumë aspekte politike dhe juridike.

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në të tre vendet e lartpërmendura akoma nuk mund të shkëputen nga e kaluara e tyre.

Qëllimet e hulumtimit janë :

Si temë e përzgjedhur nga ana ime është në atë se shumë pak njohuri ka opinioni lidhur me punën e Gjykatave Kushtetuese të këtyre tre shteteve.

Forma, organizimi dhe funksionimi i Gjykatave Kushtetuese, përparësitë dhe mangësitë e konstatuara nga shteti në shtet.

Aspektet krahasuese në mes të Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë -ngjajshmëritë dhe dallimet.

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit me vështirësi të posaçëm në aktivizimin kushtetues gjyqësor të tyre.

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut nga ana e Gjykatës Kushtetuese në rast se tejkalohen kompetencat nga ana e organeve shtetërore.

3.Hipotezat

Gjatë këtij hulumtimi shkencor do të paraqesim disa hipoteza, të cilat gjatë përpunimit të tezës do të vërtetohen. Hipotezat e punimit janë: - Roli i Gjykatave kushtetuese në RMV, Kosovë dhe Shqipëri në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

- A paraqet gjyqësia kushtetuese një mekanizëm efikas për mbrojtjen e të drejtave të njeriut?
- Parandalimi i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe qytetarit nga ana e pushtetit shtetëror në tejkalimet e kompetencave të tyre
- Mënjanimi nga rendi juridik shtetëror i ligjeve dhe i veprimeve që janë në kundërshtim me Kushtetutën.
- Mosekzistimi i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të RMV-së paraqet mangësi në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në RMV.
- Kontrolli konkret dhe abstrakt i ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare .
- Mbrojtja e qytetarëve nga ana e Gjykatës Kushtetuese si instanca e fundit pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike në vend.

4. Metodologjia e hulumtimit

Në këtë punim të magjistraturës do të shfrytëzohet literaturë hulumtuese e ndryshme duke filluar nga tekstet universitare, studime, raporte dhe publikime të tjera që kanë të bëjnë me temën e caktuar , Kushtetutat , Ligjet mbi Gjykatën Kushtetuese , Rregulloret mbi Gjykatat Kushtetuese , vendimet e Gjykatave Kushtetuese etj.

Metodat që do të përdoren janë :

- Metoda historike - do të përdoret kjo metodë që të hulumtohet historiku i krijimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ecuria e saj nga krijimi e deri në ditët tona dhe roli i saj në kuadër të sistemit juridiko-politik në shtet.
- Metoda juridike – do të shqyrtohen dhe analizohen vendimet e Gjykatave Kushtetuese të rajonit që janë disa prej tyre më të rëndësishme në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.
- Metoda statistikore – do të shqyrtohen vendimet, aktgjykimet , aktvendimet dhe të bëhet analiza dhe të shihet epilogu final që ka sjellur gjykata në fjalë.
- Metoda komparative – do të bëhen krahasime në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut .

Në tezën e magjistraturës do të shfrytëzohen të dhënat e Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut ,Kosovës dhe Shqipërisë si dhe burimet e tjera zyrtare.

5. Rëndësia e punimit

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut nuk ka vetëm karakter kombëtar, por edhe ndërkombëtar. Do të bëhen analiza krahasuese në mes të tre shteteve të rajonit, pra Republikës së Maqedonisë së Veriut, Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, me theks të veçantë në aktivizmin e tyre gjyqësor në mbrojtjen e të drejtave të njeriut si një ndër kompetencat e tyre themelore kushtetuese. Poashtu, do të analizohen edhe nismat e paraqitura nga palët si dhe vendimet që ka sjellur gjykata kur janë bërë shkeljet e të drejtave të njeriut . Për herë të parë do t'i qasemi analizës shkencore dhe në mënyrë krahasuese do të paraqesim gjyqësinë kushtetuese në tre shtetet e lartë përmedura. Edhe pse kanë shumë ngjajshmëri nga pozita kushtetuese dhe përbërja e tyre kushtetuese, megjithatë ato dallohen në disa aspekte esenciale mes veti. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë e kanë të rregulluar punën e tyre me anë të ligjit të veçantë për gjykatat kushtetuese, kurse Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut rregullohet vetëm me anë të Rregullores së punës së saj të v. 1992, gjë që paraqet një mangësi të kësaj Gjykate në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

KAPITULLI I PARË

1.GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

1.1 Historiku dhe krijimi Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e RMV-së ka një traditë mbi 50 vjeçare. Për herë të parë inkorporohet në Kushtetutën e ish -RSM-së të vitit 1963 dhe fillon me punë më 15 shkurt 1964. Krijimi i gjyqësorit kushtetues ishte i lidhur drejtpërdrejtë me vendosjen e juridiksionit të gjykatave në çështjet administrative dhe qëllimi i tyre bazohej vetëm në gjykimin e çështjeve civile dhe penale ¹. Sipas Kushtetutës së vitit 1974 dhe Ligjit mbi bazën e procedurës dhe efektin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të vitit 1976 bënë ndryshime të vogëla në juridiksionin Gjykatës dhe efektin juridik të vendimeve të saja ku Gjykata Kushtetuese ishte pjesë e sistemit të unitetit të pushtetit dhe kishte për detyrë të sigurojë harmoninë e brendshme të rendit juridik. Funkcioni themelor ishte në monitorimin dhe në ndjekje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve mbi kushtetutshmërinë dhe ligjëshmërinë- pra kishte rol formal. ²

Me referendumin e 8 shtatorit 1991 qytetarët e vendit shprehin vullnetin e tyre për një shtet të pavarur dhe sovran duke u shkëputur nga federata Jugosllave dhe krijuan shtetin e ri në atë kohë të njohur si Republika e Maqedonis, më 17 nëntor 1991 aprovuan edhe Kushtetutën, sipas Kushtetutës sistemi socio-ekonomik dhe politik i Republikës bazohej në parimin e sundimit të ligjit, të drejtat dhe liritë e njeriut, ndarjen e pushteteve, ekonominë e tregut dhe vlerat e tjera themelore të shoqërisë moderne demokratike. ³

1.2 Pozita e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese është kategori kushtetuese që bën mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë dhe mbron të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe qytetarit. ⁴. Ky institucion i ndërlidhur më tepër në aspektin teorik me parimin e sundimit të së drejtës se sa me parimin e ndarjes së pushteteve. Kjo është më se e logjishme, sepse parimi i sundimit të së drejtës është më i

¹Materiali i arritshëm në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese të RMV, http://ustavensud.mk/?page_id=4603

²Po aty,

³Po aty,

⁴Kushtetuta e Maqedonis së Veriut, Nenet 108-113

gjërë se parimi i ndarjes së pushteteve në ate legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësorë. Është organ shtetëror me një autoritet të lartë, sepse vendimet e saj janë të detyrueshme për të gjithë subjektet e tjerë pa të drejtën e ankesës. Autoriteti i saj rrjedh nga e drejta për të shfuqizuar ligjet dhe dispozitat e tjera jo kushtetuese. Ka pavarësi të plotë nga Kuvendi i RMV-së, Qeveria dhe gjykatat e zakonshme, ka pavarësi të plotë ndaj ligjeve që mund t'i shfuqizojë ose anulojë nëse nuk janë në përputhje me Kushtetutën. Si organ me një relevancë të madhe shtetërore varet vetëm nga Kushtetuta dhe paraqitet si garantuese dhe mbrojtëse e saj. Pushtetit ligjëvënës dhe ai ekzekutiv mbrohen nga pushteti i Gjykatës Kushtetuese me miratimin apo plotësimin e Kushtetutës nëpër mes të amandamenteve kushtetuese apo ndryshimit të tërësishëm të Kushtetutës.⁵

1.3 Përbërja dhe zgjedhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese-përparësitë dhe mangësitë

Në bazë të nenit 109 të Kushtetutës së RMV-së :

Gjykatën Kushtetuese e përbëjnë nëntë gjyqtarë.

Kuvendi i zgjedh gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Mandati i gjyqtarëve zgjat nëntë vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje.

Gjykata Kushtetuese nga radhët e veta zgjedh kryetarin me kohëzgjatje prej tre vjetësh dhe pa të drejtë rizgjedhjeje.

*Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga radhët e juristëve të shquar*⁶

Nga dispozita kushtetuese „jurist i shquar “ mund të konkludojmë se „gjyqtarët kushtetues duhet të jenë juristë dhe të kenë njohuri solide të së drejtës dhe të gëzojnë reputacion në shoqëri, mirëpo nga aspekti kushtetues krahasues termi „jurist i shquar “ është i paqartë dhe jo i saktë ,kështu në të ardhmen duhet të qartësohet dhe të konkretizohet sikur se që kanë precizuar kushtetutat e vendeve të rajonit dhe ato evropiane . Kushtetutën e Kosovës, e cila në nenin 114 ka specifikuar se Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese do të jenë juristë të shquar dhe personalitete me moralin më të lartë, me jo më pakë se dhjetë (10) vjetë përvojë profesionale përkatëse, me ç'rast kualifikimet tjera janë të rregulluara me ligj. Parimet e barazisë gjinore do të respektohen.⁷

Përbërjen e Gjykatës Kushtetuese e përcaktojnë tre organe të pushtetit shtetëror edhe ate : *Kuvendi i RMV-së* (meqë Komisioni për zgjedhje dhe emërimet propozon 5 kandidatë për gjyqtarë të Gjykatës

⁵. Shasivari, Jeton, E drejta kushtetuese, .Shkup, 2020 Furkan ISM , fq. 377 , Cituar nga : . Шкарик, Светомир и Давкова-Сиљановска, Гордана, Уставно право , Скопје, 2009 стр. 699-700,

⁶Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut , Cituar Neni 109 (marrur nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, (Teksti zyrtar, i spastruar-për përdorim intern), përkthyer nga: Prof. Dr Kurtesh Salii, Fakulteti juridik-UEJL, Tetovë, 2007.)

⁷. Kushtetuta e Republikës së Kosovës , Neni 114,

Kushtetuese), *Kryetari i shtetit* (meqë propozon 2 kandidatë për gjyqëtarë të Gjykatës Kushtetuese) dhe *Këshilli Gjyqësor i RMV-së* (meqë propozon 2 kandidatë për gjyqëtarë të Gjykatës Kushtetuese).⁸

Nga kjo shohim se RMV-ja bënë pjesë në ato shtete ku Kuvendi ka pushtet ekskluzivë dhe të centralizuar në zgjedhjen e gjyqëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, mirëpo kjo zgjedhje e gjyqëtarëve nuk përkon në frymën e parimit të ndarjeve të pushteteve, sepse nuk garantohet ndikimi politikë dhe presioni i partive politike në përzgjedhjen e gjyqëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, prandaj në të ardhmen duhet të ketë një barazpeshë në zgjedhje ku 3 gjyqëtarë të emërohen nga Kryetari i shtetit, 3 gjyqëtarë të zgjedhen nga Kuvendi i RMV-së dhe 3 gjyqëtarë të zgjedhen nga Këshilli Gjyqësor i RMV-së nga radhët e gjyqëtarëve. Ky model është model më ideal në përzgjedhjen e gjyqëtarëve ku përfshihen të tre pushtetet ai legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe me këtë dobësohet ndikim politik dhe presionet nga partitë politike.⁹

Bazuar në Kushtetutën e RMV-së funksioni i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është inkompatibil me ushtrimin e funksioneve tjera publike si dhe me antarësim në parti politike. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë imunitet si të deputetëve të Kuvendit për të cilën vendos vetë Gjykata, ku përmbajta për imunitetin përcaktohet me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese e jo me Kushtetut. Sipas Rregullore, gjyqtarët gëzojnë imunitet njësoj si deputetët e Kuvendit të RMV-së që domethënë se imuniteti i gjyqëtarëve ngërthen në vete dy elemente: *papërgjegjësinë* (imunitet material) dhe *paprekëshmërinë* (imunitet procedural).

Ndërprerja e funksionit si gjyqëtarë i Gjykatës Kushtetuese përcaktohet në nenin 111 parg. 4 të Kushtetutës së RMV-së: *Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese i pushon funksioni nëse paraqet dorëheqje. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese do të shkarkohet nga detyra nëse dënohet për veprë penale me dënim të pakusht me burg me më së paku gjashtë muaj ose kur përgjithmonë do ta humb aftësinë për ushtrimin e funksionit të tij, të cilën e verifikon Gjykata Kushtetuese.*¹⁰

1.4. Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese, me theks në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit

Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën; për pajtueshmërinë e dispozitave tjera nënligjore dhe kontratave kolektive me Kushtetutën dhe me ligjet; i mbron të drejtat e njeriut dhe të qytetarit që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe

⁸. Shasivari, Jeton, E drejta kushtetuese, .Shkup, 2020 Furkan ISM , fq. 378

⁹. Po aty fq 370

¹⁰. Kushtetuta e Maqedonis së Veriut , Cituar Netuni 111 parg. 4(marrur nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, (Teksti jo-zyrtar, i spastruar-për përdorim intern), përkthyer nga: Prof. Dr Kurtesh Salii, Fakulteti juridik-UEJL, Tetovë, 2007.)

shprehjese publike të mendimeve, bashkimin dhe veprimin politik dhe me ndalimin e diskriminimit në bazë të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë kombëtare, sociale dhe politike. endos për konfliktin për kompetenc në mes të bartësve të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Vendors për konfliktin për kompetencë në mes të organeve qendrore dhe atyre lokale; vendors për përgjegjësinë e Kryetarit të Shtetit; vendors për kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe të shoqatave civile dhe vendors për çështje tjera të caktuara me Kushtetutë.¹¹

Kontrolli normativ i aktve të përgjithshme juridike përbëjnë funksionin themelor të Gjykatës Kushtetuese që realizohet në dy nivele: kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kontrollin e kushtetutshmërisë dhe të ligjëshmërisë së dispozitave dhe aktve të tjera juridike të përgjithshme. Kontrolli i përgjithshëm përfshin të gjitha aktet juridike të përgjithshme, me përjashtim të amandamenteve kushtetuese (kanë fuqinë e Kushtetutës) dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare (sipas Kushtutës, e drjeta ndërkombëtare ka primatin e saj ndaj të drejtës së brendshme). Kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve i përfshin të gjitha llojet e ligjeve. Kontrolli i kushtetutshmërisë dhe i ligjëshmërisë së dispozitave dhe aktve të tjera juridike të përgjithshme i përfshin: dispozitat nën-ligjore (dekretligjet, vendimet e Qeverisë, udhëzimet, instruksionet dhe rregulloret e organeve të administratës shtetërore). Përfshinë aktet e përgjithshme: statutet e komunave, vendimet e këshillave komunal, aktet e institucioneve me autorizime publike, kontratat kolektive për punësim etj.

Kontrolli normativ i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë realizohet me *kontroll abstrakt* e jo *konkret* pasi para Gjykatës Kushtetuese udhëheqet kontest midis normave të përgjithshme juridike, e jo kontest në mes njerëzve konkret. Kontesti është abstrakt, sepse udhëhiqet në mes të normave të Kushtutës dhe normave ligjore, përkatësisht në mes të normave ligjore dhe normave të dispozitave dhe aktve të tjera të përgjithshme.¹² Nga gjithë kjo duhet shtuar se kemi të bëjmë me kontroll *aposteriori*, pasi që objekt i kontrollit është vetëm i akteve normative në fuqi dhe nuk parashihet kontroll preventiv para se aktet normative të hynë në fuqi.¹³

Gjykata Kushtetuese mbron *liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit*, por prej gjithsej 44 lirive dhe të drejtave personale, politike, ekonomike sociale dhe kulturore i mbron vetëm 3 prej tyre edhe ato : lirinë e bindjes, ndëgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimeve, bashkimin dhe veprimin politik dhe ndalimin e diskriminimit në bazë të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë

¹¹. Po aty, neni 110

¹². Shasivari, Jeton, E drejta kushtetuese, Shkup, 2020 Furkan ISM, fq. 380-381, Cituar nga: Шкарик, Светомир и Давкова-Сиљановска, Гордана, Уставно право, Скопје, 2009 стр. 706-708,

¹³ Po aty, fq 381, Cituar nga: web faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese të RMV-së http://ustavensud.mk/?page_id=4597.

kombëtare, sociale dhe politike. Mbrojta e të drejtave të tjera është në kompetencë të gjykatave të rregullta. Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese cakton kompetencat e Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të zakonshme në mbrojtjen e lirive dhe të drjetave të njeriut dhe qytetarit edhe atë nëse plotësohen dy kushte: kushti i parë, nëse paraprakisht është shteruar mbrojta juridike para gjykatave të zakonshme dhe kushti i dytë nëse kërkesa për mbrojtjen e tyre paraqitet në afat prej dy muajsh nga dita e dorëzimit të aktëgjykimit përfundimtar dhe të plotëfuqishëm me të cilat janë cenuar të drjetat.

Si objekt të kontrollit ka edhe kompetenca në kontrollin e akteve dhe veprimeve konkrete të organve të pushtetit publik, ku qytetarët konsiderojnë se i cenohen ndonjë nga tri liritë dhe të drejtat e lartëpërmendura, ku si objekt i kontestit paraqiten edhe aktet administrative dhe aktet gjyqësore të cilësdo instanc. Dobësi kryesore është se nga 44 liritë dhe të drejtat mbron vetëm tri prej tyre, si dhe aktivizimi mjaft i ngushtë i kësaj Gjykate nga themelimi i saj e deri më sot vetëm në tre raste ka konstatuar se janë shkelur liritë e lartëpërmendura. Rasti i parë është në vitin 2010 kur cenimi i lirisë së bashkimit dhe veprimit politikë¹⁴ dhe rasti i dytë në vitin 2019 cenimi i lirisë mendimit dhe shprehjes publike të mendimit.¹⁵

Në zgjedhjen e konfliktit për kompetencë, i cili mund të jetë *pozitiv* (kur dy apo më shumë organe pretendojnë në zgjedhjen e të njëjtës çështje) dhe *negativ* (kur dy apo më shumë organe pretendojnë se janë jo kompetent për zgjedhjen e të njëjtës çështje), Gjykata Kushtetuese vepron si gjykatë konflikti, nuk e zgjedh çështjen, por cakton se cili është organ kompetent për zgjedhjen e çështjes. Nëpër mes të këtij funksioni mbron parimin e kushtetutshmërisë statusore ose institucionale duke mbrojtur kufijtë kushtetues të pushtetit.¹⁶

Gjykata vendos edhe për përgjegjësinë e Kryetarit të shtetit me shumicë prej dy të tretave të votave nga numëri i përgjithshëm i gjyqëtarëve (duhet të votojnë 6 gjyqëtar) dhe nëse konstaton këtë përgjegjësi, Kryetarit të shtetit i pushon funksioni sipas fuqisë së Kushtetutit¹⁷. Në të njëjtën mënyrë dhe në frymë demokratike duhet që të vendoset edhe për përgjegjësinë e Kryeministrit dhe ministrave të Qeverisë, pra kemi të bëjmë me një sanksion dhe përgjegjësi politike- morale dhe

¹⁴Për më tepër shih në: Shasivari, Jeton, *Restricted Judicial Activism of Constitutional Court of the Republic of North Macedonia Regarding Protection of Human Rights and Freedoms*, *Acta Universitatis Danubius, Juridica*, Vol. 15, No. 1, 2019, Danubius University, Galati, Romania. p. 200-203 <http://journals.univdanubius.ro/index.php/index/index> 5522/4914

¹⁵. Për më tepër shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese <http://ustavensud.mk/?p=18219>, dhe marrur nga portali Akademika i datës 26.shtator 2019, ora 13.23 për më tepër, <https://akademik.mk/protivustavno-se-kazneti-advokatite-vo-predmetot-27-april-odluchi-ustavniot-sud-po-intsijativa-na-advokatite-zefik-i-toshkovski/>

¹⁶. Shasivari, Jeton, *E drejta kushtetuese*, Shkup, 2020 Furkan ISM, fq. 382, Cituar nga: Шкарик, Светомир и Давкова-Сиљановска, Гордана, *Уставно право*, Скопје, 2009 стр. 708-709,

¹⁷. Për më tepër shih Kushtetutën e RMV-së, Neni 87.

juridike në shkarkimin e tyre. Të njëjtën gjë e parasheh Gjykata Kushtetuese e Austrisë, Gjermanisë dhe Italisë, kurse për përgjegjësinë e Qeverisë nuk vendos në RMV Gjykata Kushtetuese por gjykatat e zakonshme.¹⁸

Vendosja për kushtetutshmërinë e programve dhe statuteve të partive dhe shoqatave civile, ka të bëjë me kontest normativ edhe atë e bën me dy akte: aktet konstituive të partisë ose të shoqatës civile dhe Kushtetutës të RMV-së, kontesti i tillë hapet nëse programet dhe veprimtaria është e orientuar drejt rrënimit të dhunshëm të rendit kushtetues e shtetëror dhe drejt nxitjes ose agresionit ushtarak, nxitjes dhe urrejtjes kombëtare, racore dhe fetare.

Gjykata Kushtetuese e RMV-së nuk ka kompetenca për të ndaluar veprimtarinë e partive politike dhe shoqatave civile, sikurse i ka kompetenca Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë dhe e Kroacisë. Vendimin për ndërprerjen e veprimtarisë së partive politike dhe shoqatave civile e nxjerr gjykata e zakonshme. Nuk ka kompetenca edhe me procesin zgjedhor, sepse këto kompetenca i ka Komisioni shtetëror zgjedhor dhe Gjykata Administrative.¹⁹

Në bazë të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese procedura hapet me iniciativë të qytetarit²⁰ apo personit juridik ose sipas detyrës zyrtare (ex-officio).

1.5. Efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Në bazë të Kushtetutës së RMV-së çdo ligj që nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën mund të shfuqizohet ose anulohet nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Anulon ose shfuqizon Gjykata Kushtetuese edhe dispozitën tjetër ose aktin e përgjithshëm, kontratën kolektive,statutin e partive politike ose të shoqatës, nëse vërtetohet se ato nuk janë në pajtim me Kushtetutën ose me ligjin. *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të formës së prerë dhe të ekzekutueshëm.*²¹

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nga aspekti i personave kanë efektin e përgjithshëm detyrues, sepse veprojnë ndaj të gjithëve (erga omnes tanguit), jo vetëm ndaj palëve në kontest. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nga aspekti i pasojave kanë efekt shfuqizues ose abrogues. Gjykata vendimet që merr për *shfuqizimin* e ligjit ose aktit tjetër të përgjithshëm juridik pushon të vlej nga momenti i

¹⁸. Shasivari, Jeton, E drejta kushtetuese, .Shkup, 2020 Furkan ISM , fq. 382 , Cituar nga : . Шкарик, Светомир и Давкова-Сиљановска, Гордана, Уставно право , Скопје, 2009 стр. 709,

¹⁹. По аty , fq 383

²⁰. Shih fusnotën 1072 në Shasivari, Jeton, „E drejta kushtetuese”, .Shkup, 2020 Furkan ISM , fq. 383 - Në RMV para Gjykatës Kushtetuese dominojn kërkesat e qytetarëve, duhet veçuar qytetarin Stamen Filipov ,që është toger i pensionuar ku nga viti 1993 ka paraqitur mbi 1000 iniciativa ,me çrast sipas iniciativës së tij Gjykata ka shfuqizuar 263 dispozita ligjore,9 ligje në tërësi dhe 64 dispozita nënligjore

²¹. Kushretuta e Maqedonis së Veriut , Cituar Netuni 111 parag. 4(marrur nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, (Teksti jo-zyrtar, i spastruar-për përdorim intern), përkthyer nga: Prof. Dr Kurtesh Salii, Fakulteti juridik-UEJL, Tetovë, 2007.),fq 44.

publikimit të vendimit në „Gazetën Zyrtare të RMV-së” që d.m.th se shfuqizimi vepron „ex nunc” (prej tani), vetëm në të ardhmën, përjashtohet egzistimi i aktit jokushtetues për në të ardhmen. Pra, me shfuqizim nuk vihen në pyetje pasojat juridike që i ka krijuar në praktikë akti jo kushtetues nga momenti i nxjerrjes së tij, shfuqizimi nuk ka efekt prapaveprues.²² Gjykata Kushtetuese me vendim për *anulim*, anulon jo vetëm aktin jokushtetues por edhe të gjitha pasojat që ka prodhuar akti në praktikë deri në momentin e nxjerrjes së vendimit për anulim. Vendimi për anulim vepron „ex tunc” (prej atëherë) pra nga dita e nxjerrjes apo hyrjes në fuqi të aktit jokushtetues që d.m.th ka fuqi prapavepruese, sepse anulon edhe pasojat juridike.²³ Për shkak të sigurisë juridike, vendimet për anulim nuk kanë fuqi prapavepruese ndaj rasteve të gjykuara (res judicata), sepse nuk mund të zhvillohet sërish procedurë (non bis in idem-jo dy herë për të njëjtën). Përjashtim bëjnë aktet konkrete të formës së prerë të gjykatave të zakonshme, të cilët i cënojnë liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit nga rethveprimi i kompetencës së Gjykatës Kushtetuese. Nga *aspekti i vëllimit* të shfuqizimit ose të anulimit, vendimet mund të jenë të *plota* (akti shfuqizohet ose anulohet në tërësi për shkaqe formale) dhe *jo të plota* (shfuqizohen ose anulohen vetëm disa dispozita të ligjit jokushtetues për shkaqe materiale).

Nga dita e publikimit në „Gazetën zyrtare të RMV-së” vendimet e Gjykatës Kushtetuese prodhojnë efekte juridike që d.m.th për dallim nga ligjet nuk kanë „*vocatio legis*” sepse ligji i shfuqizuar ose i anulur fshihet nga rendi juridik menjëherë pas publikimit të vendimit të Gjykatës. Vendimet janë të plotfuqishme, sepse nuk munden të goditen as me mjete të rregullta apo mjete të jashtëzakonshme. Procedura në Gjykatën Kushtetuese është një shkallëshe. Vendimet janë të përmbarueshme (ekzekutushme) dhe realizohen menjëherë pas publikimit në „Gazetën zyrtare të RMV-së” me ç’rast vendimet e saj i përmbaron nxjerrësi i aktit juridik që është shfuqizuar ose anuluar me anë të vendimit të Gjykatës. Nëqoftëse nuk ekzekutohen vendimet e Gjykatës Kushtetuese, atëherë përmbarimen e tyre e siguron Qeveria si bartës i pushtetit ekzekutiv.²⁴

Vendimet që merr Gjykata kanë karakter detyrues, sikurse ligjet, mirëpo nuk nënkupton edhe rirregullimin e ligjit, sepse në këtë formë do të përvetësojë funksionin e Kuvendit dhe këto kompetenca janë të Kuvendit si bartës i pushtetit legjislativ. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese paraqitet si „ligjvënës negativ”²⁵

²². Shasivari, Jeton, „E drejta kushtetuese”, .Shkup, 2020 Furkan ISM , fq. 383

²³. Po aty .fq 384

²⁴. Shasivari, Jeton, E drejta kushtetuese, .Shkup, 2020 Furkan ISM , fq. 384-385 , Cituar nga : . Шкариќ, Светомир и Давкова-Сиљановска, Гордана, Уставно право , Скопје, 2009 стр. 714-716.

²⁵. Po aty , fq 385 Cituar nga : Saliu, Dr., Kurtesh, E drejta kushtetuese, Libri I, (Botimi i katërt), Prishtinë, 2004 ,fq 199

Dispozitata kushtetuese për Gjykatën janë përgjithësuara dhe të pakta në numër. Vlerësimi për një akt ose dispozitë a është i përgjithshëm apo është lënë në duar të saj dhe kështu ka bërë shpesh shtrembërime të autorizimeve të saja. Në vitin 1996 ishin grumbulluar 150.000 nënshkrime të votuesve, që kërkonin shpalljen e referendumit për zgjedhje të parakohshme dhe Kuvendi i RMV-së me konkluzion nuk e pranoi iniciativën, sepse nuk mund të shpallin referendum për këtë çështje. Iniciativën e dërguan para Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të konkluzionit të Kuvendit, Gjykata e hodhi poshtë kërkesën me arsyetimin se nuk është kompetente për këtë çështje, sepse konkluzioni i Kuvendit nuk është akt i përgjithshëm, por është akt konkret për një çështje konkrete.²⁶

Një rast nga praktika gjyqësore e vendimi të Gjyktës Kushteuese e vitit 2007 për shfuqizimin e disa neneve të Ligjit për përdorimin e simboleve të komuniteteve në RMV të datës 15 korrik 2015, me të cilën fare nuk u mor parasysh pika 7.1 e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit që parasheh censusin shumicë për përdorimin e simboleve në komuna ku ishte i bazuar ligji në fjalë.

Një vendim shumë kontraverz dhe nën ndikimin e politikave ditore kemi në vitin 2016 brenda një periudhe tremujore, kur Gjykata Kushteutese miratoi dy vendime të kundërta për kompetencën e saj mbi kushtetutshmërinë e vendimit për shpërndarje të Kuvendit. Më 18 janar 2016 Kuvendi miratoi vendim për shpërndarje, që duhet të hynte në fuqi më 24 shkurt 2016. Ky vendim u kontestua para Gjykatës më 18 shkurt 2016 dhe nuk e pranoi këtë iniciativë me arsyetimin se vendimi për shpërndarjen e Kuvendit është një akt konkret dhe nuk përmban norma të përgjithëshme juridike. Nga ana tjetër vendimi për shpërndarjen e Kuvendit u ndryshua me 23 shkurt 2016 dhe shpërndarja e Kuvendit duhej të hynte në fuqi me 7 prill 2016 në vend të 24 shkurtit 2016. Kuvendi u shpërnda dhe u shpallën zgjedhjet të parakohshme parlamentar për me 5 qershor 2016. Në këtë kohë kishim një gjendje krize dhe ishte e pamundur të organizohen zgjedhje fer, të lira dhe demokratike dhe u parashtrua një kërkesë për shtyerjen e zgjedhjeve më 18 maj 2016. Gjykata Kushtetuese vendosi një zëri se është kompetente për të vendosur për vendimin e shpërndarjes së Kuvendit, sepse ky vendim ka karakter juridik të përgjithshëm dhe tërthorazi ju referohet tërë qytetarëve që votojnë për zgjedhje të deputetëve andaj i anuloi të dy vendimet për shpërndarjen e Kuvendit me efekt shtyrës të 18 januarit dhe 23 shkurtit 2016. Këta dy vendime plotësisht të ndryshëm dëshmojnë për

²⁶. По аты фк. 386 Цітау нга : Десковска, Др.Рената „Уставниот суд во Р.М:Предлози за реформа“, Зборник на трудови од меѓународен симпозиум, Скопје, 2004, Стр 377-386,

politizim të kësaj Gjykate, ku gjyqtarët nuk lihen të lirë në bazë të mendimit dhe bindjes së vet të marrin vendim, por ndikohen nga ata që i kanë vendosur në atë pozicion.²⁷

Kuvenidi si bartës i pushtetit legjislativ në RMV duhet të respektoj Gjykatën Kushtetuese dhe të mbaj llogari për interpretimin që u jep normave kushtetuese kjo Gjykatë. Pra, në të ardhmen kur të miratohen ligjet duhet paraprakisht të kenë parasysh interpretimet, qëndrimet, pikëpamjet dhe vendimet e Gjykatës në mënyrë që t'i shmanget rrëzikut që ligjvënësi të miratoj ligje që do të anulohen apo shfuqizohen si ligje që janë në kundërshtim me Kushtetutën. Vendimet e kësaj paraqesin burime të tërthorta të së drejtës kushtetuese, sepse përmes kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit ndikon në orientimin dhe përmbajtjen e ligjeve që miratohen nga ana e Kuvendit.²⁸

Gjykata Kushtetuese që nga fillimet e para të saj u krijua për të mbrojtur kushtetutën dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit nga shkeljet e shkaktuara nga ana e organeve shtetërore. Gjykata Kushtetuese nuk duhet llogaritur si pushtet i katërt në kuadër të pushtetit shtetëror dhe të jetë superior nga të tre pushtetet tjera, por duhet të kufizohet vetëm në mbrojtje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe nuk duhet të ndërhyjë në kompetenca të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv.²⁹

- Në RVM duhet që në kuadër të Kushtetutës të intervenohet me amandament kushtetues në pjesën e kapitullit IV ku organizohet puna e Gjykatës Kushtetuese. Të sjellet ligj nga Kuvendi i RMV-së për Gjykatën Kushtetuese e jo vetëm të rregullohet puna me anë të Rregullores . Në kuadër të ligjit duhet të ndryshohet forma e propozimit dhe emërimit të gjyqtarëve kushtetues. Të ketë kujdes në përfaqësimin gjinor dhe të përfshihen bashkësitë jo shumicë në propozim dhe emërim dhe në rastë të votimit të përfshihet forma e votimit të dyfishtë sikur në Kuvend -me Badenter.

Për rolin e Gjykatës Kushtetuese në Maqedoninë e Veriut në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarit, profesori i Drejtës Kushtetuese Jeton Shasivri në revistën „ACTA UNIVERSITATIS DANUBIUS “ mes të tjerash shkruan :

²⁷ Shasivari, Jeton, E drejta kushtetuese, .Shkup, 2020 Furkan ISM , fq. 387-388 , Cituar nga : Deskovska,Dr. Renata „The Constitutional Court in the RM: Arbitrary interpretation of its Competencies-On the occasion „ the case ofDissolution of the Parliament “, Law Review „Iustinianus Primus” Volume 7 Issue2,2016, Skopje,p 8-9; dhe „Уставен суд: Одложено распуштање на Собранието не исто со одложено дејство на законите“,01.06.2016,Правдико, në dispozicion në linkun:<https://www.pravdiko.mk/ustaven-sud-odlozheno-raspushtane-na-sobranieto-ne-e-isto-so-odlozheno-na-zakonite/>.

²⁸По ату, fq 389 Cituar nga : Стојановић,Др.,Драган,Уставно право,Књига I ,Ценат за публикација Правног факултет у Нишу ,Ниш 1999,стр.43.

²⁹ По ату. gq. 389 Cituar nga : Николћ Др., Павле , Уставно право, Пословно биро,д.о.о. Београд,1997, стр 370,

„ Sipas nenit 50 të Kushtetutës, çdo qytetar mund të kërkojë mbrojtje të lirive dhe të drejtave të garantura me Kushtetutë para gjykatave të rregullta, si dhe para Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut, përmes një procedure të rregullt bazuar në parimet e përparsisë dhe urgjencës. Mbrojtje gjyqësore nga aktet individuale të administratës shtetërore, si dhe institucioneve tjera që kryejnë punë publike. Një qytetar ka të drejtë të informohet për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit si dhe obligohet të kontribojë në ruajtjen e atyre vlerave. Sipas nenit 54 të Kushtetutës ,liritë dhe të drejtat e individit dhe qytetarëve mund të kufizohen vetëm në rast të përcaktuar me Kushtetutë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme apo gjendjes së lutës. Kufizimi i të drejtave dhe lirive nuk mund të diskriminohet në bazë të gjinisë, racës , gjuhës , fesë, origjinës kombëtare ,pasurisë ose statusit shoqëror. Kufizimi i lirive dhe të drejtave nuk mund t'i cenohet njeriut në të drejtën e jetës, torturim fizik dhe psikik, sjellje poshtërues dhe ç' njerëzore, si dhe për lirinë e bindjes personale, të ndërgjegjes, lirinë e shprehjes së mendimit dhe bindjeve fetare".³⁰

Në vazhdim do të japim të dhëna nga Raporti Gjykatës Kushtetuese për vitin 2019 të marrura nga faqja zyrtare :

Të dhëna nga numri i përgjithshëm i çështjeve dhe llojet e akteve të gjykatës me të cilat zgjidhen çështjet

Në periudhën nga **1 janarit gjerë më 31 dhjetor 2019**, Gjykata trajtoi **238 raste**. Nga këto, **167** janë pranuar gjatë vitit 2019 dhe **71** janë raportuar si të papërfunduara nga vitet e kaluara.

Nga numri i përgjithshëm i rasteve në punë gjatë këti vitit **114 raste kanë përfunduar** dhe **124 raste kanë mbetur të papërfunduara**.

TABELA 1:

LËNDË TË PRANUARA

Sipas paraqitësit së iniciativave:

<i>Paraqitës të iniciativave</i>	<i>numri i lëndëve</i>
Qytetarë	135
Partitë politike	2
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut	/

³⁰Për më shumë shih në <http://journals.univ-danubius.ro/index.php/juridica/article/view/5522>

Ndërmarrjet, organizatat tjera dhe komunitet	2
Organet e vetëqeverisjes lokale	7
Shoqata të qytetarëve	10
Gjykata Kushtetuese	/
Subjektje të tjera	11
GJITHËSEJ	167

TABELA 2:

Lëndë të pranuar sipas llojit të aktit kontestues

<i>Lloj i aktit kontestues</i>	<i>numri i lëndëve</i>
Ligje	95
Statute	1
Marrëveshje Kolektive	2
Rregullore të Qeverisë dhe të ministrive	9
Akte të Kuvendit të RMV-së	7
Akte të Vetëqeverisjes lokale	22
Akte individuale - mbrojtja e lirive dhe të drejtave	19
Akte të ndërmarrjeve	1
Akte nga shërbimet publike	/
Akte nga partitë politike	/
Akte nga Presidenti i Republikës	/
Akte të tjera	11
GJITHËSEJ	167

TABELA 3:

Lëndë të pranuar sipas llojit të juridiksionit të Gjykatës dhe sipas fushës juridike të aktit kontestues

<i>Lloji i juridiksionit i Gjykatës Kushtetuese</i>	<i>numri i lëndëve</i>
I. Vlerësimi i Kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë	126

1. Mbrojta, siguria dhe punët e brendëshme	2
2. Punët e jashtme	/
3. Financa, taksa, tatime dhe tarifat e tjera publike	8
4. Ekonomi	7
5. Ndërmarrjet publike, institucionet publike dhe institucionet që ushtrojnë autoritete publike	1
6. Organe dhe autoritetet shtetërore : Parlamenti, Presidenti i Republikës , Qeveria dhe administrata publike, Sistemi gjyqësor (gjykatat, Këshilli Gjyqësor Republikan, prokuroria, Avokati i shtetit, notaritë, avokaturat ,përmbaruesit) dhe Avokati i Popullit	45
7. Zgjedhjet, Referendumi, Partitë politike, Shoqata dhe fondacione të qyteterëve dhe tubime publike	2
8. Të drejta dhe liri fetare	/
9. Të drejtat e të huajve	/
10. Marrëdhëniet pronëso-ro-juridike	2
11. Urbanizëm dhe ndërtimitari	14
12. Trafiku dhe lidhjet	2
13. Mjedis jetësor	1
14. Marrëdhëniet e punësimit	15
15. Sigurimi pensional dhe invalidor	3
16. Sigurimi i fondit shëndetësor	5
17. Marrëdhëniet në bashkësi familjare	2
18. Arsimit, shkencë dhe kulturë	7
19. Informim publik	1
20. Pushteti lokal	7
21. Shërbime komunale	/
22. Të tjera	19
II. Kërkesa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirve	19
III. Konflikt për kompetenca	1
IV. Përgjegjësi e Presidentit të Republikës	/

V. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të programeve dhe statuteve të partive politike dhe shoqatave të qytetarëve	/
VI. Kompetenca të tjera të Gjykatës Kushtetuese	4
GJITHËSËJ	167

TABELA 4:

LËNDË TË ZGJIDHURA

Vendime të zgjidhura sipas llojit të aktit të Gjykatës me të cilën përfundon procedura:

Lloj i aktit që përfundon procedura

numri i lëndëve

Aktvendim për shfuqizim	8
Aktvendim për anulim	/
Aktvendim për refuzim	1
Aktvendim për të përcaktuar	1
Vendim për mos fillim të procedurës	40
Vendim për refuzim të iniciativës/kërkesës	60
Vendim për ndërprerje të procedurës	1
Përfundim administrativ (Regullor. Neni 13,15,16)	2
Lëndë të përfunduara në mënyra tjera	1
GJITHËSËJ	114

TABELA 5:

Lëndë të zgjedhura ku ligjet ishin të kontestuar:

<i>Lloj i aktit që përfundon procedura</i>	<i>numri i lëndëve</i>
Me aktvendim për shfuqizim	3
Me aktvendim për anulim	/

Me vendim për mosfillim të procedurës	28
Me vendim për të hedhur poshtë iniciativën	32
Me vendim për ndalim të procedurës	/
Përfundim administrativ	2
GJITHËSËJ	65

TABELA 6:

Lëndë të zgjidhura në të cilat u kundërshtuan rregulloret dhe aktet e tjera të përgjithshme:

<i>Lloj i aktit kontestues</i>	<i>numri i lëndëve</i>
Statute	2
Marrëveshje kolektive	1
Rregullore	9
Aktet e njësive të vetëqeverisjes lokale	14
Tarifa	1
Aktvendime	5
Akte tjera (Rregullat, Kushtet, Udhëzime, Përfundime, Vendime etj.)	9
GJITHËSËJ	41

<i>Mënyra e përfundimit të procedurës</i>	<i>numri i lëndëve</i>
Me aktvendim për revokim	5
Me aktvendim për anulim	/
Me vendim për mos fillim të procedurës	11
Me vendim për hedhje poshtë të iniciativës	23
Me vendim për ndërprerje të procedurës	1
Përfundim administrativ	1
GJITHËSËJ	41

31

³¹Të dhënat dhe përpunimet tabelare janë marrur nga web faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese të Maqedonis së Veriut në pjesën e Raporteve vjetor , Raporti i vitit 2019 , në linkun: <http://ustavensud.mk/?p=18959>

KAPITULLI I DYTË

2. GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

2.1 Historiku dhe krijimi i Gjykatës Kushtetuese

Si Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Kosovës kanë trashëguar të njëjtin sistem, sepse ishin pjesë përbërse e ish- Federatës Jugosllave, por këtu kemi një dallim se Kosova ishte Krahinë Autonome me Kushtetutën e vitit 1974 kurse RMV-ja ishte me status të republikës.³²

Shikuar nga aspekti historik Kosova si njësi e ish -RSFJ-së ka aplikuar kontrollin e kushtetutshmërisë nëpër mes të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata e parë Kushtetuese në ish -RSFJ u aplikua më vitin 1963, kurse në Kosovë aplikimi i kontrollit kushtetues u aplikua më vitin 1969 për shkak të rethanave ideopolitike. Në këtë vit me ligjin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës fillimisht ishte krijuar dega Gjyqësore Kushtetuese pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.³³

Në vitin 1972, Kuvendi i atëhershëm i Kosovës miratoi amandamentin nr. X në Ligjin Kushtetues të Kosovës, i cili themeloi Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Kjo bëri të mundur që kolegji për çështje kushtetuese i Gjykatës Supreme të Kosovës të transformohet në Gjykatë Kushtetuese të Kosovës, edhe me Kushtetutën Federative të ish- RSFJ-së të vitit 1974 ishte përcaktuar po ashtu edhe me Kushtetutën e Kosovës të të njëjtit vit si organ që kishte kompetenca për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, shprehimisht duke përcaktuar „ të gjitha ligjet e dispozitat tjera dhe aktet e përgjithshme të organeve të bashkësive shoqërore – politike, si dhe aktet e përgjithshme vetëqeverisëse duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën “³⁴

Gjykata Kushtetuese përbëhej nga Kryetari dhe gjashtë (6) gjyqëtarë që zgjidheshin nga Kuvendi i Kosovës në një mandat tetë (8) vjeçar pa të drejtë rizgjedhje.³⁵ Kjo Gjykatë kishte kompetenca për të vendosur lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve krahinore dhe statuteve të komunave me Kushtetutën dhe ishte kompetente për të vendosur në zgjedhjen e kompetencave në mes të organeve krahinore dhe komunave në territorin e Kosovës si dhe konfliktin e dy apo më shumë komunave.³⁶

Më 23 mars 1989 nga një fushatë brutale politike dhe policoro-ushtarake nga ana e regjimit të Serbisë të udhëhequr nga „kasapi i ballkanit" Slobodan Millosheviç u bë suprimimi i autonomisë

³² Për më tepër shih : USTAV SFRJ IZ 1974, DEO PRVI , ČLAN 2 ,apo në linkun <http://mojustav.rs/wp-content/uploads/2013/04/Ustav-SFRJ-iz-1974.pdf>

³³ Për më tepër shih në wëp faqen zyrtare të Gjyktës Kushtetuese të Kosovës e arritshme në linkun <https://gjk-ks.org/gjykata-kushtetuese/historiku/>

³⁴ Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017,fq 105-106 ,Cituar nga : Kushtetuta e Kosovës ,neni 234

³⁵ Po aty , ,Cituar nga : Kushtetuta e Kosovës ,neni 377

³⁶ Po aty , ,Cituar nga : Kushtetuta e Kosovës ,neni 372

kushtetuese të Kosovës dhe me këtë edhe puna e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe organeve tjera u suprimuan.³⁷ Ndaj këtij agresioni kushtetues, përfaqësuesit legjitimi të Kosovës ju kundërpërgjigjën Serbisë me miratimin e Deklaratës për shpalljen e Kosovës Republikë më 2 korrik 1990 dhe miratimin e Kushtetës së Kosovës në Kaçanik e njohur si Kushtetuta e Kaçanikut më 7 shtator 1990. Kjo Kushtetutë kishte përcaktuar krijimin e Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.³⁸

Nga lufta dhe përpjekjet shumë shekullore të kombit Shqipëtar doli në skenë Ushtria Çlirimtare e Kosovës si forcë e vetme për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës pas intervenimit të Paktit Veriatlantik - NATO- së më 24 mars 1999 edhe deri te kapitullimi i forcave Jugosllave dhe hyrja e forcave të NATO-së më 10 qershor 1999 dhe u hap rruga për krijimin e shtetit më të ri në Evropë REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi *Rezolutën 1244 më 10 qershor 1999*, e cila autorizoi një prani civile ndërkombëtare në Kosovë në mënyrë që të vendos një administratë të përkohëshme për Kosovën deri në zgjidhjen përfundimtare të statusit politik të Kosovës. Nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të institucionit vendor të vet-qeverisjes gjatë hartimit të Kornizës Kushtetuese, u shtrua nevoja për themelimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës . Kjo Kornizë Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme u miratua në vitin 2001 ku kishte përcaktuar organet kryesore të shtetit. Kuvendi ishte organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës, Kryetari i Kosovës përfaqëson unitetin e popullit dhe garanton funksionimin demokratik të institucioneve, Qeveria ishte përcaktuar të ushtroj pushtetin ekzekutiv dhe zbatimin e ligjeve të miratuar nga Kuvendi. Mirëpo propozimi për krijimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ishte refuzuar me arsyetimin se tejkalon frymën dhe kufizimet e përcaktuara me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit ku sipas UNMIK-ut ajo reflekton attribute të shtetësisë së Kosovës dhe në këtë mënyrë prejudikohet statusi përfundimtar i Kosovës ³⁹

Në kuadër të Gjykatës Supreme krijohet Kolegji i veçantë për mbrojtjen e Kornizës Kushtetuese. Ky Kolegj vihej në lëvizje sipas kërkesës së Kryetarit të Kosovës, çdo anëtar i kryesis së Kuvendit, çdo

³⁷ Për më tepër shih „ Ligjin mbi Ndërrprerjen e punës së Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSA të Kosovës të datës 13.06.1990

³⁸ Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017, fq. 106.

³⁹ Po aty ,fq 107 Cituar: Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 ,mundësoj vendosjen e Misionit Ndërkombëtarë të Kombeve të Bashkuara në Kosovë . Ky mision ishte i ndarë në katër shtylla dhe ishte përgjegjës për rivendosjen e shëndetit ,edukimit dhe shërbimeve publike , ushtrimin e funksioneve të policisë në afat të shkurtër dhe zhvillimin e Shërbimit Policor të Kosovës në afat të gjatë ,rindërtimin e sistemit gjyqësor dhe korrektues . Në anën tjetër OSBE-së ndërmori detyrat e nxitjes së demoratizimit dhe të drejtave të njeriut, si dhe ndërtimin e kapaciteteve në këto fusha. UNHCR-ja mori përgjegjësin për koordinimin e ndihmës humanitare për shumë kosovarë të zhvendosur kurse BE-ja mori përgjegjësin për punët e rindërtimit ekonomik ,duke përfshirë koordinimin e ndihmës ndërkombëtare financiare dhe riorganizimin e tregtisë ,monedhës dhe çështjet bankare.

Komision të Kuvendit , jo më pak se pesë (5) deputetë të Kuvendit dhe të Qeverisë, kishte kompetenca që ligjet e miratuara nga Kuvendi të jenë në përputhshmëri me Kornizën Kushtetuese, vendoste për mos marrëveshjet ndërmjet institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes ose ndërmjet komisioneve të Kuvendit.⁴⁰ Ky Kolegj asnjëherë nuk u funksionalizua.

Më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë dhe kjo i parapriu bisedimet dhe në vitin 2007 në bisedimet e Vjenës përfaqësuesi special i OKB-së z. Maatii Athisaari e dha verzionin final për Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës .⁴¹

Kuvendi miratoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës më 9 prill 2008 ku në kapitullin e VIII ka përcaktuar se Gjykata Kushtetuese është autoritet përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe ka specifikuar rrethin e subjekteve të autorizuar për të vënë në lëvizje një proces të kontrollit kushtetues. Kapitulli VIII i Kushtetutës u implementua me miratimin e *Ligjit nr.03/1-121* për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 16 dhejtor 2008, ku rregullohen organizimi dhe funksionimi i Gjykatës Kushtetuese, procedurat për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave kushtetuese, kushtet dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve kushtetues dhe parimet themelore procedurale lidhur me procedimin e një kërkesë kushtetuese.⁴²

2.2 Përbërja, organizimi dhe funksionimi i Gjykatës Kushtetuese

Neni 112 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mënyrë të prerë ka vendosur se:

*„ Gjykata Kushtetuese është autoritet përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe kontrollin e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën”*⁴³

Ky nen i Kushtetutës e vendos Gjykatën Kushtetuese në pozitën më të lartë të hierarkisë institucionale lidhur me interpretimin kushtetues dhe cilido organ shtetëror që mund të ketë bërë interpretimin kushtetues për të ushtruar një funksion të tij mund të konsiderohet „ përfundimisht i përcaktuar” vetëm pasi Gjykata Kushtetuese të ketë dhënë vendimin përfundimtar lidhur me çështjen interpretative.⁴⁴

Cituar nga ish-Kryetari i Gjykatës dhe profesori Enver Asani ku thotë: „Gjykata Kushtetuese nuk është interpretues ekskluziv i kushtetutës. Interpretimi i kushtetutës ndodh në çdo sekond të jetës

⁴⁰Korniza Kushtetuese për Vetqeverisje të Përkohshme ,2001. Neni 9.4.11 . për më tepër në : http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/FrameworkPocket_ALB_Dec2002.pdf

⁴¹Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017,fq 108

⁴²Po aty, fq. 109

⁴³Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 112 par. 1

⁴⁴Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017,fq 110. Cituar nga : Enver Hasani dhe Ivan Čukalović. " Komentar- Kushteuta e Republikës së Kosovës” (2013) fq. 619

institucionale për atë kohë sa institucionet i shkarkojnë detyrimet e tyre, të cilat juridikisht rrjedhin nga kushteuta. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese „ka autoritet ekskluziv institucional sa i përket filtrit të fundit të interpretimit kushtetues.”⁴⁵ Është detyrim kushtetues që organet shtetërore sikur që i nënshtrohen vullnetit të Kuvendit me rastin e zbatimit të ligjeve, po ashtu edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese konsiderohen finale dhe të pa apelueshme brenda sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 114 të Kushteutës të Republikës së Kosovës definohet përpërja dhe mandati i Gjykatës Kushtetuese. *Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë, të cilët do të jenë juristë të shquar dhe personalitete me moralin më të lartë, jo me më pak se dhjetë (10) vjet përvojë profesionale përkatëse. Kualifikimet e tjera përkatëse rregullohen me ligj. Parimet e barazisë gjinore do të respektohen.*⁴⁶ Propozimi për gjyqtarët bëhet nga ana e Kuvendit, kurse emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës me mandat nëntë (9) vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje.

Kushtetuta ka vendosur një sistem të kombinuar të zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues, në të cilën pushtet për të zgjedhur gjyqtarët kushtetues ndahet në mes Kuvendit si organ përfaqësues në një anë dhe Presidentit të Republikës si pushtet neutral dhe garantues i funksionimit kushtetues të institucioneve në anën tjetër. Ky sistem përfshin zgjedhjen e kandidatit nga Kuvendi që përbën dimensionin zgjedhor dhe siguron legjitimitimin e kandidaturës në pikëpamje demokratike dhe aktin e dekretimit nga Presidenti i Republikës pas miratimit të kandidaturës nga Kuvendi. Vendimin për të propozuar shtatë (7) nga nëntë (9) gjyqtarët Kuvendi e merr me 2/3 të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, kurse për dy (2) gjyqtarë vendimi merret me shumicën e votave të deputetëve, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, pas sigurimit të pëlqimit të shumicës të atyre deputetëve që mbajnë vende të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në Kosovë.⁴⁷

Gjykata Kushtetuese përmes aprovimit parlamentar të kandidaturave mund të konsiderohet si e mirëqenë. Në praktikë kjo formulë e zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues është përballur me sfida të konsiderueshme për shkak se Kuvendi si organ i përbërë nga përfaqësues të zgjedhur nga partitë e ndryshme politike në Kosovë disa herë ka dështuar në marrjen e vendimeve konsesuale për zgjedhjen e kandidatëve për pozitata vakante në Gjykatën Kushtetuese, ku nuk ka dilema se ky vepërim mund të vë në rrëzik serioz pavarësimin, punën dhe funksionimin e kësaj Gjykate.⁴⁸

⁴⁵Po aty, fq 110 Ciatuar : Enver Hasani dhe Ivan Čukalović. " Komentar- Kushteuta e Republikës së Kosovës" (2013) fq. 620

⁴⁶Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 114 ,par. 1

⁴⁷Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 114 ,par. 3

⁴⁸Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017,fq 114-115

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është e udhëhequr nga Krytari dhe Zëvendëskryetari ,të cilët zgjedhen nga vetë gjyqtarët e Gjykatës me votim të fshehtë për mandat tre (3) vjeçar . Kryetari i Gjykatës Kushtetuese koordinon aktivitetet e Gjykatës, thërret dhe drejton seancat verbale, përfaqëson Gjykatën Kushtetuese, nënshkruan aktet e Gjykatës Kushtetuese dhe kryen detyra tjera të përcaktuara me ligj apo me Rregulloren e punës së Gjykatës. Zëvendëskryetari ushtron detyrat kur mungon Krytari apo për çfarëdo arsye nuk është në gjendje të ushtroj detyrën e tij. Kryetari mund t'i delegojë Zëvendëskryetarit edhe disa detyra tjera të caktuara për të mbështetur Kryetarin në ushtrimin e punëve të tij.⁴⁹ Gjyqtarët kushtetues në punën e tyre kanë mbështetje edhe nga ana e këshilltarëve ligjorë, ku bëjnë hulumtime ligjore dhe analiza juridike. Këshilltarët emërohen me shumicën e thjeshtë të votave të gjyqtarëve dhe që votojnë gjatë seancës administrative duke u bazuar në një proces transparent të hapur dhe konkurrues e përzgjedhjes.⁵⁰

Në bazë të Kushtetutës së Kosovës është përcaktuar dhe garantuar pavarësia organizative dhe financiare e Gjykatës Kushtetuese, ku gjyqtarët gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkim nga detyra për vendimet e marra, mendimet e shprehura dhe veprimet e marra në kuadër të fushës së përgjegjësisë si gjyqëtar kushtetues.⁵¹

Në bazë të nenit 118 të Kushtetutës shumë qartë precizohet shkarkimi i gjyqtarëve kushtetues: „ Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vetëm për kryerjen e krimeve të rënda ose për mospërfillje të rëndë të detyrave. “⁵² Mirëpo edhe në bazë të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese janë përcaktuar kufizime për gjyqtarët për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e procesit kushtetues, ku nuk mund të jenë anëtarë të partive politike , anëtarë në borde drejtuese të ndërmarrjeve publike, shoqërive tregëtare ose organizatave jo-qeveritare. Gjyqtarët nuk mund të ushtrojnë detyrë apo profesion me pagesë, por mund të jenë ligjerues të shkencave juridike në ndonjë universitet të akredituar.⁵³

Mekanizëm i rëndësishëm është pavarësia buxhetore që ka Gjykata Kushtetuese. Fillimisht përgatisin projektbuxhetin vjetor dhe e dërgojnë në Kuvend për votim dhe aprovim. Në bazë të ligjit (Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës,2008/03-121), ekzekutivi nuk mund të intervenojë dhe të

⁴⁹Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ,2008/03-121, neni 11. për më shumë Ligji në fjalë është i arritshëm në linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2614>

⁵⁰Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017,fq. 115 Citar nga : Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ,neni 18 , për më shumë Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese në linkun :<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=16599>

⁵¹Po aty

⁵² Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 118

⁵³ Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ,2008/03-121, neni 5

ndryshojë asnjë lloj tjetër modifikimi në buxhet që është propozuar nga ana e Gjykatës dhe këtu kemi një pavarësi të plotë financiare. Buxheti i propozuar përfshihet në tërësi në propozimin për Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës që i paraqitet Kuvendit për miratim .

Pavarësia buxhetore është instrument shumë i rëndësishëm, sepse mbrohet nga ndërhyrjet eventuale në propozimin e buxhetit për vitin paraprak ose nga ndërhyrjet eventuale në lidhje me shpenzimin e buxhetit. Pavarësia buxhetore i mundëson një funksionim të pavaruar me këtë mbrohet nga çdo ndërhyrje eventuale.

Sipas modelit kelzian Gjykata Kushtetuese nuk bën pjesë në oborrin e pushtetit gjyqësor dhe nuk ka lidhje organike apo strukturore në mes të gjykatave të rregullta në kuadër të sistemit gjyqësor dhe Gjykatës Kushtetuese⁵⁴ Një tipar dallues i kësaj Gjykate me gjykatat e rregullta është profili dhe përvoja e gjyqtarëve kushtetues ku nuk vijnë domosdoshmërisht nga gjyqësori, por nga „ një popullatë më e gjërë duke përfshirë avokatë dhe studiues të shquar ligjorë “. ⁵⁵

Një qasje të ngjajshme e ndjek edhe Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ku gjyqtarët kushtetues duhet të jenë juristë të shquar me reputacion të shkëlqyeshëm profesional me jo më pak se dhjetë (10) vjet përvojë pune profesionale, veçanarisht në fushën e së drejtës publike dhe kushtetuese të dëshmuar përmes punës profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, shërbyes civil ose mësimdhënës universitar. ⁵⁶

Ka edhe dallime të tjera në emërimin e gjyqtarëve kushtetues dhe gjyqtarëve të rregullt. Gjyqtarët kushtetues zgjedhen nga Kuvendi dhe dekretohen nga Presidenti i Republikës, kurse gjyqtarët e rregullt propozohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe dekretohen nga Presidenti i Republikës dhe kohëzgjatja në detyrë dallon se anëtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë mandat nëntë (9) vjetë, kurse gjyqtarët e rregullt pas emërimit të tyre janë në detyrë deri në pensionim.⁵⁷

2.3 Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese me theks në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit

Gjykata Kushtetuese është kompetente për interpretimin dhe mbrojtjen e kushtetutshmërisë.

⁵⁴Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017,fq. 110-111 Citar nga: . Mushkolaj, Gjyljeta; Morina, Visar; Johan van Lamoën, PhD., Commentary LCC Law on the Constitutional Court of the Republic of Kosovo, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) Pristina, 2014. fq 43

⁵⁵Po atz Cituar nga : John Ferjohn dhe Pasquale Pasquino. “ Constitutional adjudication : lessons from Evrope” Tex.L.Rev82 (2003):1671

⁵⁶Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ,2008/03-121, neni 4. për më shumë Ligji në fjalë është i arritshëm në linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2614>

⁵⁷Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 105

Juridiksioni është i gjërë dhe i përcaktuar në neni 64 , 91 dhe 113 të Kushtetutës së Kosovës ⁵⁸ dhe me ligje të veçanta për shembull Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. ⁵⁹ Juridiksioni i Gjykatës është zgjeruar më tej me miratimin e Amandamentit kushtetues nr. 24, i cili ka përcaktuar formimin e një dhome të Specializuar të Gjykatës Kushtetuese e përbërë nga tre (3) gjyqëtarë ndërkombëtarë të emëruar shtes krahas gjyqtarëve të referuar sipas nenit 114 par. 1 të Kushtetutës .

Kjo dhomë do të vendos ekskluzivisht mbi referimet kushtetuese në lidhje me dhomat e specializuara dhe me Zyrën e Prokurorit Special në përputhje me legjislacionin në fuqi.⁶⁰

Në vijim do të analizojmë kompetencat e Gjykatës në bazë të një tipologjie të mbështetur në veçoritë e kontrollit kushtetues dhe jo thjeshtë në përshkrim tekstual të Gjykatës .

2.4 Kontrolli abstrakt i kushtetueshmërisë

Gjykata Kushtetuese e bazuar në bazë të modelit kelzian ushtron kontroll abstrakt të kushtetueshmërisë me rastin e verifikimit të përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit të Republikës dhe të Kryeministrit, rregulloreve të Qeverisë me Kushtetutën. Qëllimi i kësaj procedure të inicimit para Gjykatës nga rrethi i subjekteve ka për qëllim parësor mbrojtjen e së drejtës objektive, rendit juridik dhe kushtetues dhe jo ndonjë të drejtë të veçantë subjektive siç e kemi te format e kontrollit konkret kushtetues. Kemi kontroll abstrakt edhe kur shqyrtohet përputhshmëria e statutit të komunës me Kushtetutën e Kosovës. ⁶¹

Në bazë të nenit 113 par. 2 kërkesën për kontroll abstrakt përpara Gjykatës Kushtetuese janë një grup i vogël i organeve shtetërore që përfshin një rreth shumë të ngushtë institucionesh, tre prej të cilëve janë aktërë politikë institucional, përderisa vetëm njëri është aktër institucional i pavarur dhe jo politik. Këta kanë të drejtë të parashtrojnë: *një e katërta (1/4) apo tridhjetë (30) e më shumë deputetëve të Kuvendit, Presidentit të Republikës, Qeverisë dhe nga Avokati i Popullit* ⁶²

Në bazë të këtij neni të Kushtetutës individët nuk kanë të drejtë të kontestojnë në mënyrë direkte kushtetueshmërinë e ligjeve, statutit të komunës, direktivave të Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe Rregulloreve të Qeverisë përpara Gjykatës në bazë të modelit të *padisë popullore (actio popularis)*. Kontestimin e këtyre akteve, individët mund ta realizojnë në mënyrë të tërthortë,

⁵⁸Po aty ,Nenet 61par. 4 , 91 par 1,2,3 dhe 113

⁵⁹Për më shumë shih Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale (neni 64) në linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2530>

⁶⁰Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017,fq 117 Cituar nga :Amandamenti Nr 24 i Kushtetutës së Kosovës ,05-V-139,05.08.2015

⁶¹Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 113 par. 2

⁶²Po aty

duke shfrytëzuar mekanizmin e Avokatit të Popullit ose Presidentit të Republikës si garantues për funksionimin kushtetues të organeve shtetërore.

Bazuar në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, kontestimin e kushtetuetushmëris së këtyre akteve palët e autorizuar mund ta bëjnë brenda afatit prej gjashtë (6) mujave nga data në të cilën akti i kontestuar ka hyrë në fuqi. Ky afat do t'i japë palës së autorizuar kohë të mjaftueshme për të përgatitur siç duhet kërkesën, por do të ishte më e preferueshme (për hir të sigurisë ligjore), në qoftëse ata do të marrin më pak kohë dhe do të angazhojnë Gjykatën sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që akti i kontestuar – nëse kontestohet të jetë jo kushtetues – të jetë në fuqi vetëm për periudhën më të shkurtër të mundshme.⁶³ Gjykata Kushtetuese me kërkesë të palës apo në mënyrë zyrtare -ex officio mund të suspendojë aktin ose ligjin e kontestuar dhe të vendos një masë të përkohshme deri sa të merret vendimi përfundimtar me qëllim të shmangies së efekteve të padëshirueshme që përbëjnë dëme të pariparueshme, ose nëqoftë se do të jetë në interes të publikut.⁶⁴

Nëqoftëse zvogëlohen të hyrat e komunës dhe cenohet përgjegjësia komunale nga ana e Qeverisë, komuna është e autorizuar të kontestoj kushtetuetshërinë e ligjeve apo akteve përkatëse para Gjykatës Kushtetuese në rast se është prekur nga ai akt. Në bazë të Kushtetutës komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimarrjes së organeve komunale që në bazë të kompetencave të lartëpërmendura ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të garantuara kushtetuese në rast se autonomia lokale e garantuar me Kushtetutën e Kosovës dhe me Kartën Evropiane për Qeverisje Lokale vihet në pikëpyetje si pasojë e masave legislative ose administrative të organeve të pushtetit shtetëror.⁶⁵

Në bazë të nenit 62 të Kushtetutës së Kosovës komunitetet pakicë kanë qasje të drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese ku Zëvendëskryetari për komunitete ka të drejtë të kontestojë çdo vendim të komunës në qoftëse konsideron se ai akt apo vendim përbën shkelje të drejtave të garantuara me Kushtetut.⁶⁶

Në bazë të nenit 113 par. 5, dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit brenda një afati tetë (8) ditësh nga data e miratimit kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfardo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi si për nga përmbajtja, ashtu edhe për nga procedura e ndjekur. Një

⁶³Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017, fq 118. Cituar nga : Enver Hasani dhe Ivan Čukalović. " Komentar- Kushteuta e Republikës së Kosovës" (2013) fq. 630

⁶⁴Po aty ,Cituar :nga Mushkolaj, Gjyljeta; Morina, Visar; Johan van Lamoën, PhD., Commentary LCC Law on the Constitutional Court of the Republic of Kosovo, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) Pristina, 2014. fq 284

⁶⁵Po aty ,fq 118-119

⁶⁶Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 62

ligj apo vendim i dërgohet Presidentit të Republikës për shpallje vetëm pas mbarimit të afatit tetë (8) ditor nga dita e miratimit kur në realitet pushon e drejta subjektive inicuese të kontrollit kushtetues për të proceduar me këtë kërkesë kushtetuese. Nëse kontestohet në bazë të nenit 113 par. 5, ligji apo vendimi mund të shpallet vetëm pasi Gjykata Kushtetuese të jetë deklaruar me vendim final, mirëpo për shkak të natyrës urgjente ajo është e detyruar të nxjerrë vendim mbi kontestin jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas dorëzimit të kërkesës.⁶⁷ Kjo procedurë e referimit kushtetues është dizajnuar që të jetë në funksion të mbrojtjes së interesave të minoriteteve të përfaqësuara në Kuvend, mirëpo është përdorur edhe nga deputetët e pakicave, por edhe nga deputetët e Kuvendit që e përbëjnë shumicën në shumë raste të jetës parlamentare.

Në Komentarin e Kushtetutës së Kosovës, prof Enver Hasani mes tjerësh shkruan se: „*Referimi kushtetues përbën një hapësirë shumë të gjërë juridiksionale përmes të cilës mund të kontrollojë çdo vendim të Kuvendit, ku çdo veprim i Kuvendit që prodhon pasoja juridike (të përgjithshme apo individual), qoftë i lëshuar në formë të shkruar apo të pashkruar, mund t'i nënshrohet kontrollit kushtetues*“.⁶⁸ Referuar nenin 113 par. 5 të Kushtetutës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese përbën një filtër tejet efikas për të vlerësuar vendimarrjen e Kuvendit, jo vetëm kur ushtron pushtet legjislativ, por edhe pushtet zgjedhor apo mbikëqyrës. Këto konsiderohen tipike për demokracitë parlamentare.

2.5 Kontrolli kushtetues i projekt-amendamenteve kushtetuese

Kushtetuta e Kosovës sikur se dhe kushtetutat e disa shteteteve, Kushtetuta e Turqisë (1982), Kushtetuta e Kilit (1980) dhe Kushtetuta e Rumanisë (1991 e plotsuar me amndamente në vitin 2003), hyjnë në grupin e kushtetutave që kanë përcaktuar shqyrtimin e amendamenteve kushtetuese nga ana e Gjykatës Kushtetuese, një kompetencë që fuqizon mjaft rolin e Gjykatës ndaj Kuvendit.

Kemi dy procedura të veçanta që zhvillon Gjykata me rastin e kontrollit kushtetues. Njëra procedurë ushtrohet *a priori* apo paraprake ku procedura vihet në lëvizje sipas detyrës zyrtare bazuar në nenin 113 par. 9 të Kushtetutës. Obligohet që të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit të tyre në Kuvend me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin e II të Kushtetutës.⁶⁹

⁶⁷Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, 2008/03-121, neni 43,

⁶⁸Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017, fq 121. Cituar nga : Enver Hasani dhe Ivan Čukalović. " Komentari- Kushteuta e Republikës së Kosovës" (2013) fq. 587

⁶⁹Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 113 par. 9

Në bazë të nenit 113 par. 3 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese është kompetente edhe për shqyrtimin e përputhshmërisë së një amandamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare dhe të bëjë rishikimin e kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur. Ka disa veçori të sistemit të kontrollit gjyqësor të projekt-amandamenteve kushtetuese në Kosovë, të cilët derivojnë nga dispozitat e lartpërmendura kushtetuese. Në bazë të nenit 113 par.9 dhe par.3 shqyrtimi i projekt amandamenteve kushtetuese mund të bëhet vetëm para miratimit të tyre në mënyrë paraprake – apriori, përmbajta e neneve kushtetuese reflekton një balancë në mes të konceptit për rishikimin e amandamenteve kushtetuese, përmes Gjykatës Kushtetuese dhe konceptit për kompetencë të pavarur të Kuvendit në fushën e miratimit të amandamenteve kushtetuese.⁷⁰ Kryetari i Kuvendit është i detyruar sipas Kushtetutës që të referojë projekt-amandamentet kushtetuese pas aprovimit nga Komisioni Parlamentar i ngarkuar për hartimin e amandamenteve kushtetuese që të verifikojë kushtetueshmërinë e tyre.

Sistemi i kontrollit kushtetues të amandamenteve kushtetuese konsiston në faktin se projekt-amandamentet kushtetuese mund të shqyrtohen në kuptimin përmbajtësor, por vetëm për sa i takon përputhshmërisë së tyre me liritë dhe të drejtat kushtetuese të garantura me Kapitullin II të Kushtetutës, kur Gjykata konfrontohet vetëm me pyetjen nëse dhe ç'masë mund të cenojnë projekt-amandamentet kushtetuese liritë dhe të drejtat kushtetuese të përcaktuara me kapitullin e lartëpërmendur kushtetues.⁷¹

Në jurispodencën e Kosovës kemi raste të parashtruara ku kërkohet vlerësimi nga ana e Gjykatës nëse projekt-amandamentet kushtetuese çenojnë këto të drejta, rasti K.O.29/12 dhe K.O 48/12, ku 31 deputet të Kuvendit propozuan amandament kushtetues ku Kryetari i Kuvendit e dërgoj në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim paraprak a pakësohen të drejtat dhe liritë të përcaktuar me Kapitullin e II.⁷²

2.6 Konflikti për kompetencë

Gjykata Kushtetuese e Kosovës siç thamë edhe më lartë është ndërtuar në bazë të modelit kelzian ku në kuadër të vetë e ka edhe zgjidhjen e konfliktit për kompetenca dhe institucionet si Kuvendi, Presidenti i Republikës dhe Qeveria janë të autorizuar në bazë të Kushtetutës të kërkojnë zgjedhjen e konfliktit për kompetenca. Kjo iniciativ ngrihet nga autorët e lartëpërmendur kur për

⁷⁰Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017, fq 122

⁷¹Po aty.

⁷²Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë në linkun: <https://gjk-ks.org/decision/amendamentet-e-propozuara-kushtetuese-t-dorzuara-nga-kryetari-i-kuvendit-t-republiks-s-kosovs-m-23-mars-2012-dhe-4-maj-2012/>

shkak të pretendimit të një organi për kompetencë kushtetuese që paraqet formën pozitive të konfliktit për kompetencë ose kur dy organe kushtetuese deklarojnë se janë jo kompetentë për të ushtruar një pushtet ose kompetencë kushtetuese lidhur me çështjen e caktuar.

Neni 31 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese thotë „ *Kërkesa e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 3 (1) të Kushtetutës parashtrohet nga cilado palë e autorizuar në konflikt ose nga cilado palë e autorizuar dhe që cenohet drejtpërdrejtë nga i njëjti konflikt. Kërkesa përmban çfardo informate të dobishme në lidhje me konfliktin e supozuar në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së Gjykatës Kushtetuese*”⁷³

Kërkesa kushtetuese për zgjidhjen e kompetencës parashtrohet brenda afatit gjashtë (6) muajor nga çasti i lindjes së konfliktit.⁷⁴ Lidhur me kontestin kushtetues për konflikt të kompetencave Gjykata Kushtetuese shqyrton dhe vendos lidhur me çështjen e kompetencës ose juridiksionit të organit, por nuk vendos lidhur me aspektin përmbajtësor (supstancial) të vendimit.

Kushtetuta lidhur me konfliktin për kompetencë në mes të gjykatave të rregullta nuk ia ka besuar Gjykatës Kushtetuese, por sipas ligjit për gjykata „Gjykata e Apelit është kompetente për të vendosur për konfliktin e juridiksionit ndërmjet gjykatave themelore.”⁷⁵

2.7 Kërkesa individuale dhe shkelja e Kushtetutës nga Presidenti i Republikës

Neni 113 par. 7 i Kushtetutës së Kosovës e precizon kërkesën individuale ku thotë: „*Individët janë të autorizuar të paraqesin shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*”⁷⁶ Kjo mbrojtje zbatohet përmes kërkesës individuale, ku çdo individ mund të referojë shkelje nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë pasi që të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Prof. Enver Hasani thotë: „ *Një kusht tjetër sipas nenit 113.7 është që parashtruesi në mënyrë që të autorizohet për të shfrytëzuar juridiksionin përkatës të Gjykatës, duhet që të jetë prekur nga një shkelje e një institucioni publik të shtetit. Me një fjalë, parashtruesi mund të iniciojë çështje individuale pranë Gjykatës, vetëm nëse ka interes të drejtpërdrejtë në të. Interesi i drejtpërdrejtë për*

⁷³Citar nga : Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ,2008/03-121, neni 31

⁷⁴Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ,2008/03-121, neni 32

⁷⁵Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017,fq 127 Citar : Ligji për Gjykatat Nr. 03/L-199, neni 18

⁷⁶Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 113 par 7

*çështjen sipas GjEDNj-së, vlerësohet të jetë atëherë kur parashtuesi është viktimë e një shkeljeje të një autoriteti publik.*⁷⁷

Termi „individ” duhet parë në kuptim të gjërë pasi jo vetëm personat fizikë, por edhe personat juridikë, siç mund të jenë organizatat tregëtare, fetare apo politike mund të referojnë çështje para Gjykatës Kushtetuese, nëse konsiderojnë se ndojnë prej të drejtave dhe lirive të përcaktuara me Kushtetutë janë cenuar nga autoritetet publike. Termi individ përfshin edhe shtetasit e huaj që kanë qëndrim të përkoshëm në Kosovë nëse argumentohet se janë viktimë në kuptimin e cënimit të të drejtave të garantuar me Kushtetutë.

Kriteret themelore për pranushmëri është shterimi i mjeteve juridike dhe këtë kriter duhet parë pikërisht në lidhje me natyrën subsidiare të kërkesës kushtetuese për t’ju dhënë mundësi individëve që pretendimet e tyre për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të garantuara t’i realizojnë në rrugë administrative dhe gjyqësore. Pranueshmëria e këtij kriteri është paraparë edhe në *nenin 35 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, ku parashtuesi i kërkesës duhet t’i shter të gjitha mjetet juridike të vendit që janë në dispozicion.⁷⁸

Një element i rëndësishëm që ndërlidhet me paraqitjen e ankesës individuale, është saktësimi i ankesës , me këtë d. m.th që parashtuesi ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat liri dhe të drejta pretendon se janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik që dëshiron ta kontestojë. Ligji për Gjykatën Kushtetuese nuk lejon paraqitjen e ankesës individuale kushtetuese *in abstrakto*, por shkelja e pretenduar e një të drejte kushtetuese duhet të jetë konkrete. Këtu kemi të bëjmë me një procedurë konkrete të kontrollit të kushtetutshmëris në të cilën parashtuesi i ankesës paraqet ankesë kundër një akti apo veprimi konkretë të organit publik, i cili cenon ndonjë të drejtë apo liri të përcaktuar me Kushtetutë.⁷⁹

Në Komentarin e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Johan van Lamoën, mes të tjerash shkruan: „Ashtu sikur Neni 113.7 i Kushtetutës, i cili përdor termin “individët”, Neni 47.1 i referohet një nocioni të ngjajshëm, respektivisht, “çdo individ”. Megjithatë, edhe pse siç u komentua në bazë të nenit 113.7, nocioni “çdo individ” do të thotë “çdo person fizik dhe juridik”, asnjë nga dispozitat e Kushtetutës, ligjit apo Rregullores së Punës nuk përmban ndonjë tregues se sa shtrihet rrethi i personave fizik dhe juridik. Sa ju përket personave fizik, jo vetëm një qytetari të Kosovës, por edhe shtetasi i huaj që viziton Republikën e Kosovës ose që banon atje, të drejtat e të cilit janë shkelur nga

⁷⁷Enver Hasani dhe Ivan Čukalović. " Komentari - Kushtetuta e Republikës së Kosovës" (2013) fq. 597 . pika 7

⁷⁸Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017,fq 129

⁷⁹Po aty

ndonjë autoritet publik në Kosovë ose jashtë Kosovës, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në Gjykatë"

80

Kërkesa individuale mund të parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve dhe afati fillon të rrjedhë që nga dita kur individit (personit fizik apo juridik) i është dorëzuar vendimi gjyqësor ose në raste të tjera nga dita kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Kërkesat individuale çdo vit janë në rritje e sipër drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Kjo paraqet një indikator shumë të rëndësishëm dhe të besueshëm ndaj Gjykatës si institucion në mbrojtje të lirive dhe të drejtave kushtetuese. Në lidhje me kërkesat, në vijim do të japim në formë tabelare të dhënat e Raportit Vjetor për vitin 2018 nga ana e Gjykatës Kushtetuese

Parashtrimi i kërkesave

Gjykata Kushtetuese vendos për çështjet që i referohen në mënyrë ligjore nga palët e autorizuar. Në vitin 2018, 206 kërkesat janë dorëzuar në Gjykatë, prej të cilave 96 KI (kërkesa individuale) dhe 10 KO (kërkesa të institucioneve, përkatësisht të organeve shtetërore), që do të thotë se janë pranuar mesatarisht 17,7 kërkesa në muaj, kurse janë zgjidhur 11,1.

Struktura e kërkesave të parashtruara është si në vijim:

- 158 (76.7%) kërkesat janë dorëzuar nga individët (persona fizikë);
- 48 (23.3%) kërkesat janë dorëzuar nga autoritetet e tjera publike (personat juridikë).

Shpërndarja e kërkesave

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, DRLSA⁸¹ i kan proceduar të gjitha kërkesat e parashtruara sipas nenit 13 të Kushtetutës. Shpërndarja e kërkesave/lëndëve për gjyqtarët raportues është bërë në përputhje me rregullin 10 dhe 36 të Rregullores së punës. Përfundim nga ky rregull është shpërndarja e kërkesave për vënien e masës së përkohshme, të cilat kërkesa procedohen sipas rregullit 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese dhe rasteve *ad hoc*, të cilat paraqesin konflikt interesi në përputhje me nenin 18 të Ligjit për Gjykatat dhe në pajtim me rregullin 9 të Rregullores së punës.

⁸⁰ Mushkolaj, Gjyljeta; Morina, Visar; Johan van Lamoën, PhD., Commentary LCC Law on the Constitutional Court of the Republic of Kosovo, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) Pristina, 2014. fq 345

⁸¹ DRLSA – është Departamenti i regjistrimit të lëndëve , statistikës dhe arkivit në kuadër të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës


Qasja në Gjykatë dhe besimi i publikut në punën e Gjykatës

Të gjithë qytetarët e Kosovës (si dhe personat nën juridiksionin e Kosovës), pavarësisht nga përkatësia etnike dhe fetare, kanë qasje të barabartë në Gjykatën Kushtetuese.

Kërkesat e paraqitura në Gjykatë, për sa i përket përkatësisë etnike të parashtruesve, paraqiten si në vijim:

- 130 (63,1%) kërkesa nga shqiptarët;
- 14 (6,8%) kërkesa nga komuniteti serb;
- 2 (1.0%) kërkesa nga komuniteti boshnjak;
- 1 (0.5%) kërkesa nga komuniteti RAE;
- 11 (5.3%) kërkesa nga nacionalitete të tjera; dhe
- 48 (23.3%) kërkesat janë parashtruar nga autoritetet e tjera publike (persona juridikë).

GRAFIKONI 1 :




Qasja gjinore e parashtruesve të kërkesave tregohet me sa vijon:

- 124 kërkesa të parashtruara nga gjinia mashkullore, ose 69,2%;
- 16 kërkesa të parashtruara nga gjinia femërore, ose 10,7%;

- 21 kërkesa të parashtruara në grup, ose 9,4%;
- 34 kërkesa të parashtruara nga organizatat punuese, ose 10,1%; dhe
- 11 kërkesa të parashtruara nga institucionet, ose 0,6%.

GRAFIKONI 2




Llojet e shkeljeve të supozuara

Tipologjia e shkeljeve të pretenduara nga 206 kërkesat e pranuar në vitin 2018 është si në vijim:

- Neni 21 [Parimet e përgjithshme), 3 raste ose 1,5%;
- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare], 26 raste ose 12,6 %;
- Neni 24 [Barazia para ligjit], 11 raste ose 5,3 %;
- Neni 29 [E drejta e lirisë dhe sigurisë], 1 rast ose 0,5%;
- Neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], 83 raste ose 40,3%;
- Neni 45 [Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes], 1 rast ose 0,5%
- Neni 46 [Mbrojtja e pronës], 42 raste ose 20,4%;
- Neni 49 [E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit], 6 raste ose 2,9%
- Neni 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave], 2 raste ose 1,0%
- Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], 2 raste ose 1,0%;
- Shqyrtimi kushtetues i vendimeve të autoriteteve publike, mbi baza të tjera, 3 raste ose 1,5%;
- Shkelje të tjera, 26 raste ose 12,6 %.


GRAFIKONI 3 :



Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 184 kërkesa ose 89,3 % e tyre kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave: 7
- 21 kërkesa ose 10,2 % e kërkesave kanë të bëjnë me autoritetet tjera publike:
- 1 ose 0,5 % janë interpretime (sqarime) kushtetuesu.

GRAFIKONI 4 :



Seancat dhe kolegjet shqyrtuese

Gjatë vitit 2018, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 35 seanca plenare, me 125 kolegje shqyrtuese dhe gjithsej janë shqyrtuar 133 kërkesa.


Rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, me aktvendime si dhe me vendime për hedhje poshtë të kërkesës dhe vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër. Në këtë periudhë janë paraqitur 2 mendime mospajtuese të gjyqtarëve në aktgjykime (rastet: KO12/18 dhe KI146/17, 147/17, 148/17, 149/17 dhe KI/149/17).

Struktura e 128 vendimeve të publikuara është si në vijim:

- 12 Aktgjykime, të përcjella me 2 Mendime Mospajtuese (rasti KO12/18 dhe rasti i bashkuar KI146/17, 147/17, 148/17, 149/17 dhe KI150/17);
- 99 Aktvendime për papranueshmëri;
- 4 Aktvendime për papranueshmëri dhe refuzim të kërkesës për masë të përkohshme;
- 11 Refuzim i kërkesës me procedurë të shkurtër;
- 1 Vendim për hedhje poshtë të kërkesës; dhe
- 1 Vendim për tërheqje të kërkesës nga lista.

GRAFIKONI 5 :

STRUKTURA E VENDIMEVE NË NUMËR DHE PËRQINDJE (I-XII 2018)



82

Gjykata Kushtetuese është kompetente për të gjykuar nëse Presidenti i Republikës ka bërë shkelje serioze të Kushtetutës. Në bazë të nenit 113 par. 6, *Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë të autorizuar të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës.* " ⁸³

Grupi i deputetëve që bëjnë kërkesë deri në Gjykatën Kushtetuese, duhet që të bëjnë përshkrimin e fakteve për shkeljen e supozuar, të identifikojnë dizpozitat konkrete të Kushtetutës, për të cilën pretendojnë se i ka shkelur Presidenti i Republikës, të paraqesin prova mbi të cilën mbështetet pretendimi për shkeljen e rëndë të Kushtetutës. Sipas Ligjit për Gjykatën Kushtetuese kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve që nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit të Republikës është bërë publike.⁸⁴ Ky organ që në fillim të punës së saj është konfrontuar me kërkesën e tridhet e dy (32) deputetëve të Kuvendit që pretenduan se mbajtja e postit të kryetarit të partisë politike nga ana e Presidentit të Republikës, përbën shkelje serioze dhe të rëndë të Kushtetutës⁸⁵. Sipas J. V Laemon në Komentarin e Ligjit mes tjerash thotë :

⁸²Të dhënat janë marur dhe përpunuar nga Raporti Vjetor 2018 31-34 i arritshëm në wepp. faqen https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/05/Raporti_vjetor_2018_GJKK.pdf

⁸³Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 113 par. 6

⁸⁴Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, 2008/03-121, neni 44

⁸⁵Për më shumë Kërkesa e paraqitur nga deputeti Naim Rustemi dhe 31 deputet të tjerë të Kuvendit kundër Presidentit shkelqesis së tij z. Fatmir Sejdiu është në linkun: <http://gjk-ks.org/decision/naim-rrustemi-dhe-31-deputet-t-tjer-t-kuvendit-t-republiks-s-kosovs-vs-shklqsis-s-tij-fatmir-sejdiu-president-i-republikeum/>

*“Duke pasur parasysh kompetencat e konsiderueshme dhënë Presidentit sipas Kushtetutës, është e arsyeshme që publiku të supozojë se Presidenti i tyre, “që përfaqëson unitetin e popullit” dhe jo një interes sektorial ose parti politike, do të përfaqësojë të gjithë ata. Çdo shtetas i Republikës ka të drejtë të jetë i sigurtë për paanësinë, integritetin dhe pavarësinë e Presidentit të tyre. Kjo është veçanërisht kështu, kur ai ushtron zgjedhje politike si në rastin kur zgjedh kandidatët që konkurrojnë nga koalicionet e mundshme për t’u bërë Kryeministër”.⁸⁶ Gjykata Kushtetuese në bazë të kërkesës dhe të gjitha fakteve kishte nxjerr përfundimin se Presidenti i Republikës kishte bërë *shkelje të rëndë kushtetuese* pasi kishte mbajtur në të njëjtën kohë postin e Presidentit të Republikës dhe të Kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës duke cenuar kështu nenin 88 par. 2 të Kushtetutës, i cili përcakton se Presidenti pas zgjedhjes „nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike”⁸⁷ Duke vendosur mbi themelësinë e rastit, Gjykata Kushtetuese ka analizuar rastin nëse shkelja ishte „teknike” apo „serioze”, dhe kishte ardhur në përfundim se Presidenti i Republikës „përfaqëson unitetin e popullit” dhe me këtë është konstatuar se ka bërë shkelje serioze⁸⁸ dhe Presidenti Fatmir Sejdiu jep dorëheqje të parevokueshme më datë 27 shtator 2010.⁸⁹*

Ditëve të fundit në një shkrim të titulluar „Mbi lojalitetin kushtetues”, prof. dr. Visar Morina mes tjerash shkruan, „Juristi me famë botërore Hans Kelsen, njëri ndër arkitektët e Kushtetutës Austriake të vitit 1920 me të drejtë pohonte se Gjykata Kushtetuese është kujdestare e kushtetuetsshmërisë në një demoraci kushtetuese. Andaj ndërtimi i gjyqësisë kushtetuese në Kosovë është manifestim direkt i zbatimit të kësaj Kushtetute dhe doktrinës kelziane për Gjykatën Kushtetutuese si kujdestare e kushtetuetsshmërisë.”⁹⁰

⁸⁶ Mushkolaj, Gjyljeta; Morina, Visar; Johan van Lamoën, PhD., Commentary LCC Law on the Constitutional Court of the Republic of Kosovo, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) Pristina, 2014. fq 338

⁸⁷ Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017, fq 130

⁸⁸ Po aty, fq 131

⁸⁹ Për më shumë reth dorëheqjes së Presidentit F. Sejdiu në linqet : <https://www.dw.com/sq/presidenti-sejdiu-jep-dor%C3%ABheqjen/a-6049627>, <https://www.evropaelire.org/a/2169631.html>, https://www.youtube.com/watch?v=yvqWeu-qm_g

⁹⁰ Për më shumë shih në Koha e datës 9 prill 2020 ,11: 48 , në linkun: <https://www.koha.net/veshtrime/216843/mbi-lojalitetin-kushtetues/>

KAPITULLI I TRETË

3. GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

3.1. Historiku dhe krijimi i Gjykatës Kushtetuese

Në fillim të viteve 90 të shekullit XX, Shqipërinë si shumë vende që ishin pjesë e „Blokut të vendeve socialiste” e kaploi vala e domostratave dhe protestave për rrëzimin e sistemit komunist. Protestat studentore kishin filluar më 8 dhejtor 1990. Kërkesa ishte për kushte më të mira në Qytetin Studenti, por kishin edhe kërkesa politike për lijin e pluralizmit politik dhe dënimin e dhunuesve të studentëve.⁹¹

Rrënjët e kontrollit kushtetues në Shqipëri datojnë nga periudha e përmbysjes të sistemit komunist dhe kalimin në periudhën pluraliste. Gjatë periudhës së sistemit komunist të gjitha kushtetutat si ajo 1946, 1953 dhe 1976, kontrolli kushtetues ju besua Kuvendit Popullor si organ më i lartë ku kujdesej për interpretimin kushtetues të ligjeve. Kushtetuta e viti 1976 kishte përcaktuar :

Neni 66

Kuvendi Popullor është organ më i lartë i pushtetit shtetëror mbrojtës i sovranitetit të popullit e të shtetit dhe i vetmi organ ligjvënës.

Neni 67

Kuvendi Popullor ka këto kompetenca kryesore:

- Përcakton, në përputhje me vijën e përgjithshme dhe direktivat e Partisë së Punës së Shqipëris, drejtimit kryesor të politikës së brendëshme e të jashtme të shtetit,
- Miraton e ndryshon Kushtetutën dhe ligjet, vendos mbi pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe bënë interpretimin e tyre.⁹²

Me ndryshimet demokratike që pasuan nga fillimi i viteve 90 të shek XX, kërkohej edhe ndryshime institucionale në ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ndryshimet demokratike fillimisht u shpallën me ligjin nr. 7491 të datës 29 prill 1991, por ndryshimet më të mëdha kushtetuese u bënë me ligjin nr. 7561 të datës 29 prill 1992. Në kuadër të këtyre ndryshimeve u krijua edhe Gjykata Kushtetuese si një ndër organet më të rëndësishme për garantimin e rendit kushtetues që po instalohet në një shtet demokratik ku do të sundojë e drejta.

⁹¹Për më shumë në linkun : <https://naishtedikur.info-Histori>

⁹²Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017, fq 89

Kuvendi në fillim kishte përcaktuar Gjykatën Kushtetuese si autoritetin më të lartë që garantonte respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj .⁹³

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë që nga fillet e saj kishte caktuar modelin kelzian të kontrollit kushtetues, përbëhej nga nëntë (9) gjyqtarë kushtetues me një mandat prej dymbëdhjetë (12) vite pa të drejtë rizgjedhjeje dhe pesë (5) prej të cilëve zgjidheshin nga Kuvendi dhe katër (4) nga Presidenti i Republikës. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhej me votim të fshehtë nga vetë gjyqtarët. Ligji i mësipërm përcaktonte edhe statusin e gjyqtarëve kushtetues, kompetencat e atributet, subjektet që e vinin në lëvizje dhe fuqinë detyruese të vendimeve të saj.⁹⁴ Më 15.07.1998 Kuvendi miratoi ligjin nr. 8373 „Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” të Republikës së Shqipërisë, i cili krijohet në bazë ligjore për çështjet e veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese.

Me miratimin e Kushtetutës më 28 nëntor 1998 u shfuqizua Ligji për dispozitat kryesore kushtetuese andaj mënyra e emërimit dhe kompetencat e Gjykatës pësuan ndryshime rrënjësore. Kushtetuta përcaktonte se Gjykata Kushtetuese përbëhej nga nëntë (9) gjyqtarë, të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit për një periudhë nëntë vjeçare pa të drejtë rizgjedhjeje. Anëtarët e Gjykatës zgjidheshin nga radha e juristëve me kualifikim të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 15 vjet në profesion.⁹⁵

Gjykata Kushtetuese kishte përcaktuar se qëllimi i hartuesve të Kushtetutës ka qenë që emërimi i gjyqtarëve të mos mbetet vetëm në kompetencën e një organi, por të reflektojë ndarjen dhe kontrollin e pushteteve gjë që siguron në mënyrë të përshtatshme pavarësinë dhe autoritetin e këtyre gjykatave. Sipas Gjykatës Kushtetuese, sistemi i emërimit i pranuar nga Kushtetuta është në esencë sistem i bashkëpunimit institucional të Presidentit të Republikës dhe Kuvendit.⁹⁶

Kuvendi në verën e vitit 2016 miratoi ligjin nr. 76/2016 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417 datë 21.10.1998, „Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ", i cili për herë të tretë që nga themelimi i Gjykatës, solli ndryshime në përbërje dhe juridiksion. Sipas këtyre ndryshimeve kushtetuese, ajo përbëhej nga nëntë (9) gjyqtarëve , ku tre (3) gjyqëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre (3) gjyqëtarë zgjedhen nga Kuvendi dhe tre (3) gjyqëtarë zgjedhen nga Gjykata e Lartë. Anëtarët përzgjedhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tre vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi .⁹⁷ Kuvendi zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me tre të pestat

⁹³ Shih faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese në linkun : http://www.gjk.gov.al/web/Historiku_97_1.php

⁹⁴Po aty

⁹⁵Për më shumë shih Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë , Neni 125

⁹⁶Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017,fq 90-91

⁹⁷Po aty ,fq 91

e të gjithë deputetëve, mirpo nëse Kuvendi nuk mund të zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë shpallet i emëruar.

Për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese duhet të plotësohen kriteret për zgjedhje :
*„ Duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë , avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike me një veprim të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera tjera të së drejtës dhe nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike apo pozicione drejtuese në një parti politike gjatë dhjetë (10) viteve të fundit përpara kandidimit “*⁹⁸ E gjithë kjo është bërë për të penguar politizimin e Gjykatës dhe për të ruajtur paanshmërinë e saj në marrjen e çfarë do lloj vendimi të drejt dhe meritore pa ndikim të politikës.

Historiku i krijimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë mund të them se kaloj në tri (3) faza të rëndësishme:

- *Periudha e parë është periudha e krijimit të Gjykatës nga viti 1991-92 gjer në ardhejn e Kushtetutës së re të 28 dhjetorit 1998.*
- *Periudha e dytë është ajo nga Kushtetuta e viti 1998 deri në vitin 2016 me ligjin nr. 76/2016*
- *Periudha e tretë është me përfshirjen e vetiungut në të gjithë Drejtësinë të Shtetit Shqiptar.*

3.2. Përbërja dhe pozita e Gjykatës Kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në Kreun e VIII nga neni 124 deri tek neni 134 ka paraparë organizimin, punën, kompetencat dhe pozitën kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese.

Në neni 125 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë përcaktohet përbërja e Gjykatës :

„ 1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit.

2. Gjyqtarët emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi, nga radhët e juristëve me kualifikim të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 15 vjet në profesion.

3. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo tre vjet në një të tretën e saj sipas procedurës së caktuar me ligj.

4. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese emërohet nga radhët e anëtarëve të saj nga Presidenti i Republikës, me pëlqimin e Kuvendit, për një periudhë prej 3 vjetësh.

⁹⁸Po aty , Cituar : Nenin 30 i Kushtetutës së Shqipërisë, ndryshuar me Ligjin nr. 76/2016 të datës 22.07.2016 për disa shtesa dhe ndryshimi në ligjin nr. 8417 të datës 21.10.1998 , „ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”.

5. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij.”⁹⁹

Gjyqëtarët kushtetues kanë një varg garancish për të siguruar pavarësinë e tyre kur gjyqtarët i nënshtrohen parimit të parevokueshmërisë. Nuk mund të shkarkohen nga detyra gjatë kohës që e ushtrojnë mandatin, mandati përfundon me vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe ky organ parashikon qëndrimin në detyrë të gjykatësit kushtetues deri në emërimin e anëtarit të ri .

Kushtetuta ka përcaktuar qartë statusin e gjykatësit kushtetues në neni 130 të Kushtetutës që thotë: „Të qenit gjyqtarë i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private.”¹⁰⁰ Kanë imunitet të garantuar nga vet Kushtetuta dhe nuk mbajnë përgjegjësi për atë çka thonë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre dhe as për vendimet që marrin dhe votat që shprehin. Mendimi i pakicës në marrjen e një vendimi botohet së bashku me vendimin e Gjykatës në Fletoren Zyrtare. Gjyqëtar i kushtetues ka imunitet nga procesi penal dhe është shumë i diskutueshëm ditëve të fundit në kuadrin e reformimit të përgjithshëm të imuniteteve të funksionarëve të lartë shtetëror. Pa lejën dhe pëlqimin e Gjykatës nuk mund të ndiqet penalisht, edhe në rast kur mund të ndalohet dhe arrestohet për faktin se kapet në kryerje e sipër të një krimi , ose menjëherë pas kryerjes së tij, Gjykata Kushtetuese duhet të jep pëlqimin e saj brenda 24 orëve për dërgim në Gjykatë të gjyqëtarit të arrestuar apo në rast të kundërt organi kompetent duhet ta lirojë atë.¹⁰¹

Të gjitha rastet kur gjyqëtarët shkarkohen nga detyra edhe atë për shkelje të Kushtetutës, kryerjen e në krimi, paaftësi mendore ose fizike, për akte që diskreditojnë rëndë pozitën e gjyqtarit kushtetues, shkarkimi nga detyra kryhet nga Kuvendi me shumicë prej 2/3 të deputetëve, vendimi duhet t’i nënshtrohet edhe shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese.¹⁰²

Kriteret tjera si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është e përcaktuar edhe me ligj. Përbërja e këtij organi përtrihet çdo tre (3) vjet me një të tretën (1/3) e gjyqtarëve kushtetues sipas procedurës së përcaktur me ligj.

Me punën e Gjykatës Kushtetuese udhëheq Kryetari i Gjykatës që zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me votim të fshehtë; për një periudhë tre (3) vjeçare me të drejtë rizgjedhje vetëm edhe për një herë.

103

⁹⁹Kushtetua e Republikës së Shqipëris , Cituar Neni 125

¹⁰⁰Kushtetua e Republikës së Shqipëris , Cituar Neni 130

¹⁰¹ Zaganjori, Xh., Anastasi, A., Cani (Methasani) E., Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Shtëpia Botuese Adelprint 2011 , fq. 158-159 dhe Omari, L. & Anastasi., A, E drejta Kushtetuese, 2010, Shtëpia Botuese ABC

¹⁰²Po aty

¹⁰³Për më tepër në linkun : http://www.gjk.gov.al/web/Perberja_90_1.php

3.3. Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese me theks në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit

Kompetencat e Gjykatës Kushtetuese janë të përcaktuara me nenin 131 të Kushtetutës së Shqipërisë.¹⁰⁴ Kontrolli i pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, është kompetencë kryesore e organit në fjalë. Gjykata Kushtetuese është organ kryesor që kontrollon respektimin e parimit të sovranitetit të popullit dhe atë të shtetit të së drejtës, gjykon mosmarrëveshjet për kompetenca në mes të pushtetit qendror dhe atij vendor; gjykimin të kushtetutshmërisë së partive politike dhe organizatave të tjera politike.¹⁰⁵ Ky institucion po ashtu gjykon edhe kontestet të natyrës zgjedhore siç është kontrolli i kushtetutshmërisë së zgjedhjes dhe të pajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të Presidentit të Republikës dhe të deputetëve të Kuvendit si dhe verifikimin e zgjedhjes së tyre. Është kompetente të hidhet në rishikimin e kushtetutshmërisë së referendumit dhe verifikimit të rezultateve të tij.¹⁰⁶

Funksion i rëndësishëm i Gjykatës është ai për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarit, ku pasi të kenë shterur të drejtën e ankesës ndaj çdo akti të pushtetit publik ose vendimit gjyqsor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Ndryshimet e fundit kushtetuese avancuan sistemin e mbrojtjes kushtetuese të lirive dhe të drejtave themelore pasi modeli i mëparshëm lejonte vetëm ankesa individuale për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, por jo edhe për liritë dhe të drjetat tjera kushtetuese.¹⁰⁷

Kur flasim për kontrollin e pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën duhet pasur parasysh se gjykimin të Gjykatës Kushtetuese i nënshtrohen ligjet, marrëveshjet ndërkombëtare përpara ratifikimit të tyre, aktet normative që kanë fuqinë e ligjit, aktet normative të organeve të pushtetit qendror dhe atij lokal. Në lidhje me përcaktimin më konkretë të akteve që kanë fuqinë e ligjit, kanë pasur diskutime të ndryshme që lidhen me juridiksionin gjyqsorë ose kontrollin kushtetues të akteve normative. Është mbrojtur mendimi se objekte të shqyrtimit të Gjykatës Kushtetuese do të jenë vetëm burimet primare të së drjetës. Shqyrtimi i akteve dhe dispozitave nënligjore del jashtë objektit të shqyrtimit të Gjykatës Kushtetuese. Ato mund të shqyrtohen gjithmonë nga ana e gjykatave të rregullta. Ndarja në mes të akteve që gjykojnë gjykatat e rregullta dhe Gjykata Kushtetuese ka si kriter kryesor *së pari* natyrën e aktit nëse është me përmbajtje individuale apo normative dhe *së dyti* pretendimi ndaj përmbajtjes së aktit, nëse kërkohet paligjshmëri apo moskushtetueshmëria e

¹⁰⁴Për më shumë shih Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 131

¹⁰⁵Zaganjori, Xh., Anastasi, A., Cani (Methasani) E., Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Shtëpia Botuese Adelprint 2011, fq. 158-159

¹⁰⁶Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017, fq 93

¹⁰⁷Po aty

tij. Pra, përveç ligjeve, akteve të tjera nënligjore me përmbajtje normative, mund të jenë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese, nëse pretendohet papajtueshmëria e tyre me Kushtetutën.¹⁰⁸

Viteve të fundit Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë i ka kushtuar rol të madh *mbrojtjes së të drejtave dhe lirive kushtetuese*. Gjykata ka interpretuar në mënyrë të gjerë rastet e mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të njeriut. Në vendimet e saj, jo vetëm se janë detajuar garancitë e përmendura në Kushtetutë, por edhe janë afimuar elemente të reja garantuese. Përmes interpretimit janë vendosur parime të pathëna shprehimisht në përgjigje të drejtpërdrejtë në lidhje me to, për shkak të boshllëqeve, mospërputhjeve dhe mungesës së vijës logjike. Gjyqtarët janë të pavarur si nga orgjinalizimi, ashtu edhe nga interpretimet tjera dhe kanë autoritetin ekskluziv për të përmbyllur konfliktet ligjore pasi që nuk mund të lënë një çështje pa përgjigje.¹⁰⁹

Kohëve të fundit bëhet përpjekje dhe ka tendenca për universalizimin e së drejtës për ndërthurjen e rolit të gjyqtarit kombëtar e ndërkombëtar dhe qarkullimin e jurisprudentëve e doktrina kushtetuese të vendeve të tjera. Kjo e arritur është si rezultat i pavarësisë së gjyqtarëve që mund të kalojnë kufijtë e shteteve me interpretimet e tyre dhe formojnë garanci për mbrojtje të lirive dhe të drjetave themelore.¹¹⁰

Kushtetutat vlerësohen si pajtim-garanci mjaft të rëndësishme për të siguruar zbatimin e të drjetave dhe lirive themelore. I tillë është *parimi i sigurisë juridike, parimi i qartësisë dhe saktësisë së normave, parimi i të drjetave të fituara, parimi i barazisë së armëve etj.* Me këtë mund të flasim jo vetëm për interpretim thjesht kushtetues, por edhe ndryshim të saj (Kushtetutës). Në fakt kjo që ndodh është hapsirë e krijuar dhe e lejuar nga vetë Kushtetuta, e cila e ka thirrur drejtëpërdrejtë Konventën Evropiane për të drejtat e Njeriut për të garantuar shkallën e kufizimeve të të drejtave kushtetuese. Ka vendosur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me fuqi mbiligjore apo më mirë thënë në mes të ligjit dhe Kushtetutës, si dhe i ka dedikuar Gjykatës të drjetën për të kontrolluar pajtueshmërinë e ligjeve të brendshme me konventat ndërkombëtare.¹¹¹

Gjykata Kushtetuese është fakt se kur kontrollon pajtueshmërinë e ligjeve me konventat ndërkombëtare, mban në vëmendje jo vetëm tekstin e konventës si të tillë, por edhe interpretimet që Gjykata Evropiane u ka bërë dispozitave të saj. Në zgjidhjen e çështjes, ajo u referohet shpesh vendimeve të Gjykatës Evropiane për të drejtat e Njeriut, por edhe vendimeve të gjykatave të tjera

¹⁰⁸Zaganjori, Xh., Anastasi, A., Cani (Methasani) E., Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Shtëpia Botuese Adelprint 2011, fq. 163

¹⁰⁹Po aty, fq 172-173

¹¹⁰Po aty Cituar : nga Gustavo Zagerelsky, Fjalë përshëndetëse e mbajtur me rastin e 50-vjetorit të Krijimit të Gjykatës Kushtetuese Italiane.

¹¹¹Po aty, fq 172

të vendeve demokratike si dhe doktrinae më të reja kushtetuese. Përgjatë studimeve hasim mjaft raste që do të paraqesim disa në Kapitullin e katër, ku dëshmohet qartë se si garancitë kushtetuese të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarit, ndërveprojnë me njëra-tjetrën dhe marrin jetë përmes këtij ndëraktivitetit. Pyetja që parashtrohet vazhdimisht është:

Deri kur shtrihet autoriteti ligjor i gjyqtarit për të interpretuar Kushtetutën? A mund të ndryshoj gjyqtari Kushtetutën?

Në teorinë kushtetuese botërore ka pasur dy mendime: *i pari* është ai që thotë se interpretimi i Kushtetutës mund të jetë i pavarur nga kuptimi origjinal, kurse mendimi *i dytë* kërkon që ky interpretim të jetë brenda vlerave dhe fjalëve që ekzistojnë në Kushtetutë.

Në bazë të këtyre mendimeve ndeshen dy teori përballë njëra tjetrës edhe ate teoria e origjinalizimit dhe jo origjinalizimit. Këto teori e konkurojnë njëra tjetrën, por teoria e origjinalizimit është ndihmuar shumë nga zhvillimi i të Drejtës Kushtetuese të Krahastuar, i konstitucionalizimit të krahastuar, si lidhjes së fort që ekziston në mes të së drejtës kushtetuese kombëtare dhe drejtës ndërkombëtare. Kushtetutat në shumë raste janë të padetajuara mirë. Atëherë gjyqtarët kanë diskrecionin të interpretojnë dhe të zbatojnë dispozitat që sanksionojnë të drejtën kushtetuese dhe garancitë e tyre. Është vështirë të kryhet interpretim me besnikëri ndaj Kushtetutës, nga ai që quhet pseudo-interpretim që në fakt përfshijnë në vete ndryshimet e saj. Gjyqtarët mund të vendosin për çështje, edhe pse Kushtetuta nuk e jep.

3.4 Vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese

Në bazë të nenit 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të :, a) Presidentit të Republikës; b) Kryeministrit; c) jo më pak se një të pestës së deputetëve; ç) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit; d) çdo gjykatë sipas rastit të nenit 145 pika 2 të kësaj Kushtetute; dh) Avokatit të Popullit; e) organeve të qeverisjes vendore; ë) organeve të bashkësive fetare; f) partive politike, organizatave të tjera; dhe g) individëve¹¹²

Forma e kontrollit të kushtetueshmërisë, Gjykata Kushtetuese shqyrton aktin e formimit të partive politike si dhe nëse veprimtaria e tyre është në pajtim me parimet dhe vlerat e rendit kushtetues. Nëse Gjykata çmon se ka të dhëna se veprimtaria e mëtejshme e një partie ose organizate politike cenon rendin kushtetues ose interesat shtetërore apo publike ,sipas rastit, me vendim të veçantë të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancë plenare mund të vendos pezullimin e veprimtarisë së partisë ose organizatës politike deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Po ashtu

¹¹²Kushtetua e Republikës së Shqipërisë, Citarat Neni 134

nëse arrin në përfundim se krijimi i një partie ose organizate politike vjen në kundërshtim me Kushtetutën, Gjykata shfuqizon aktin e krijimit ose mund të urdhërojë çregjistrimin e saj.¹¹³

Gjykata Kushtetuese vlerëson si të nevojshme që së pari të shprehet mbi legjitimitimin e kërkuarit. Lidhur me këtë Gjykata çmon se Avokati i Popullit legjitimohet në paraqitjen e kërkesës së tij para kësaj Gjykate. Siç është theksuar edhe në praktikën e mëparshme të kësaj Gjykate, Avokati i Popullit, si një nga subjektet që mund ta vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 134/2 të Kushtetutës, duhet të justifikojë interesin e tij në filozofinë e krijimit të këtij institucioni, si një mekanizëm efektiv në mbrojtje të të drejtave kushtetuese të shtetësve, të drejta të cilat përbëjnë bazën e rendit juridik¹¹⁴ çështjen konkrete. Interesi i tij duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron ku si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve. Shkeljet duhet të evidentohen në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij. Sipas nenit 60 të Kushtetutës, Avokati i Popullit është organ kushtetues i krijuar për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të administratës publike.¹¹⁵ Një nga mënyrat, me të cilat ky organ realizon funksionin e tij, është edhe vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e akteve normative të nxjerra nga administrata publike dhe që nga evidentimi i Avokatit të Popullit rezultojnë të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën. Avokati i Popullit mund të arrijë në këtë përfundim përmes hetimeve, vëzhgimeve apo informacioneve që ai mbledh, kur individët i drejtohen atij me anë të ankesës ose kërkesës. Nëse ky organ vlerëson se si rrjedhim i veprimtarisë së administratës publike janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të individit, atëherë ai ndërmerr hapa konkrete për verifikimin e mëtejshëm të shkaqeve që kanë çuar në këtë shkelje dhe rast pas rasti rekomandon marrjen e masave të karakterit normativ, nëse është e nevojshme. Gjykata Kushtetuese konstaton se kompetenca e Avokatit të Popullit për t'iu drejtuar kësaj Gjykate konsiderohet si një garanci shtesë që i është dhënë në mënyrë indirekte individit për të vënë në vend të drejtën e cenuar nga aktet e administratës publike. Avokati i Popullit duhet të argumentojë shkeljen konkrete dhe interesin në çështjen që kërkon të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese. Kur Avokati i Popullit krijon bindjen se shkelja ka ardhur si pasojë e përmbajtjes së një ligji ose akti tjetër normativ, pra nga vetë formulimi i vullnetit të organit që e ka nxjerrë atë, atëherë ai mund të njoftojë

¹¹³Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017, fq 92-93

¹¹⁴ Për më shumë në Interpretimin Kushtetues file:///F:/Kushtetuta%20e%20Shqipëris.pdf

VGJK 40/2007 fq 56

¹¹⁵Kushtetua e Republikës së Shqipëris , Neni 60 par. 1, 2,3

Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin e aktit si antikushtetues. Në një rast të tillë mund të thuhet se çështja konkrete lidhet me interesin e këtij organi kushtetues për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e individit. Në këtë këndvështrim, interesi i Avokatit të Popullit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me qëllim shfuqizimin si antikushtetues të aktit të ligjvënësit duhet të shqyrtohet rast pas rasti, pasi ky është edhe kuptimi i nenit 134/2 të Kushtetutës, i cili e ka renditur këtë organ në grupin e subjekteve që i drejtohen Gjykatës Kushtetuese vetëm nëse justifikojnë interesin e tyre në çështjen konkrete. Gjykata Kushtetuese çmon se vënia në lëvizje nga Avokati i Popullit është në përputhje me funksionin e tij kushtetues.

3.4.1 Vënia në lëvizje përmes autoriteteve publike

Kjo e drejtë ushtrohet nga organet më të larta të pushtetit qendror dhe atij lokal, si : Presidenti i Republikës, Kryeministri, deputetët jo më pakë se një e pesta (1/5) , Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe organet e pushtetit lokal. Vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese siç e cekëm më lartë bëhet edhe nga Avokati i Popullit, partitë politike ,organet përfaqësues të bashkësive fetare dhe organizatat tjera. Kërkesa e autoriteteve publike ka një tipar dallues, ato vënë në lëvizje një kontroll abstrakt dhe objektiv të ligjit, ku objekt i gjykimit janë normat juridike. Në këtë rast, interesi ligjor që kërkohet të mbrohet nuk është individual, por ka të bëjë me *funksionimin e shtetit*.

Shqyrtimi i pajtueshmërisë së ligjit ose akteve tjera me Kushtetutën, mund të fillojë vetëm me kërkesën e Presidentit të Republikës, të Kryeministrit, jo më pak se një e pesta (1/5) e deputetëve si dhe me kërksën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.¹¹⁶

Por problemi i legjitimitetit të subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, është vlerësuar prej jurisprondencës së saj si një aspekt i rëndësishëm i procesit kushtetues, Ajo ka çmuar se „*procedurën e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë së normës, në aspektin formal, mund ta vënë në lëvizje, për arsye të një interesi publik qoftë, dhe pa pasur një interes konkret subjektiv, vetëm autoritetet e larta shtetërore, (subjektet e parashikuara nga neni 134/1, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të Kushtetutës).Pra, kushtetutbërësi ka legjitimuar për të vënë në lëvizje Gjykatën në lidhje me kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së normës vetëm katër subjektet e parë të listuara në pikën 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ky kontroll nuk ushtrohet në lidhje me një të drejtë subjektive të individit, por në ballafaqim ndërmjet akteve normative me Kushtetutën. Mbi këtë bazë, të gjithë*

¹¹⁶ Zaganjori, Xh., Anastasi, A., Cani (Methasani) E., Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Shtëpia Botuese Adelprint 2011 , fq. 164

subjektet e tjerë që parashikohen me nenin 134/1, shkronjat “dh”, “e”, “ë”, “f” dhe “g”, i drejtohen Gjykatës në kuptim të kontrollit konkret të kushtetutshmërisë së normës juridike”.¹¹⁷

Gjykata Kushtetuese sa i përket legjitimitit të subjekteve të cilëve u kërkohet intersi i tyre me çështjen, e ka konsoliduar qëndrimin duke bërë testimin (*ratione materie*) për të analizuar legjitimitimin e kërkuarit në lidhje me pretendimin e tij për antikushtetutshmërinë e aktit. Ajo ka theksuar se : „*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë synon identifikimin e të drejtës së shkelur të subjekteve si rrjedhojë e antikushtetutshmërisë në përmbajtje të normës juridike. Për sa i përket legjitimitit të subjekteve, të cilëve u kërkohet interesi i tyre me çështjen, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë synon identifikimin e të drejtës së shkelur të subjektit si rrjedhojë e antikushtetutshmërinë e normës që ka sjell këtë cënim të interesit*”.¹¹⁸

Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet inicuese që parashikohen në nenin 134, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet funksionit dhe veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Partitë politike janë të specifikuara në nenin 134 pika 1 shkronja “f” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Ato kanë legjitimitet kushtetues vetëm për ato çështje që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, partitë politike paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve e pikëpamjeve politike të përbashkëta që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit. Partitë politike në sistemin e zgjedhjeve e veçanërisht në procesin zgjedhor, që nga fushata parazgjedhore, paraqitja e kandidatëve, formimi i trupave zgjedhore, ndjekja e zgjedhjeve e deri tek ndarja e mandateve, paraqiten si një faktor përcaktues shumë i rëndësishëm, prandaj demokracia përfaqësuese, ashtu si dhe sistemi i zgjedhjeve, nuk mund të paramendohen pa ekzistencën dhe funksionimin e partive politike. Ky pozicion specifikë që partitë politike kanë në raport me zgjedhjet përcakton njëkohësisht dhe interesin e tyre për të patur një legjislacion dhe rregulla sa më të qarta të të drejtave.¹¹⁹

¹¹⁷ Po aty, fq 165 ,bazuar në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.9, datë 19.03.2008

¹¹⁸ Po aty, fq 165 ,bazuar në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.17, datë 25.07.2008

¹¹⁹ Për më shumë në Kushtetutën file:///F:/Kushtetuta%20e%20Shqipëris.pdf, VGJK1/2005.

3.4.2 Vënia në lëvizje përmes gjykatave të zakonshme

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë vihet në lëvizje nga gjykatat e zakonshme me vendim të gjyqtarit në kuadrin e një procesi gjyqësor, qoftë ai penal, civil, tregtar apo ndonjë çështje tjetër. Gjatë gjykimit të zakonshëm, gjyqtari çmon se ligji që zbatohet në çështjen konkrete vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe nuk e zbaton atë ligj. Merr vendim për pezullimin e gjykimit dhe e çon çështjen për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.

Nga kjo shtrohet një pyetje nëse nisma e procesit kushtetues përbën një detyrim për gjyqtarin, apo thjesht lihet në subjektivizimin e tij. Qendron mendimi se dispozita kushtetuese që i jep këtë mundësi gjyqtarit të zakonshëm, përbën një detyrim, pasi gjyqtari nuk mund të zbatojë një ligj që ai çmon se vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe as të vendos vetë për pajtueshmërinë e tij me Kushtetutën. Kushtetuta nuk e legjitimon as shmangien e zbatimit të ligjit antikushtetues me heshtje nga gjyqtari.¹²⁰ Ky sistem është i zbatueshëm në shtetet evropiane dhe njihet si model evropian. Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese mund të vihet në lëvizje nga gjyqtari i zakonshëm, vetëm në rastin kur ky i fundi e çmon ligjin si antikushtetues.

Me këtë na ndihmon shumë edhe jurisipodencia e Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë.

Ligji Themelor (Das Grundgesetz) 1949 ka njohur edhe institucionin e *referimit incidental*, ku nëse një gjykatë konkludon se një ligj mbi bazën e të cilit varet vlefshmëria e vendimit të saj, është jo kushtetues. Atëherë gjykata mund të ndërpresë procedurën deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese lidhur me pretendimin e ngritur për mos përputhjen e ligjit me dispozitat e Ligjit Themelor. Gjykata Kushtetuese është kompetente për të vendosur nëse një normë e të drejtës ndërkombëtare është pjesë e së drejtës federale dhe krijon të drejta dhe detyrime për individin sipas Ligjit Themelor. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese prodhojnë efekt të detyrueshëm juridik për organet federale dhe të gjithë organet e landeve,¹²¹ sikurse gjykata e zakonshme dhe autoritet publike. Këto vendime kanë forcën e ligjit në ato raste kur Gjykata shpall një ligj të papajtueshëm me Kushtetutën dhe vendimet e tilla publikohen në Gazetën Zyrtare.¹²²

Gjyqtari i zakonshëm rrespekton rregullat procedurale të parashikuara nga ligji organik i Gjykatës Kushtetuese për ushtrimin e tij, si dhe jurisipodencën kushtetuese. Psh. gjykatësi pezullon gjykimin vetëm kur vëren se kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjit përkatës është i domosdoshëm për

¹²⁰Zaganjori, Xh., Anastasi, A., Cani (Methasani) E., Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Shtëpia Botuese Adelprint 2011, fq. 166

¹²¹**Landet** janë republikat në kuadër të Federatës së Gjermanisë. Pas vitit 1945 Gjermania ishte sferë e intersit ku ishte ndarë në katër zona. Deri në vitin 1989 ishin gjithëse 12 Lande, kurse pas rënies së Murit të Berlinit ju bashkuan edhe katër Lande me shpërbërjen Gjermanisë Lindore. Për bashkimin e shtetit Gjerman merit të madhe ka ish kancelari Helmut Kohl 1930-2017.

¹²²Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017, fq. 83

zgjidhjen e çështjes konkrete. Ky lloj gjykimi kushtetues kërkon domosdoshmëri në egzistencën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë në mes të ligjit, antikushtetutshmërisë, e cila çmohet se e tillë nga Gjykata Kushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.¹²³ Pra, lidhja në mes ligjit dhe çështjes konkrete që shqyrton gjyqtari, është një lidhje e ngushtë me karakter të drejtpërdrejtë dhe të domosdoshëm.

Gjykata Kushtetuese ka parasysh ekzistencën e lidhjes së domosdoshme që kërkohet për gjykime të kësaj natyre. „Ajo ka rrëzuar kërkesën incidentale të gjyqtarit, në rastet kur çështja e kërkuar ka paraqitur mangësi të dukshme të rëndësisë për zgjidhjen e rastit konkret, ose kur motivet e parashtruara në kërkesë mbi rëndësinë e çështjes, kanë qenë të papërshtatshme.”¹²⁴

3.4.3 Vënia në lëvizje përmes kërkesave individuale

Në bazë të nenit 131/f dhe 134/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet që individët janë subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese edhe atë:

*“Gjykata Kushtetuese vendos për: gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave” dhe “Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të individëve”.*¹²⁵

Në bazë të neneve të lartpërmendura të Kushtetutës janë dy çështje që duhet theksuar edhe atë:

1. Pretendohet se ndaj individit nuk është zhvilluar një proces i rregullt ligjor.
2. Pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e tjera juridike të parashikura me ligj për mbrojtjen e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pra si një shkallë gjyquese përfundimtare.

Kërkesa individuale nuk mund të paraqitet para Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të tjera themelore, sepse ato individ i mbron drejtpërdrejtë në gjykatat e zakonshme. Kushtetuta e vitit 1998 bëri një ngushtim të kompetencave të këtij organi në lidhje me mundësinë e vënies në lëvizje të Gjykatës nga ana e individit. Në bazë të kësaj, individ nuk mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave apo lirive të tjera themelore të tij, përveç se për mbrojtjen e njëjës prej tyre për një proces të rregullt ligjor e sidoms nëse cenimi vjen prej një akti ligjor apo nënligjor. Kjo konsiderohet si një kufizim që Kushtetuta i bënë garantimit të të drejtave të tjera themelore.

¹²³Zaganjori, Xh., Anastasi, A., Cani (Methasani) E., Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Shtëpia Botuese Adelprint 2011, fq. 167, bazuar në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. 15 të datës 07.04.2000 a i arritshëm në linkun http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

¹²⁴Po aty, Cituar :Sadushi, S., Kontrolli Kushtetues, BOTIMPEX, Tiranë 2004 fq. 106-111

¹²⁵Kushtetua e Republikës së Shqipërisë, Cituar Nenet 131 f dhe 134/g

Kërkesa individuale ka karakter subsidar, paraqitet në Gjykatën Kushtetuese pasi shterohen të gjitha rrugët tjera të ankimit gjyqësor apo administrativ, mandej pretendime për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt, duhet të jetë konkret dhe jo i supozuar dhe kërkesa duhet të plotësojë edhe elementet e tjera të kërkuara për paraqitje të kërkesave në Gjykatën Kushtetuese si p.sh. *ajo të paraqitet jo më vonë se dy vjet nga konstatimi i shkeljes apo data e njoftimit të vendimit të organit përkatës, të jetë në gjuhën shqipe, e qartë dhe e kuptueshme.*¹²⁶

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta për një proces të rregullt ligjor parashikohet shprehimisht në nenin 42 si një e drejtë dhe liri themelore e individëve, i cili parashikon:

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

*2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.*¹²⁷

Në bazë të një analize që „të drejtën për një proces të rregullt ligjor” të parashikuar me Kushtetutë me „të drejtën për një proces të drejtë” parashikuar nga N.6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe lirive Themelore të Njeriut, edhe pse duhet thënë që e drejta për proces të rregullt ligjor është më i gjerë se ajo për një proces të drejtë, i cili lidhet me organe kryesisht gjyqësore. Kjo qasje është me rëndësi për vetë faktin se të kuptuarit drejtë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, do të ketë referim të gjerë tek interpretimet që ka bërë GJEDNJ mbi të drejtën për një proces të drejtë, por nuk mund të kufizohet vetëm në të. ¹²⁸

Kushtetuta ka përcaktim të qartë në këtë të drejtë, edhe pse nuk duhet harruar kuptimi që ka për të drejtat themelore të Republikës së Shqipërisë. Çdo e drejtë e Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe interpretimit që i bëhet asaj, e ka këtë të drejtë për një proces drejtpërfshirës. Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese nëpërmjet të jurisprudentës së saj ka konsoliduar kuptimin jo vetëm në interpretimin e drejtpërdrejtë të Kushtetutës, por edhe në referim të nenit 6 të KEDNJ apo praktikës së GEDNJ. Gjykata Kushtetuese nuk ka tentuar ta zëvendësojë gjyqësorin, por të jap kuptimin e të drejtës për një proces të rregullt si e drejtë kushtetuese.

¹²⁶Po aty , fq 84-85.

¹²⁷Kushtetua e Republikës së Shqipërisë , Cituar Neni 42

¹²⁸ Zaganjori, Xh., Anastasi, A., Cani (Methasani) E., Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Shtëpia Botuese Adelprint 2011 , fq 85-86 ,Cituar nga : Greer S, The European Convention on Human Rights : Achievements, Problems and Prospects, Cambridge University Press, Kembrixh, 2006.

Gjykata Kushtetuese në jurisprondencën e saj ka lidhur ngusht garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe elementet përbërse të saj me konceptin e shtetit të së drejtës, duke e konsideruar të parin element thelbësor të shtetit të së drejtës.¹²⁹

Kush konsiderohet „individ”, përveç personave fizikë që u elaborua më lartë, këtë të drejtë e kanë edhe presonat juridik. Neni 16/2 i Kushtetutës parashikon se edhe personat juridikë mund të jenë bartës i të drejtave dhe lirive themelore¹³⁰, për aq sa këto të drejta përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e vetë të të drejtave e lirive themelore.

Nisur nga ky përkufizim i Kushtetutës në vendimin e saj nr. 39/2003¹³¹ Gjykata Kushtetuese ka theksuar : „ *Personat juridikë të së drejtës private, janë përfitues të këtyre të drejtave e lirive dhe si të tillë, mund ta vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pretendime për proces jo të rregullt, sipas nenit 42 e 131/f të Kushtetutës. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe partitë politike e organizatat e tjera që kanë qëllim të mbrojnë liri e të drejta të veçanta të individëve si p.sh., të drejtën e zgjedhjes e lirinë e besimit*”.

Gjykata ka mbajtur një qëndrim paksa më ndryshe në lidhje me legjitimitimin e presonave juridik publike për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke konsideruar si themelin e kësaj të drejte mbrojtjen e sferës private të individit nga shteti. Kështu në të njëjtin vendim Gjykata thekson se „ *Çështja ndryshon për sa i përket personave juridikë publike. Ata ushtrojnë funksione shtetërore e marrin vendime pa qenë bartës të të drejtave e lirive themelore. Rregullimet dhe aktet që nxjerrin këto organe nuk mund të bëhen objekt i të drejtave themelore nga vetë ata, sepse mungon lidhja e tyre me qenien njerëzore. Qëllimi themelor i të drejtave dhe lirive është mbrojtja e sferës private të individit nga shteti, prandaj organizmat e vetë shtetit nuk mund të bëhen subjekte të të drejtave dhe lirive themelore gjatë kryerjes së detyrave shtetërore*”.¹³²

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë nuk e ka përjashtuar krejtësisht mundësinë e presonave juridikë për të vënë në lëvizje këtë organ për mbrojtjen e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke kushtëzuar ushtrimin e kësaj të drejte nga këto persona me pjesëmarrje në qarkullimin civil njësoj personat fizikë dhe me angazhimin e tyre në mbrojtjen e një fushe të caktuar të drejtash themelore që shërbejnë për forcimin e autonomisë së tyre. Gjykata në arsyetimin e saj

¹²⁹ Po aty, fq 86 q. 167, bazuar në Vendimet e Gjykatës Kushtetuese Nr. 6/2006, nr.6/2009, apo nr. 35/2010 etj.

¹³⁰ Kushtetua e Republikës së Shqipërisë, Neni 16 par. 2

¹³¹ Zaganjori, Xh., Anastasi, A., Cani (Methasani) E., Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Shtëpia Botuese Adelprint 2011, fq 87, bazuar në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.39 të datës 23.12.2003 në linkun: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

¹³² Po aty,

parashë se: „Si përjashtim, personat juridik publikë mund ta vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese kur ato marrin pjesë në qarkullimin civil dhe cenohen njëlloj sikur të ishin qytetarë të thjeshtë si dhe në rastet kur janë ngarkuar drejtëpërdrejtë me mbrojtjen e një fushe të caktuar të drejtash themelore që shërbejnë direkt për të forcuar autonominë e tyre”. Trajtimi si individ që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, në kuptimin e nenit 134/1 “g” në lidhje me nenin 16/2 të Kushtetutës dhe organit e pushtetit lokal, univerzitetet dhe stacionet radio-televizive. Duke mbajtur këtë qëndrim, Gjykata nuk e ka lidhur domosdoshmërisht ushtrimin e kërkesës për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese sipas nenit 131/f me natyrën e personit juridik, publik apo privat, por me natyrën e pretendimit që i parashtrohet Gjykatës.¹³³

Ky pretendim duhet të jetë i lidhur ngushtë me cenimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor që i është bërë personit juridik drejtpërsëdrejti (pasi të jenë shterur mjetet e tjera ligjore).

3.5 Reformat në drejtësi dhe Gjykata Kushtetuese, me theks në vettingun e gjyqtarëve kushtetues

Para se të fillojmë me shqyrtimin e Reformave në dretësinë e Republikës së Shqipërisë, kam parasysh shumë pyetje rreth „Vettingut”: ç’është?, kur u paraqit? për çfarë shërben?, dhe shumë çështje tjera?!

Dikush, për herë të parë hedh dritë mbi etimologjinë e „vettingut”. Është pikërisht pedagogu i njohur Erlis Hereni, i cili na jep një shpjegim tejet interesant për fjalën e vettingut. Etimologjia e fjalës „Vetting” daton nga fillimi i viteve 1860 dhe rrjedhë nga fjala Veteriner që e përshkruante procesin e kontrollit të shëndetit dhe përputhshmërisë së kuajve të garave përpara se ata të futeshin në pistën e vrapimit. Rëndësia ekonomike, spektakolare dhe procedurale, bartte kontrolli i veterinerit në një spektakël kaq popullor, fitimprurës (apo ekonomi shkatrruese), e bëri procesin të nevojshëm për kontrollë përpara se dikujt t’i besohej një detyrë e caktuar.

Pra „Vettingu” është proces kontrolli i detajuar për zyrtarët publik që në një shtet të së drejtës duhet të bëhet normalisht nga institucionet ligjor që zbatojnë ligjin.¹³⁴ Republika e Shqipërisë ka treguar se është në reformim të vazhdueshëm për të vendosur stabilitet dhe garanci demoratieke, por rruga e ndryshimeve nuk ka qenë e lehtë dhe mjaft e ndërlikuar.

¹³³Po aty, fq 88, bazuar në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.14/2009 në linkun: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

¹³⁴Pë më shumë në shkrimin e datës 26 shkurt 2018 në TV1-CHANEL, <http://tv1-channel.tv/2018/02/26/cfare-do-te-thote-vetting/>

Pas hyres në fuqi të Kushtetutës së vitit 1998, ajo është ndryshuar tri (3) herë. Ndryshimet nuk kanë pasur çdo herë efekt dhe ndikim pozitiv në organizimin dhe funksionimin e drejtësisë dhe veçanrisht ndryshimet e bëra në vitin 2008, të cilët ndër tjera ndryshuan formulën e zgjedhjes së Presidentit të Republikës. Një ndër problematikat ka qenë mos garantimi i një sistemi gjyqësor të pavarur dhe llogaridhënës.

Ndryshimet kushtetuese të bëra me 22 korrik 2016 u votuan unanimitet nga të gjithë 140 deputetët e Kuvendit. Miratimi i këtyre ndryshimeve ishte hapi i parë i rëndësishëm për përmirësimin radikal të sistemit të drejtësisë dhe rikthimin e besimit të qytetarëve tek pushteti gjyqësor.¹³⁵ Ndryshimet Kushtetuese përfshijnë edhe Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, ku Ligji nr. 99/2016 ndryshoi dhe plotësoi ligjin nr. 8577 e datës 10 shkurt 2000. Ky ligj përcakton rregullat e organizimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, statusin e gjyqtarit, paraqitjen e kërkesave dhe shqyrtimin e tyre, parimet dhe rregullat e gjykimit kushtetues, marrjen e vendimeve dhe ekzekutimeve të tyre. Ligji nr. 99/2016 synon të bëjë Gjykatën Kushtetuese më efektive në vendimmarrje si dhe forcon më shumë rolin dhe pavarësinë e plotë organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të caktuara në Kushtetutë si dhe funksionin e saj si organë që zgjedh mosmarrëveshjet e natyrës kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

Veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese drejtohet dhe organizohet nga Kryetari i saj dhe në mungesë të tij, zëvendësohet nga gjyqtari më i vjetër në detyrë. Mbështet në veprimtarinë e saj nga administrata e gjykatës, e cila përbëhet nga nënpunës civilë, njësia e shërbimit ligjor dhe nga punonjës të tjerë. Njësia e shërbimit ligjor përbën bërthamën shkencore juridike, e cila ka funksion këshillues dhe ndihmës në procesin e vendimmarrjes së Gjykatës duke përfshirë përgatitjen e çështjeve për gjykim, dhënien e opinionëve ligjore dhe përgatitjen e kërkimeve shkencore për çështjet gjyqësore që janë për shqyrtim.

Në këtë ligj parashikohen:

- *Procedura për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual,*
- *Procedura mbi pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën,*
- *Procedura mbi pajtueshmërinë e ligjve ose aktve tjera me Kushtetutën,*
- *Procedura lidhur me mosmarrëveshjet për kompetenca në mes pushteteve,*
- *Procedura për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së partive dhe organizatave politike,*
- *Procedura për shkarkimin e Presidentit të Republikës,*

¹³⁵Reforma në drejtësi MODUL TRAJNIMI PËR STUDENTËT JURIST DHE AKTIVIST TË SHOQËRIS CIVILE, Konrad Adenauer Stiftung, fq. 2, https://www.kas.de/documents/252038/253252/7_dokument_dok_pdf_52461_1.pdf/ba509f53-6191-0746-9cd2-975292ab417f?version=1.0&t=1539647466974

- *Procedura lidhur me referendumin ,*
- *Procedura mbi referimin incidental*.¹³⁶

Si u rrëzua Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ?!

Institucioni më i lartë gjyqësor në fillim të reformave të drejtësisë, kishte nëntë anëtarë, ndërsa tërheqjet nga detyra dhe vettingu i reduktuan në dy anëtarë dhe zëvendësimi i vendeve është në varësi të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ku edhe ky organ ka problemet e veta nga vakanca. Mosfunksionimi i përkohshëm i Gjykatës Kushtetuese është konsideruar si një problem i rëndë nga opozita politike, por edhe nga ekspertë të ndryshëm. Pavarësisht se shumica e anëtarëve të kësaj gjykate u rrëzuan në vetting ose u tërhoqën para vettingut, kjo gjykatë i është përgjigjur një numri të lartë kërkesash për antikushtetutshmëri ligjesh ose vendimesh qeverie, ndërsa së paku një ligj aktual i *Teatrit Kombëtar* ka ngritur pikëpyetje mbi kushtetutshmërinë. Mosfunksionimi i përkohshëm është njëra anë e problemit, ana tjetër është rreziku i vonësive të gjata të zëvendësimit të të gjithë anëtarëve që mungojnë si dhe faktin që kushtetuta e vitit 2016 nuk është krijuar me supozimin që shumica dërrmuese e gjyqtarëve kushtetues do të iknin apo rrëzoheshin.¹³⁷

Profesori i Drejtës Kushtetuese dhe ish anëtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Sokol Sadushi mes tjera thotë : „*Vetë drejtësia kushtetuese është një proces dhe thelbi i saj konsiston në respektimin e kushtetutës, si akti themeltar i shtetit, në rolin që ajo luan për kufizimin e pushtetit dhe të funksioneve të organeve shtetërore, me qëllim mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të individit. Drejtësia kushtetuese, e cila përbën një pengesë ndaj veprimeve arbitrare të mbartësve të funksioneve të pushtetit publik, bazohet në parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve dhe në veçanti në përfshirjen e Gjykatës Kushtetuese, si autoriteti më i lartë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe si një garant i respektimit të epërsisë së kushtetutës në raport me normat e tjera të së drejtës. Rëndësia e kontrollit të kushtetutshmërisë qëndron në faktin se, në një mosmarrëveshje të lindur, ndërmjet shqyrtimit dhe vlerësimit të kushtetutshmërisë, Gjykata zgjidh rastin konkret në raport me të drejtën dhe në veçanti me Kushtetutën. Gjykatat kushtetuese janë pajisur me pushtet të gjerë në fushën e drejtësisë kushtetuese, por efekti më domethënës i tyre mbetet në kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit dhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pushteteve*”.

¹³⁶ Po aty, fq . 12-13

¹³⁷ Për më shumë në shkrim e datës 26 korrik 2018 në faqen Reporter.al , linku : <https://www.reporter.al/si-u-rrezua-gjykata-kushtetuese/>

¹³⁸ Për më shumë shih në linkun: <https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2013/01/tema-20-vjet-GJK.pdf>

Në vijim do të japim statistikën të marrura në faqen e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë mbi Statistikën e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2019 :


A. KËRKESAT DREJTUAR GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË VITIT 2019

Në vitin 2019 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë janë paraqitur dhe regjistruar në total 50 kërkesa, nga të cilat:

- 29 kërkesa janë paraqitur për kundërshtim vendimeve të gjykatave të zakonshme, në kuadër të procesit të rregullt ligjor;
- 3 kërkesa janë paraqitur për konstatim të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor;
- 14 kërkesa janë paraqitur për papajtueshmëri të ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën;
- 1 kërkesë është paraqitur për zgjidhje të mosmarrëveshjes së kompetencës;
- 1 kërkesë është paraqitur për kundërshtim vendimi të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
- 2 kërkesa janë paraqitur për kundërshtim të vendimeve të Këshillit të Ministrave.

GRAFIKONI 6 :

KËRKESA TË PARAQITURA GJATË VITIT 2019




- | | | |
|--|-------------------------|---|
| ■ Për proces të parregullt 29 | ■ Konstatim cenimi 3 | ■ Papajtueshmëri të ligjeve 14 |
| ■ Vendime të Këshillit të Ministrave 2 | ■ Vendime të Kuvendit 1 | ■ Zgjidhje e mosmarrëveshjes për kompetencë 1 |

Sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese (sipas nenit 134 të Kushtetutës), gjatë vitit 2019 janë paraqitur:

- 1 kërkesë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë;
- 1 kërkesë nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë;
- 7 kërkesa nga gjykatat (kontroll incidental);
- 1 kërkesë nga Organet e Qeverisjes Vendore;
- 3 kërkesa nga organizatat;
- 37 kërkesa nga individët;

GRAFIKONI 7



B. VENDIMMARRJA E GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË VITIT 2019

Gjatë vitit 2019 Gjykata Kushtetuese:

- ka kaluar 4 kërkesa për shqyrtim në seancë plenare;
- ka kaluar 2 kërkesa për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve;
- për 40 kërkesa ka vendosur moskalimin e tyre për shqyrtim në seancë plenare (vendime moskalimi).

Referuar kërkesave të kaluara për shqyrtim në seancë plenare:

- 1 kërkesë është paraqitur nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë;
- 1 kërkesë është paraqitur nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë;
- 1 kërkesë është paraqitur nga gjykatë, në kuadër të kontrollit incidental, sipas parashikimeve të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës;
- 1 kërkesë është paraqitur nga individ.

Referuar kërkesave të kaluara për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve:

- 1 kërkesë është paraqitur nga organizatë (Shoqata e Bashkive të Shqipërisë);
- 1 kërkesë është paraqitur nga individ;

Referuar vendimeve të moskalimit:

Kolegjet e kësaj Gjykate janë shprehur me vendim për 40 kërkesa, bazuar në nenin 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr.8577/2000). Nga këto, sipas rasteve dhe shkaqeve ligjore, të parashikuara në nenet 31/2, dhe 31/a/2, nga Kolegjet është vendosur për sa vijon:

- për 4 kërkesa: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, për shkak se kërkimet nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese;
- për 6 kërkesa: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, për shkak se kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet;
- për 15 kërkesa: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, kur vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor;
- për 7 kërkesa: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, pasi kërkuar nuk ka shteruar mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ose legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive në dispozicion;
- për 3 kërkesa: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, pasi kërkesa është haptazi e pabazuar;

- për 1 kërkesë: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, pasi kërkimet të cilat nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese; si dhe kur vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor;
- për 1 kërkesë: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, pasi vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor, si dhe kërkuksi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ose legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive në dispozicion;
- për 1 kërkesë: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, pasi kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet, si dhe është haptazi e pabazuar;
- për 1 kërkesë: “Moskalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë plenare”, pasi kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet, si dhe është haptazi e pabazuar;

Nga totali i vendimeve të dhëna gjatë vitit 2019 (40 vendime):

- 30 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura në vitin 2018;
- 10 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura në vitin 2019¹³⁹

¹³⁹Të dhënat janë marur nga web faqja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë në linkun : http://www.gjk.gov.al/web/Statistikat_per_veprimtarine_e_Gjykates_Kushtetuese_gjate_vitit_2019_1698_1-1333.php

KAPITULLI I KATËRT

ASPEKTET KRAHASUESE TË MBROJTJES SË LIRIVE DHE TË DREJTAVE THEMELORE TË NJERIUT DHE TË QYTETARIT NGA GJYKATAT KUSHTETUESE E MAQEDONISË SË VERIUT, KOSOVËS DHE SHQIPËRISË

4.1. Aktivizmi gjyqësor i Gjykatës Kushtetuese të RMV-së në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit-analiza e jurisprudencës kushtetuese

E drejta për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut është e garantuar me anë të Kushtetutës në Nenin 110 alinea 3 :

„Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimeve, bashkimit dhe veprimin politikë dhe ndalimin e diskriminimit të qytetarëve mbi bazë të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë kombëtare, sociale dhe politike”.¹⁴⁰

Për të analizuar punën e Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut kam hulumtuar raportet vjetore pesë vjeçare të punës së Gjykatës me theks të veçant në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në një periudhë kohore nga viti 2009-2013.

Gjatë vitit 2009 ka pasur gjithsej 423 lëndë në Gjykatën Kushtetuese, ku edhe 113 të tjera janë bartur nga viti 2008. Gjatë këtij viti janë përfunduar gjithsej 282 lëndë dhe 141 kanë ngelur të papërfunduara 141, 5 nga viti 2008 dhe 136 nga viti 2009.

Në këtë viti janë paraqitur gjithsej 15 iniciativa për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave në bazë të nenit 110 alinea 3 e Kushtetutës, ku 9 janë për diskriminim , 3 për mbrojtje të lirisë së besimit dhe një për mbrojtje për gjykim të drejtë të paanshëm dhe fer. Gjatë shqyrtimit të këtyre iniciativave nga ana e Gjykatës 14 kërkesa janë hedhur poshtë si të pa baza, sepse palët është dashur t’ju drejtohen gjykatave të zakonshme. Në një rast të vetëm të pranuar parashtuesi i iniciativës kërkoi mbrojtjen e lirisë dhe bashkimit politikë. U mbajt seanca dëgjimore publike nga ana e Gjykatës, në mënyrë që ky rast të vendoset në vitin 2010.¹⁴¹

¹⁴⁰ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut neni 110 alinea 3, (marur nga Shasivari, Jeton, „E drejta kushtetuese”, .Shkup, 2020 Furkan ISM , fq. 440)

¹⁴¹ Pjes nga Raporti i vitit 2009 i Gjykatës Kushtetuese të RVM-së i publikur më 18 shkurt 2010 i marur nga web faqja e Gjykatës <http://ustavensud.mk/?p=12531>

Gjatë vitit 2010 ka pasur gjithësej 371 lëndë, ku 230 janë pranuar gjatë vitit, kurse 141 janë bartur nga viti 2009. Të përfunduar janë 245 lëndë, kurse 126 lëndë ngelën të papërfunduar një nga 2008, 11 nga 2009 dhe 114 nga 2010.

Kërkesa për mbrojtjen e të drejtave nga neni 110 alinea 3 e Kushtetutës janë pranuar gjithësej 9 iniciativa. Në 5 iniciativa, Gjykata vendosi për hedhje poshtë me vendim për shkak se nuk ishte kompetente për të vendosur, për një iniciativë Gjykata hodhi poshtë me vendim për shkak të procesit të vendimarrjes së supozuar, për 2 iniciativa Gjykata i hodhi poshtë për shkak se nuk janë paraqitur në afatin kohor. Një rast i vetëm që ka vendosur është bartur nga viti 2009 dhe bëhet fjalë për **Vendimin U.nr 84/2009 të datës 10 shkurt 2010**, ku Gjykata vendosi se personit **Xhavit Rushani** me adresë nga fshati Zajas, i është shkelur e drejta për veprim dhe bashkim politikë e garantur me Kushtetutë dhe nuk është pranuar kandidatura e tij për Kryetar të Komunës së Zajsit në zgjedhjet lokale të mbajtur në mars të vitit 2009. Në të njejtën kohë Gjykata anuloi vendimin përfundimtar dhe të plotëfuqishëm me nr. 01-32/2 të datës 6 shkurt 2009 i sjellur nga Komisioni Komunal Zgjedhor –Zajas.¹⁴²

Gjatë vitit 2011 ka pasur gjithësej 361 lëndë në Gjykatën Kushtetuese, 236 janë pranuar gjatë vitit 2011, kurse 125 janë bartur nga vitet paraprake. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve në Gjykatë të kryera janë 231 lëndë, kurse pjesa tjetër e mbetur 130 lëndë janë të papërfunduara (115 nga vitet paraprake).

Gjatë këtij viti Gjykata kishte në shqyrtim 27 iniciative për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të bazuara në nenin 110 alinea 3 e Kushtetutës, ku 23 janë të inicuar në vitin 2011 që ishte numri më i madh në pesë vjeçarin e fundit të drejtuar si iniciativa të këtij lloji. Gjykata gjatë vitit kalendarik kishte vendosur për 23 lëndë, ku në 3 raste me vendim ishin hedhur si të pa bazë, sepse nuk ishin gjetur shkelje.

Bëhet fjalë për 3 raste edhe ate:

- *Vendimi U.nr. 107/2010*, Gjykata e hedh poshtë iniciativën e personit Levko Tanevski, avokat nga Shkupi, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të bazuara në nenin 110 alin. 3, në lidhje me shprehjen e opinionit publikë të garantuar me nenin 16 të Kushtetutës, i dëmtuar me *Aktgjykim K.nr. 80/2010* e sjellur nga Gjykata Themelore në Shtip më 12 dhjetor 2009 dhe *Aktgjykimin K.ZH. nr. 94/10* e sjellur nga Gjykata e Apelit në Shtip më 22 mars 2010. Duke u bazuar në fakte dhe rrethana konkrete, pikëpamjet dhe kritikën kishin tejkaluar kufirin e tolerancës së mundëshme, d.m.th. tejkaluan kufijtë e lejuar dhe kështu shkelën nderin dhe

¹⁴² Pjesë nga Raporti i vitit 2010 i Gjykatës Kushtetuese të RVM-së i publikur më 24 shkurt 2011 i marur nga web faqja e Gjykatës <http://ustavensud.mk/?p=12528>

reputacionin e avokatisë. Gjykata konstatoi se gjykata e shkallës së parë dhe të dytë nga përcaktimi i të gjitha fakteve dhe rethanave përkatëse ligjore dhe marrja e vendimve që janë ankimuar kanë vepruar brenda sferës së kompetencave të tyre gjyqësore, prandaj nuk mund të jetë shkelje e së drejtës për lirinë e shprehjes dhe mendimit publik.

- *Me Vendim U.nr 146/2010*, Gjykata refuzoi kërkesën e Jani Makradulit me vendbanim në Shkup, i përfaqësuar nga i autorizuari S.S avokat, për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit të garantuara me nenin 110 alin. 3 e Kushtetutës së RMV-së, për sa i përket lirisë së besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimt. Mënyrën në të cilën parashtuesi i iniciativës deklaroi publikisht dhe shprehu mendimin e tij në lidhje me kryerjen dhe ushtrimin e funksionit publik (në formë pyetje, si anëtar i partisë politike opozitare dhe nga foltorja e partisë politike, pasojat që vijnë nga paraqitja publike,...) pa u angazhuar në vërtetimin e vërtetësisë së pyetjes ose deklaratës të analizuar në tërësinë e tyre, është një veprim i cili siç duket vetëm i përket lirisë së besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, por në thelb ai bën pjesë në nderin dhe reputacionin e qytetarit, i cili aktualisht kryen funksione publike dhe shkel padrejtësisht ato vlera dhe me këtë deklaratë ka humbur përmbajtjen dhe të njejtat i ka keqpërdorur. Aktgjykimet e diskutueshme nuk e cenojnë garantimin e kushtetutshmërisë së lirisë së besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit.
- *Me Vendim U.nr. 147/2011* e hedh poshtë kërkesën e Lubomir D. Frçkovskit me adresë banimi në Shkup, për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit të garantuara me nenin 110 alin. 3 e Kushtetutës së RMV-së në lidhje me të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, e garantuar me nenin 16 të Kushtetutës, ku parashtuesi i iniciativës beson se i janë shkelur me *Aktgjykimin K. nr 991/09* të datës 01 tetor 2010 e sjellur nga Gjykata Themelore Shkup I dhe me *Aktgjykimin KZH.nr.332/11* të datës 7 mars 2011 e sjellur nga Gjykata e Apelit në Shkup. Në bazë të Gjykatës, gjykata e shkallës së parë dhe të dytë, në përcaktimin e të gjitha fakteve dhe rethanave të rëndësishme juridike dhe marrjen e vendimeve për veprave penale „shpifje” dhe „fyerje”, ata kanë vendosur në fushën e juridiksionit të tyre, prandaj nuk mund të jetë shkelje e të drejtës së lirisë së shprehjes publike, sepse kërkuesi nuk mund që duke përdorur lirinë e shprehjes publike, të rrezikohet e drejta e garantuar e një qytetari tjetër. ¹⁴³

¹⁴³ Pjes nga Raporti i vitit 2011 i Gjykatës Kushtetuese të RVM-së i publikur më 6 mars 2012 i marur nga web faqja e Gjykatës <http://ustavensud.mk/?p=12525>

Gjatë vitit 2012 ka pasur gjithësej 335 lënd, 205 lënd janë pranuar gjatë vitit kalendarik, kurse 130 janë bartur nga vitet paraprake. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve 239 janë përfunduar, kurse 96 mbeten të papërfunduara.

Gjatë këtij viti Gjykata ka pranuar 25 iniciativat për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të bazuara në nenin 110 alin. 3 të Kushtetutës së RMV-së dhe ka vendosur për 27 lëndë të llojit të njejtë. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve, 15 kërkesa kanë të bëjnë për mbrojtje nga diskriminimi, 11 kërkesa kanë të bëjnë me mbrojtje të lirisë së besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit dhe një kërkesë për mbrojtje të lirisë dhe bashkimit politik.

Në 6 kërkesa Gjykata i ka hedhur si të pa baza, sepse nuk ka gjetur shkelje të pretenduar që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive që palët kishin kërkuar (4 raste kishin të bëjnë me pretendimin se janë shkelur të drejtat e mendimit dhe shprehjes publike të mendimit. Një rast kishte pretendim për diskriminim social dhe një rast kishte pretendim për shkelje në bazë të religjionit).¹⁴⁴

Gjatë vitit 2013 ka pasur gjithësej 268 lënd, 170 lënd janë pranuar gjatë vitit kalendarik, kurse 98 lënd janë bartur nga vitet paraprake. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve 142 janë kryer, kurse 126 mbeten të pakryera.

Gjatë vitit kalendarik janë pranuar 22 kërkesa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të bazuara në nenin 110 alin. 3 të Kushtetutës. Gjykata ka vendosur për 13 lëndë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave dhe 10 kërkesa janë për mbrojtje nga diskriminimi. Tri kërkesa janë për mbrojtje të lirisë së besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit. Të gjitha iniciativat drejtuar Gjykatës për mbrojtje të të drejtave dhe lirive janë hedhur poshtë për shkak të pakompetencës, 6 kërkesë dhe për shkak të pengesës procedurale në vendimarrje 7 kërkesa.¹⁴⁵

TABELA 7:

Forma tabelare e iniciativave drejtuar Gjykatës Kushtetuese në periudhën 2009-2013

Iniciativa	2009	2010	2011	2012	2013
Lëndë në Gjykatë	423	371	361	335	268

¹⁴⁴ Pjes nga Raporti i vitit 2012 i Gjykatës Kushtetuese të RVM-së i publikur më 11 mars 2013 i marur nga web faqja e Gjykatës <http://ustavensud.mk/?p=12522>

¹⁴⁵ Pjes nga Raporti i vitit 2013 i Gjykatës Kushtetuese të RVM-së i publikur më 03 prill 2014 i marur nga web faqja e Gjykatës <http://ustavensud.mk/?p=12519>

Të pranura gjatë vitit kalendarik	310	230	236	205	170
Të bartura nga vitet paraprake	113	141	125	130	98
Të përfunduara gjatë vitit kalendarik	282	245	231	239	142
Lëndë të papërfunduara gjatë vitit kalendarik	141	126	130	96	126
Iniciativa drejtuar Gjykatës për mbrojtje dhe të drejtave në bazë të nenit 110 alin.3 e Kushtetutës	15	9	27	25	22-9 janë bartur në vitet në vijim
Të bartura nga vitet paraprake	/	1	4	2	/
Të hedhura posht	14	9	26	27	13
Të vendosura	/	1	/	/	/

Nga tabela shihet se për periudhën 5 vjeçare 2009-2013 vetëm rasti **U. Nr. 84/2009** i inicuar më **vitin 2009** dhe i shqyrtuar dhe vendosur më **10 shkurt 2010** është gjetur shkelje e të drejtave dhe lirive të garantuara me nenin 110 alin.3 që ka të bëjë me shkeljen e të drejtës për bashkim dhe veprim politik.

Rastet e përzgjedhura#

Vendimi i Gjykatës Kushtetutes të Maqedonisë së Veriut U. Nr. 84/2009 i datës

10 shkurt 2010

Xhavit Rushani me adresë banimi në fshatin Zajas të Kërçovës, nëpër mjet të përfaqësuesve ligjorë- Avokatëve të tij D.G dhe A.G nga Ohri ngriti iniciativë deri në Gjykatën Kushtetuese të RMV-së, për shkak se i mohoj apo i shkelej *e drejta për bashkim dhe veprim politikë të garantuara me nenin 110 alin.3* e Kushtetutës, i mohoj e drejta për kandidim për Kryetar të Komunës së Zajsit në zgjedhjet lokale të 22 marsit 2009 nga ana e Komisionit Komunal Zgjedhor të Zajzit.

Më datë 22 tetor 2009 në Gjykatën Kushtetuese u mbajt seancë dëgjimore dhe u sollën të gjitha faktet dhe dokumentet e nevojshme. Gjykata konsatoti se Komisioni Komunal Zgjedhor- Zajaz në bazë të nenit 67 pika 4 të Ligjit mbi zgjedhjet, ka sjellur Vendimin 01-31/2 të datës 06 shkurt 2009

, ku listën për kandidat për Kryetar të Komunës së Zajazit e ka dorëzuar Begsat Useini dhe e njëjta është refuzuar. Me arsyetimin e Vendimit se i nominuari si kandidat për Kryetar të Komunës së Zajzit, Xhavit Rushani, shikuar shkresën Nr. 11-258/3 të 04 shkurt 2009 nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor nga të dhënat në evidencën penale të kryer nga MPB nuk i plotëson kushtet për zgjedhje të bazuara në nenin 7 pika 2 alin. 4 të Kodit Zgjedhor.

I pakënaqur nga Vendimi, kandidati për Kryetar të Komunës të Zajzit, Xhavit Rushani përmes Avokatit D. G ngriti padi para Gjykatës Administrative, duke potencuar se nuk janë të sakta vlerësimet e KQZ-së, se nuk i plotëson kushtet në bazë të nenin 7 pika 2 alin. 4 të Kodit Zgjedhor, duke sjellë edhe Çertifikatën e Gjykatës Themelore të Kërçovës me numër K.R.nr. 222/09 të datës 06 shkurt 2009 dhe njoftimin se nuk ka qënë i dënuar dhe nuk ka të ngritur padi penale ndaj tij me numër PS Kërçovë 28.12.1/84. Në bazë të kësaj propozon që Gjykata Administrative të hedh poshtë Vendimin e Komisionit Zgjedhor Komunal- Zajaz dhe të pranohet kandidatura për Kryetar të Komunës.

Gjykata Administrative vendosi në bazë të padisë së ngritur më 06 shkurt 2009 dhe sjell Vendimin UR. Nr 122/2009 ku padia e ngritur nga ana e paditësit Xhavit Rushani kundër Vendimit të Komisionit Zgjedhor Komunal- Zajaz 01-31/2 e datës 06 shkurt 2009 hedhet poshtë. Në bazë të arsyetimit të Vendimit, Gjykata Administrative në bazë të gjitha fakteve dhe argumenteve juridike vlerësoi se Komisioni Zgjedhor Komunal -Zajaz ka vepruar në mënyrë të drejtë pasi që Vendimi i paditur dhe listat për kandidatë të mundshëm për Kryetar Komune të Zajazit i ka dorëzuar Begzat Huseini. Më tej në arsyetim Gjykata Administrative thekson se padia nuk është ngritur nga propozuesi i listës, por nga vetë kandidati i mundshëm nëpër mes avokatit të tij dhe në bazë të dispozitave ligjore nuk ka qënë i autorizuar të ngris padi dhe në bazë të kësaj padia është ngritur nga personi jo kompetent dhe Gjykata e përjashtoi atë sipas nenit 60 pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Kandidati për Kryetar Komune më 7 shkurt 2009 paraqet një rastë emergjent deri tek Komisioni Shtetëror Zgjedhor ku kërkon që kandidatura e tij të analizohet duke zbatuar dispozitat ligjore të Kodit Penal të RM-së. Përmbajtja e letrës zyrtare e dërguar nga MPB për dënimin e tij dhe evidencën nga të dhënat penale duke zbatuar dispozitën e nenit 104 të Kodit Penal dhe për të marrë një vendim të drejtë juridik. Në mënyrë plotësuese më 12 shkurt 2009 deri tek Komisioni Shtetëror Zgjedhor dhe Komisioni Komunal Zgjedhor – Zajaz si dëshmi se nuk ka pengesa ligjore për pranimin e kandidaurës ka paraqitur Vendimin e Gjykatës së Apelit në Shkup me numër KS nr. 80/03 të datës 12 mars 2003 dhe Vërtetim të Evidencës Penale.

Parashtruesi i listës Begzat Huseini i kandidatit për Kryetar Komune Xhavit Rushanit, më datë 15 shkurt 2009 deri tek Komisioni Shtetëror Zgjedhor dhe Komisioni Zgjedhor Komunal – Zajaz, paraqiti

akt – kërkesë për Vendim, duke deklaruar se më 12 shkurt 2009 në ora 11: 50 para Komisionit Zgjedhor Komunal – Zajaz, kanë dorëzuar tërë dokumentacionin e nevojshëm për kandidat për Kryetar të Komunës së Zajzit dhe e njëjta kandidaturë është dorëzuar në ora 14:05 përpara Komisionit Shtetëror Zgjedhor. Ata deklarojnë se gojarisht kanë qenë të informuar nga ana e anëtarëve të Komisionit Zgjedhor Komunal – Zajaz, se kandidatura refuzohet për shkak të vendimit të Gjykatës Aministrative. Deri në ditën e dorëzimit të kësaj kërkesë nuk ka pranuar përgjigje me shkrim.

Më 19 qershor 2009 me kërkesë të Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Komisionit Komunal Zgjedhor të Zajazit ka dorëzuar dokumente të vlerësuara si konfidenciale ku MPB i ka dorëzuar këtij Komisioni me numër Sd. Nr 18.3-647 të datës 04 shkurt 2009, ku thuhet se personi në fjalë është regjistruar në evidencën penale që udhëheq MPB me këto të dhëna: „Gjykata Themelore Shkup I me aktgjykim K 1149/01 të datës 29 shtator 2001 e dënon me një vit burgim për veprën penale në bazë të nenit 391 pika 1 e Kodit Penal të R.M-së”.

Në bazë të dokumenteve të dorëzuara së bashku me kërkesën, kishte të bashkangjitur edhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me numër të lëndës KS nr. 80/03 të datës 12 mars 2003, që mbështet kërkesën e të pandehurit Xhavit Rushani nga fshati Zajaz i Kërçovës për amnesti dhe është ndaluar procedura e ndjekjes penale ndaj të pandehurit në fjalë përpara Gjykatës Themelore Shkup I me numër të lëndës K nr. 1149/01 e ngritur nga Prokuroria Themelore e Shkupit me numër të lëndës KO nr. 2143/01 të datës 18 gusht 2001 për veprën penale – Mbajtje dhe posedim të armëve dhe eksplozivëve në bazë të nenit 396 pika 1 dhe 2 e Kodit Penal të RM-së për shkak të egzistencës së bazës juridike të parashikuar në nenin 1 paragrafi 1 i Ligjit për Amnesti (Gazeta Zytare e RM-së me nr. 18 e datës 08 mars 2002) personi në fjalë ishte i amnestuar në bazë të ligjit dhe me këtë ligj përfshihen dhe lirohen nga ndjekja penale dhe aktakuzat e qytetarëve të RM-së dhe ndërpriten të gjitha ekzekutimet e sanksioneve me burgim ndaj atyre që kanë bazë të dyshmta apo kanë kryer vepra penale që ka të bëjë me Konfliktin e vitit 2001 në një periudhë kohore prej 01 .01 e deri më 26.09.2001.

KONKLUZION

- Në bazë të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni Komunal Zgjedhor – Zajaz dhe Gjykata Aministrative, në zhvillimin e procedurës zgjedhore, ishin të detyruara që ligjin ta interpretojnë në dobi e jo në dëm të qytetarit si në rastin konkretë. Nisur nga faktet që Shteti, nëpër mes të organeve shtetërore, lejoi që të dhënat e pa sakta të jenë pengesa kryesore e qytetarit dhe të realizojë të drejtën e kandidimit për Kryetar Komune të Zajazit që kishte të drjetën pasive, pra kandidimi dhe votimi i kishin plotësuar të gjitha kushtet ligjore për këtë funksion. Gjykata Kushtetuese vlerëson se hedhja

poshtë e kandidaturës së tij për Kryetar Komune në thelb i mohohet e drjeta e garantuar me Kushtetutë për veprim dhe bashkim politikë dhe pas kësaj candidature ishte iniciativa e qytetarëve në përputhje me rregullat e përhershme juridike.

Në bazë të kësaj Gjykata Kushtetuese, PËRCAKTON (VËRTETON) që qytetarit XHAVIT RUSHANI nga fshati Zajaz i Kërçovës, i është shkelur e drejta për veprim politikë me hedhjen poshtë të kandidaturës së tij për Kryetar të Komunës së Zajazit në Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 22 mars 2009.

ANULOHET Vendimi përfundimtar dhe i plotëfuqishëm me numër 01-31/2 i datës 06 shkurt 2009 i sjellur nga Komision Zgjedhor Komunal – Zajaz.

Këtë vendim Gjykata Kushtetuese e solli me votim të të gjithë gjyqtarëve me datë 10 shkurt 2010 në Shkup.

Vendimi publikohet në „Gazetën Zyrtare” të RM-së.¹⁴⁶

***Vendimi i Gjykatës Kushtetutes të Maqedonisë së Veriut U. Nr. 116/2017 i datës
27 qershor 2017***

Goce Markovski dhe Gorast Muratovski, të dy nga Shkupi, të përfaqësuar nga avokati P.Z, avokat nga Shkupi dorëzuan në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut një kërkesë për mbrojtje të lirive dhe të drejtave nga neni 110 alin. 3 e Kushtetutës në lidhje me të drejtën e lirisë së mendimi dhe shprehjes publike të mendimit dhe ndalimit të diskriminimit për shkak të përkatësisë politike.

Sipas pretendimeve në kërkesën e datës 29.07.2017 aplikantët, të cilët ishin anëtarë të partisë politike "E majta", së bashku me dy persona të tjerë, organizuan një protestë paqësore gjatë prezantimit të pajisjeve ushtarake amerikane dhe ARM-së. Gjatë ngjarjes, ata donin të dërgonin një mesazh me një pankartë "Kundër Luftës së Fitimeve". Qëllimi i anëtarëve të partisë politike ishte të tregonin se ata janë kundër militarizimit të shoqërisë, kundër militarizmit të përhapur nga SH.B.A. duke demonstruar fuqi në Maqedoninë e Veriut. Ata menduan se me parullën e tyre të shkruar në pankartë, do t'i dërgonin një mesazh, pasi deklarojnë: *"Me këtë paradë ushtarake ne kemi dërguar një ftesë të drejtpërdrejtë për terroristët se në këtë vend nuk jemi në gjendje të merremi me një stuhi të madhe dhe ne duam që paratë të shpenzohen për arsim dhe shëndet të mirë."*

Policët i paralajmëruan që të largoheshin me flamurin nga sheshi "Maqedonia" dhe pas kësaj personat vazhduan në Qendrën Tregtare të Qytetit dhe u ngjitën në katin e dytë, ku u përpoqën të shfaqnin flamurin me mesazh. Në atë moment u arrestuan nga oficerët e policisë dhe u prangosën.

¹⁴⁶Vendimi i plot **Y.6p. 84/2009** i datës **10 shkurt 2010** është i publikuar në Wep faqen e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së në linkun <http://ustavensud.mk/?p=10134>

Ata u mbajtën në atë gjendje rreth 15 minuta dhe mandej në koordinim me eprorët e tyre, policët i morën prangat nga duart e tyre dhe i identifikuan.

Ngjarja iu raportua Sektorit të Kontrollit të Brendshëm, Kriminalistikës, Hetimeve dhe Standardeve Profesionale në Ministrinë e Brendshme dhe Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ishin marrë masa disiplinore ndaj oficerëve të policies dhe u njoftua Zyra e Prokurorit Publik Themelor në Shkup.

Kërkesa shprehet se sjellja e oficerëve të policisë ishte jashtë kompetencave të tyre ligjore në pengimin e lirisë për shprehje të opinionit publik të garantuar me nenin 16 të Kushtetutës, si dhe në kundërshtim me nenin 54 paragrafi 4 të Kushtetutës, i cili thotë se liria e shprehjes publike të mendimit mund të mos jetë e kufizuar dhe deklarojnë se Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, në nenin 10 garanton lirinë e shprehjes dhe të drejtën e transmetimit të informacionit dhe ideve pa ndërhyrjen e autoritetit publik.

Gjykata në seancën publike dhe nga inspektimi i provave të paraqitura dhe të marra përcaktoi se më 29.07.2017, G. Markovski dhe G. Muratovski, së bashku me dy persona organizuan një protestë paqësore gjatë prezantimit të pajisjeve ushtarake Amerikane dhe ARM-së. Gjatë ngjarjes, ata donin të dërgonin një mesazh, duke shfaqur një flamur të shkruar në një kanavacë *"Kundër Luftës për Fitim"*.

Qëllimi ishte të tregonin se janë kundër militarizimit të shoqërisë dhe menduan se me parullën e shkruar të dërgonin një mesazh siç deklarojnë: "Me këtë paradë ushtarake ne kemi dërguar një ftesë të drejtpërdrejtë për terroristët dhe se si një vend nuk jemi në gjendje të merremi me një stuhi të madhe. "Ne duam që paratë të shpenzohen për arsim dhe shëndet të mirë." Në mesin e protestuesve ishte edhe një aktivist civil dhe gazetar në OJQ "Civile".

Policët i paralajmëruan që të largoheshin nga Sheshi Maqedoni. Personat vazhduan në Qendrën Tregtare të Qytetit me flamurin e ngritur lart. Në atë moment, ata u arrestuan nga oficerët e policisë dhe u prangosën. Ata u mbajtën në atë gjendje për rreth 15 minuta, pas së cilës, në koordinim me eprorët e tyre, policët i hoqën prangat nga duart dhe i identifikuan. Privimi i lirisë është një pengesë për të ngritur flamurin e tyre dhe përcjelljen e mesazhit të tyre për publikun.

Nga inspektimet, Departamenti i Kontrollit të Brendshëm, Hetimeve Kriminale dhe Standardeve Profesionale, përcaktoi që oficerët e policisë tejkaluan autorizimet e tyre zyrtare kur përdorën mjetet e shtrëngimit "dorezë dhe shishe" dhe mjetet e lidhjes së "prangave". Në të njëjtën kohë, ky Departamenti paraqiti një njoftim në Prokurorinë Publike Shkup, me qëllim të njohjes dhe marrjes së masave në kompetencën e tyre.

Në zbatim të nenit 110 pika 3 të Kushtetutës së RVM-së, Gjykata Kushtetuese mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit në lidhje me lirinë e besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, shoqatës politike, mendimit politikë dhe diskriminimin ndaj qytetarëve për shkak të seksit, racës, fesë, kombësisë, përkatësisë shoqërore dhe politike.

Çdo qytetar, i cili konsideron se e drejta ose liria e tij / saj e përcaktuar me nenin 110 alin. 3 e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut është shkelur nga një akt ose veprim individual, mund të kërkojë mbrojtje nga Gjykata Kushtetuese brenda 2 muajve nga dita e dorëzimit të aktit individual ose të formës së prerë, d.m.th. nga dita e zbulimit për ndërmarrjen e veprimeve me të cilat është kryer shkelja, por jo më vonë se 5 vjet nga dita e ndërmarrjes së saj.

Sipas nenit 9 të Kushtetutës së RMV-së, qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të barabartë në liritë dhe të drejtat, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, origjina kombëtare dhe shoqërore, bindjet politike dhe fetare, prona dhe statusi shoqëror. Qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve. Sipas nenit 16 të Kushtetutës, i cili i referohet lirive dhe të drejtave civile dhe politike, garantohet liria e besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit. Liria e fjalës, paraqitja publike, informacioni publik dhe krijimi falas i institucioneve të informacionit public, janë të garantuara. Qasja e lirë në informacion, liria e marrjes dhe transmetimit të informacionit është e garantuar. E drejta e përgjigjes në media është e garantuar. E drejta për korrigjim në media është e garantuar. E drejta për mbrojtje të burimit të informacionit në media është e garantuar, censurimi është i ndaluar.

Liria e shprehjes është një e drejtë subjektive që është e lidhur në mënyrë të pandashme me personin njerëzor dhe është parakusht për realizimin e shumë lirive dhe të drejtave të tjera. Garancia e kësaj lirie në Kushtetutë është në atë nivel që mundëson realizimin e saj të drejtpërdrejtë, pa përkrahjen e një rregulloreje të veçantë ligjore dhe në të njëjtën kohë mundëson mbrojtjen e saj të drejtpërdrejtë në bazë të Kushtetutës, nga Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 110 alin. 3 e Kushtetutës. Kufizimi i lirisë së shprehjes mund të justifikohet vetëm me domosdoshmëri imperative dhe imponon ekzistencën e një nevoje urgjente shoqërore, pra një qëllim dhe domosdoshmëri të ligjshme në një shoqëri demokratike.

Sidoqoftë, sipas Gjykatës, provat e paraqitura vërtetuan se të dy aplikuesit për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kishin karakteristikat e mbrojtura, d.m.th. veçori që konfirmojnë se ata janë anëtarë të partisë politike "E majta". Përkatësisht, anëtarët e Ministrisë së Brendshme, u informuan për protestën paqësore, për të cilën në kuptim të nenit 21 të Kushtetutës, ata nuk janë të detyruar të raportojnë paraprakisht dhe një leje të veçantë dhe vetëm kundër tyre u drejtuan disa veprimtari dhe veprime, d.m.th. u privuan nga liria dhe kështu shkelën të drejtat e tyre për liritë dhe të drejtat

kushtetuese, përkatësisht lirinë e shprehjes sipas nenit 16 dhe të drejtën për barazi të të gjithë qytetarëve, ndalimin e diskriminimit të parashikuar në nenin 9 të Kushtetutës, si dhe në nenet e parashikuara në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi të nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, në bashkëpunim me nenin 10 të së njëjtës konventë.

KONKLuzion

Nga gjendja e krijuar juridike dhe faktike, Gjykata konstatoi se në këtë rast ekziston diskriminimi në ushtrimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara, pra diskriminim në bazë të përkatësisë politike të aplikantëve në ushtrimin e së drejtës së lirisë, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, e cila shkel nenet 9, 16 dhe 21 të Kushtetutës, nenet 3 dhe 6 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe nenin 14 a.c. me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Bazuar në të drejtën e garantuar kushtetuese dhe ndërkombëtare për shprehjen e opinionit publik si dhe ndalimin e diskriminimit për shkak të përkatësisë politike, Gjykata konstaton se në rastin konkretë autoritetet publike duke mosrespektuar nenet 10 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kanë shkelur të drejtën e tyre për lirinë e mendimit dhe shprehjes publike të mendimit të garantuar me nenin 16 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ndalimin e diskriminimit për shkak të përkatësisë politike, duke shkelur kështu nenin 110 alin. 3 të Kushtetutës. *Gjykata ka vendosur dhe konfirmuar se personave Goce Markovski dhe Gorast Muratovski, të dy nga Shkupi, u është cenuar e drejta e lirisë së mendimit dhe shprehjes publike të mendimit dhe ndalimi i diskriminimit për shkak të përkatësisë politike, për sa i përket nenit 110 alin 3 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.*

Këtë vendim Gjykata Kushtetuese e sjell me votim të të gjithë gjyqtarëve me datë 27 qershor 2018 në Shkup.

Vendimi publikohet në „Gazetën Zyrtare” të RM-së¹⁴⁷

¹⁴⁷ Vendimi i plot **Y.6p. 116/2017** i datës **27 qershor 2018** është i publikuar në Wep faqen e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së në linkun <http://ustavensud.mk/?p=16567>

4.2. Aktivizmi gjyqësor i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit- analiza e jurisprodencës kushtetuese

Shtetit i Kosovës garanton dhe mbron me Kushtetutë liritë dhe të drejtat themelore të qytetarit sipas nenit 113 paragrafi 7 ku thotë :

„ Individët janë të autorizuar të ngrenë shkelje nga autoritet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuar me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”¹⁴⁸

Për të parë punën e Gjyktës Kushteutese të Republikës së Kosovës do të bëj analizë punën e këtij institucioni në një periudhë pesë vjeçare edhe ate duke anlizuar raportet vjetore të vitit 2010-2014

:

Gjatë viti 2010 , nga Departamenti i Regjistrimit të Lëndëve, Statistik dhe Akrikiv në vazhdimësi si DRLSA kanë qenë në punë gjithsej 207 kërkesa/lëndë: 75 kërkesa janë bartur nga viti 2009 dhe 132 lëndë të reja . Gjykata ka përfunduar 119 lënd ose 90,15% nga të cilët 70 lëndë janë nga viti 2009 ndërsa 49 nga viti 2010.

Kërkesat e pranuar-regjistruara në vitin 2010 kanë qenë të parashtruara nga:

- 1 kërkesë nga nënkryetari i Komunës së Pejës nga radhët e komuniteteve, në lidhje me procesin e përzgjedhjes së nënkryetarit të komunës nga po këto komunitete;
- 1 kërkesë nga grupi i deputeteve të Kuvendit të Kosovës në lidhje me shkeljen e Kushtetutës nga ana e Presidentit të Kosovës;
- 1 kërkesë nga Presidenti i Kosovës në lidhje me postin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit;
- 1 kërkesë nga Ushtruesi i detyrës së Presidentit në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmrisë së ushtrimit të funksionit të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Sekretarit të partisë politike dhe funksionit të Ushtruesit të detyrës së Kryetarit të Republikës së Kosovës;
- 2 kërkesa nga Avokati i Popullit, në emër të OJQ-ve në lidhje me kundërshtinë e Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe në emër të një qytetari të komunitetit serb;
- 1 kërkesë nga Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit në lidhje me emërtimin e komunës në gjuhën serbe; dhe
- 125 kërkesa nga individët të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kërkesat e pranuar në vitin 2010, (132), pretendonin shkeljet e të drejtës në:

¹⁴⁸Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 113 par. 7

- pension, 31.06%; pronë, 18.94%;
- vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të gjykatave, 14.39%;
- në lëmin e marrëdhënies së punës, 12.12%;
- vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të institucioneve shtetërore, 9.85%;
- në të drejta të tjera dhe interpretime/sqarime kushtetuese, 13.91%. ¹⁴⁹

Gjatë vitit 2011 nga DRLSA janë pranuar gjithsej 252 kërkesa/lëndë, 88 kërkesa të bartura nga viti 2010 dhe 164 kërkesa u pranuan në vitin 2011. Gjykata ka përfunduar 132 kërkesa, ndërsa 120 kërkesa u bartën në vitin 2012.

Nga 132 kërkesat e zgjidhura gjatë vitit 2011, 92 u publikuan në uebfaqen e Gjykatës dhe u proceduan tek palët, ndërsa 40 vendime janë në proces të përgatitjes. Në vijim disa prej vendimeve që Gjykata nxori gjatë vitit 2011:

- AKTGJYKIMI në rastin Nr. KO 29/11, Parashtrues Sabri Hamiti dhe deputetët e tjerë - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i 22 shkurtit 2011;
- AKTGJYKIMI në rastin Nr. KO 98/11, Parashtrues Qeveria e Republikës së Kosovës, lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- AKTGJYKIMI në rastin Nr. KO 119/10, Parashtrues Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14 paragrafi 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr. 03/L111, të 4 qershorit 2010;

Besimi i qytetarëve në Gjykatën Kushtetuese është rritur dukshëm si rezultat i punës efikase, efektive dhe të paanshme. 164 kërkesa janë pranuar gjatë vitit 2011, që do të thotë se janë pranuar mesatarisht 13,8 kërkesa në muaj dhe kjo shënon një rritje prej 24,55% krahasuar me vitin 2010.

- Struktura e kërkesave të parashtruara është:
- 148 kërkesa individuale (nga personat fizikë) ose 90,24%
- 16 kërkesa nga personat juridikë (Qeveria, gjykatat, subjektet politike, kompanitë private, sindikatat dhe organizatat religjioze) ose 9,76% . ¹⁵⁰

Gjatë viti 2012 nga DRLSA janë pranuar gjithsej 259 kërkesa/lëndë, ku 139 kërkesa janë pranuar në vitin 2012 dhe 120 nga vitet paraprake. Gjykata ka përfunduar 165 kërkesa (63.71% e të gjitha

¹⁴⁹Pjesë nga raporti i viti 2010 i publikuar në vitin 2011 në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese në linkun : https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2017/11/RAPORTI_2010.pdf

¹⁵⁰Pjesë nga raporti i viti 2011i publikuar në vitin 2012 në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese në linkun : <https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2017/11/Raporti-Vjetor-2011-Versioni-Final.pdf>

rasteve të pazgjidhura), ndërsa 94 kërkesa, ose 36.29% (2 kërkesa nga viti 2010, 13 kërkesa nga viti 2011 dhe 79 kërkesa nga viti 2012), janë bartur në vitin 2013. 158 nga 165 kërkesat e zgjidhura gjatë vitit 2012 janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës dhe janë proceduar te palët (përfshirë edhe 40 vendimet e vitit 2011, të cilat ishin në proces të hartimit), ndërsa 32 vendime të zgjidhura më 2012 janë në proces të përgatitjes.

Disa Aktgjykime që Gjykata nxori gjatë vitit 2012:

- Aktgjykim në Rastin Nr. KI51/11, Parashtrues Rexhep Rahimaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, Ac. nr. 359/10, të 14 dhjetorit 2010;
- Aktgjykim në Rastin nr. KI55/11, Parashtrues Fatmir Pireci, Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010;
- Aktgjykim në Rastin Nr. KO57/12, Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit Nr. 04/L-084 Për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës;

Struktura e kërkesave të parashtruara është:

- 119 kërkesa individuale (nga persona fizikë), ose 85,61%;
- 20 kërkesa nga persona juridikë (institucione) ose 14,39%. ¹⁵¹

Gjatë viti 2013 nga DRLSA janë pranuar gjithsej 327 kërkesa/lëndë, ku 233 kërkesa janë pranuar në vitin 2013 dhe 94 nga vitet paraprake. Gjykata ka përfunduar 225 kërkesa (68.80% e të gjitha rasteve të pazgjidhura), ndërsa 102 kërkesa, ose 31.20% (6 kërkesa nga viti 2012 dhe 96 nga viti 2013), janë bartur në vitin 2014. 200 nga 225 kërkesat e zgjidhura gjatë vitit 2013 janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës dhe u janë dorëzuar palëve (duke përfshirë edhe 32 vendimet e vitit 2012, të cilat ishin në proces të hartimit), ndërsa 44 kërkesa të zgjidhura janë në proces të përgatitjes.

Disa Aktgjykime që Gjykata nxori gjatë vitit 2013:

- Aktgjykim në rastin KI 120/10, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 308/2007, të 10 qershorit 2010,
- Aktgjykim në rastin KO 09/13, konfirmimi i amendamentit të propozuar kushtetues, të paraqitur nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 18 janar 2013, nëpërmjet shkresës Nr. 04-DO-1357,
- Aktgjykim në rastin KI 41/12, Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës,.

¹⁵¹ Pjesë nga raporti i viti 2012 i publikuar në vitin 2013 në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese në linkun :<https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2017/11/RAPORTI-VJETOR-2012.pdf>

Struktura e kërkesave është si në vijim:

- 209 kërkesa individuale (nga persona fizikë), ose 89,70%;
- 24 kërkesa nga persona juridikë (institucionet), ose 10,30%. ¹⁵²

Gjatë viti 2014 Gjykata ka pasur në punë gjithsej 289 kërkesa/lëndë, 187 kërkesa janë pranuar në vitin 2014 kurse 102 kërkesa janë bartur nga vitet paraprake. Gjithsej janë vendosur 226 kërkesa ose 78.20% e të gjitha rasteve të pazgjidhura. 208 nga 226 kërkesat e zgjidhura gjatë vitit 2014 janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës dhe janë proceduar te palët (përfshirë edhe 37 vendimet e vitit 2013, të cilat ishin në proces të hartimit), ndërsa 59 kërkesa të zgjidhura janë në proces të përgatitjes.

Disa Aktgjykime që Gjykata nxori gjatë vitit 2014:

- Aktgjykim, vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 17 korrikut 2014, rasti KO119/14.
- Aktgjykim, përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84.14 [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rasti KO103/14.
- Aktgjykim, vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, rasti KI99/14 dhe KI100/14.

Rasti i përzgjedhur #

Aktgjykim në Rastin nr. Ki 06/10 Valon Bislimi kundër Ministris së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë

Parashtruesi i kërkesës është z. Valon Bislimi nga Prishtina, i cili përmes avokatit të tij F. G që e përfaqësoi atë në këtë procedurë para Gjykatës Kushtetuese. Palë kundërshtare në procedurën para Gjykatës Kushtetuese janë Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës. Kërkesa është e bazuar në Nenin 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës, në Nenin 20 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Me 11 nëntor 2004, Gjykata Komunale në Prishtinë mori Vendimin P. nr. 1341/04, me të cilin e konfirmonte kallëzimin penal kundër Valon Bislimit dhe katër personave të tjerë për veprë penale të vjedhjes së rënde të përcaktuar në Nenin 253(1) të Kodit të Përkohshëm Penal. Në vitin 2008, kjo Gjykatë caktoi tri seanca dëgjimore lidhur me rastin e sipërpërmendur penal kundër personit në fjalë dhe të tjerëve edhe atë në një interval kohor me datën 24 qershor, 9 korrik dhe me 24 korrik

¹⁵² Pjesë nga raporti i viti 2013 i publikuar në vitin 2014 në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese në linkun https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2017/11/gjkk_raporti_vjetor_2013.pdf

2008. Me gjithë praninë e Valon Bislimit, të gjitha seancat e caktuara ishin shtyrë për shkak të mungesës së palëve të tjera në procedurë.

Më 27 prill 2009, personi në fjalë paraqet kërkesë për pasaport në Departamentin për marrjen e Dokumentëve pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës. Të njejtën ditë e bëri pagesën prej 25 eurove për pasaportë. Megjithatë as nuk e mori pasaportën, as nuk mori ndonjë vendim me shkrim me të cilin i refuzohej kërkesa e tij për pasaportë. Me 13 janar 2010 kërkoi nga Gjykata Komunale në Prishtinë t'ia lëshonte një certifikatë që nuk është nën hetime për ta marrë pasaportin. Nuk ka marrë asnjë certifikatë apo vendim të gjykatës lidhur me moslëshimin e pasaportës, por mori nga gjykata vetëm një "*refuzim verbal*" për kërkesën e tij. Më 28 maj 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë lëshoi aktgjykimin P. Nr. 134/04, e hodhi poshtë kallëzimin penal, dhe e pezulloi procedurën penale kundër tyre.

Parashtruesi i kërkesës ankohet se i është shkelur e drejta e tij për liri të lëvizjes e garantuar me Nenin 35 të Kushtetutës. Ai pohon që Gjykata Komunale në Prishtinë në mënyrë të padrejtë nuk i ka lëshuar certifikatën që është dokument i domosdoshëm për MPB për t'ia lejuar pasaportën.

Ai pohon që MPB nuk ka kurrfarë bazë juridike për t'ia privuar të drejtën e tij kushtetuese në bazë të mungesës së certifikatës së lëshuar nga gjykata që një person nuk është nën hetime. Në parim, sipas tij, kufizimi i vendosur në të drejtën e tij për liri të lëvizjes nuk është i bazuar në ligj, por është çështje e interpretimit të gabuar të ligjeve dhe e praktikës, përfshirë këtu keqinterpretimin e një memorandumit të mirëkuptimit të 21 gushtit 2008 të lidhur në mes Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësorë dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Më 25 janar 2010, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese, më 19 shkurt 2010. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe vendosi të kërkojë informata shtesë lidhur me këtë kërkesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë. Më 28 prill 2010, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, përfshirë këtu informatat shtesë që i kishte marrë më vonë Gjykata në përbërje të plotë shqyrtoi dhe vendosi që kërkesa është e pranueshme.

Një seancë degjimore u mbajt me 14 korrik 2010. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dhe përfaqësuesit e MPB-se, KGJK-se dhe të Ministrisë së Drejtësisë, ishin të pranishëm në këtë seancë. Një përfaqësues i Gjykatës Komunale të Prishtinës ishte po ashtu i pranishëm në këtë seancë.

Më 22 shtator 2010, Gjykata mbajti seancë të mbyllur për shqyrtim dhe e miratoi aktgjykimin ku Vendosi që :



- KONSIDERON se ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për liri të lëvizjes të garantuar me Nenin 35 (2) të Kushtetutës në lidhje me Nenin 2 të Protokollit Nr. 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- *KONSIDERON se praktika e bazuar në memorandumin e mirëkuptimit të 21 gushtit 2008, të zbatuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Gjykata Komunale e pengon parashtruesin e kërkesës që ta gëzojë të drejtën për mjete efektive juridike në kundërshtim me Nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me Nenin 2 të Protokollit Nr. 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;*
- *KONSTATON që Ministria e Punëve të Brendshme duhet të vendosë lidhur me kërkesën e parashtruesit, të 27 prillit 2009, për pasaportë në pajtim me Ligjin për Dokumenta të Udhëtimit brenda 30 ditësh pas pranimi të këtij Aktgjykimi;*
- *Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do te publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit;*
- *Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë dhe mund t'i bëhet rishikim editorial.*

4.3. Aktivizmi gjyqësor i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit-analiza e jurisprodencës kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 134 g u garanton të drejtën e individëve të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.¹⁵³ Ky institucion jep gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterrur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave (neni 131). Kjo kompetencë e saj për të shqyrtuar ankimet individuale kushtetuese është e kufizuar vetëm në lidhje me elementet procedurale të procesit të rregullt ligjor dhe jo edhe për kontrollin substancial të procesit.

Rasti i përzgjedhur studimi #

Vendimi nr. 4, datë 25.02.2009 V – 4/09

Kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese , është paraqitur nga kërkuesi ILIAZ BICI i përfaqësuar nga avokati A.N, duke iu referuar nenit 131, shkronja “f” të Kushtetutës me arsyetimin e cenimit të rregullsisë së procesit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit.

ILIAZ BICI, biri i Abazit, datëlindja 1947, banues në fshatin Dragostunjë, Komuna Qendër, Librazhd, ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar një procesë të parregullt gjyqësor duke argumentuar në këto drejtime kryesore:

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat procedurale civile dhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Ky Kolegj kryen një shqyrtim paraprak dhe vlerëson nëse prova e re i përmban kriteret ligjore për rishikimin e vendimit. Rëndësia thelbësore e provës së re për zgjidhjen e çështjes nuk mund të gjykohet në dhomën e këshillimit, por në seancë gjyqësore. Rastin në shqyrtim, nga pikëpamja formale, prova e re e paraqitur i përmban elementet e kërkuara nga neni 194, shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile. Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është marrë nga një trup gjyqtarësh, e cila ka krijuar një dyshim të bazuar tek kërkuesi për njëanshmërinë e saj. Në të dy gjykimet e zhvilluara në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë kanë marrë pjesë dy gjyqtarë, (njëri nga të cilët ka qenë edhe relator i çështjes gjatë shqyrtimit të *rekursit* të paraqitur prej kërkuesit në këtë gjykatë). Në të dy rastet, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka marrë vendime kundër interesave të kërkuesit.

¹⁵³ Kushtetua e Republikës së Shqipëris , Neni 134/g

Subjekt i intersuar SHOQËRIA “ALBANIA TABAK - Fabrika e Re e Cigareve” Sh.P.K, Librazhd, përfaqësuar nga z. Oljon Kaso dhe Znj. Natasha Laska, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës duke parashtruar:

- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në dhomën e Këshillimit është ligjor dhe në përputhje me kërkesat e neneve 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. Është në diskrecionin e dhomës së këshillimit të vlerësojë faktin nëse kërkesa plotëson kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji. Në dhomën e këshillimit nuk zhvillohet një gjykim , por një gjykim formal ku përcaktohet vetëm nëse kërkesa i plotëson kushtet e parapara me nenin 497 të Kodit të Procedurës Civile.

- Pretendimi i ngritur nga kërkuesi për cenim të parimit të paanshmërisë, për shkak të pranisë së dy gjyqtarëve si në gjykimin e themelit, ashtu edhe në shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, është i pa bazuar. Rastet në të cilat gjyqtari ka pengesë ligjore të marrë pjesë në gjykimin e një çështjeje, janë të përcaktuara në nenet 72 e 73 të Kodit të Procedurës Civile. Në çështjen konkrete nuk ndodhemi përballë këtyre rasteve, sepse asnjëri prej tyre nuk ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në ndonjë shkallë tjetër të gjykimit. Shqyrtimet në dhomën e këshillimit kanë të bëjnë vetëm me vlerësimin e kriterëve ligjore për kalimin ose jo në seancë gjyqësore dhe nuk përmbajnë karakteristikat e gjykimeve të mirëfillta duke mos e cenuar në këtë mënyrë të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për gjykatës referues në këtë lëndë është Sokol Sadushi ku vëren se:

Kërkuesit Iliaz Bici, me vendimin nr. 589, datë 22.05.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i është kthyer në pronësi sipërfaqja 2000 m², me nr. pasurie 499/6, e ndodhur në zonën kadastrale 2446, Librazhd. Duke qenë se sipërfaqja e kthyer më sipër rezultonte e zënë nga Shoqëria “Albania – Tabak” Sh.p.k Librazhd, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd me padinë me objekt *“Kthim sendi dhe detyrim për pagimin e qerasë së shfrytëzimit të truallit për periudhën 11.06.2001 deri në dorëzimin e truallit”*. Në përfundim të gjykimit, kjo gjykatë, pasi konstatoi se *“trualli i paditësit gjendet në kufi me pronat e të paditurës, e cila aktualisht zotëron edhe truallin e paditësit”*, me vendimin nr. 62, datë 13.03.2002, vendosi *“pranimin e kërkesëpadisë”*. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 302, datë 30.05.2002, ka vendosur *“Prishjen e vendimit nr. 62, datë 13.03.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë”*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd, me vendimin nr. 221, datë 19.06.2003, ka vendosur *“Pranimin e kërkesëpadisë së paditësit Iliaz Bici dhe “Rrëzimin e kundërpadies së Shoqatës “Albania Tabak – Fabrika e Re e Cigareve” Sh.p.k Librazhd”*.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 603, datë 24.12.2004, ka vendosur *“Rrëzimin e kërkesës së padisë të paditësit Iliaz Bici, si e pa mbështetur në ligj e në prova dhe pranimin e kundërpadisë pjesërisht”*. Pas rekursit të bërë nga ana e kërkuarit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 507, datë 25.04.2006, ka vendosur *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 603, datë 24.12.2004, të Gjykatës së Apelit Durrës”*. Iliaz Bici, në cilësinë e palës së interesuar, në bazë të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile ka kërkuar në Gjykatën e Lartë rishikimin e Vendimit nr. 221 të datës 19.06.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd. Si *“provë e re me shkresë me rëndësi për çështjen, e cila nuk mund të dihej nga pala gjatë shqyrtimit të saj”*, përpara Gjykatës së Lartë kërkuar ka paraqitur një hartë të quajtur Plan–Rivelimi e datës 13.07.2001, e zonës kadastrale 2466 me nr. pasurie 499/2, në të cilën tregohet prona e Shoqërisë Albania - Tabak Fabrika e Re e Cigareve Sh.p.k Librazhd, e nënshkruar nga pronari i kësaj shoqërie. Nga harta rezulton se midis pronës së shoqërisë së mësipërme dhe pronës së kërkuarit nuk ka mbivendosje, përfundim ky i njëjtë me atë të vendimit nr. 62 të datës 13.03.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd. Vendim është ndryshuar nga kjo gjykatë me vendimin nr. 221 të datës 19.06.2003. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, me vendimin nr. 00-2008-146, të datës 01.02.2008, ka vendosur *“Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga Iliaz Bici për rishikimin e vendimit nr. 221 të datës 19.06.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd”*.

Në lidhje me pretendimin e kërkuarit mbi cenimin e parimit të paanshmërisë së trupës së gjyqtarëve që përbënin dhomën e këshillimit, Gjykata thekson se analiza duhet zhvilluar nën dritën e jurisprondencës aktuale të vetë kësaj Gjykate dhe të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Jurisprondenca e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar *“gjykatë e anshme”* trupi gjykues në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili në këndvështrimin objektiv nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar se *“thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një apo më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuarin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje”*

Në rastin në shqyrtim, rezulton se dy gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, kanë marrë pjesë në dy gjykime të iniciuara nga kërkuari. Gjykata çmon se një fakt i tillë nuk sjell *a priori* cenim të parimit të

paanshmërisë, pasi çdokush mund të inicojë të njëjtën gjykatë dhe të njëjtët gjyqtarë për çështje të ndryshme. I ndryshëm është qëndrimi, kur i njëjti gjyqtarë apo gjykatë gjykon të njëjtën çështje gjyqësore. Rezulton se dy nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët kanë shqyrtuar rekursin e paraqitur nga kërkuesi dhe kanë konkluduar për drejtësinë e vendimit të Gjykatës së Apelit, që ka rrëzuar padinë e kërkuesit, kanë shqyrtuar dhe kanë konkluduar edhe për mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimit të dhënë prej tyre.

Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të vlerësojë themelësinë e provës së re dhe rëndësinë e saj mbi çështjen, por vetëm të konkludojë nëse pjesëmarrja e dy gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dy vendimet e dhëna për të njëjtën rrethanë të pretenduar, ka krijuar një dyshim të justifikuar tek kërkuesi se vendimi i dhënë ka qenë produkt i një procesi të dyshuar si të njëanshëm.

Si përfundim, Gjykata konkludon se pretendimi i kërkuesit për cenim të një prej elementeve të drejtësë për një proces të rregullt gjyqësor dhe që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme në perceptimin e publikut është i drejtë. Për rrjedhojë, kërkesa përta i përket pretendimit të dytë të kërkuesit, është e bazuar dhe duhet pranuar.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë duke u bazuar në nenet 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të Ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash, **V E N D O S I:** Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2008-147 të datës 01.02.2008 të Dhomës së Këshillimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare. ¹⁵⁴

¹⁵⁴Vendimi i plot është i arritshëm në wëp faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë në linkun : http://www.gjk.gov.al/web/Lista_e_Vendimeve_92_1.php , Vendimi nr. 4, datë 25.02.2009

4.4. Ndikimi i jurispodencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në konsolidimin e gjyqësisë kushtetuese në Maqedoninë e Veriut, Kosovë dhe Shqipëri në lëminë e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit

Një ndër kriteret themelore për pranueshmëri është shterimi i mjeteve juridike, këtë kriter duhet parë pikërisht në lidhje me natyrën subsidiare të kërkesës kushtetuese për t'ju dhënë mundësinë individëve që pretendimet e tyre për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të garantuara t'i realizojnë në rrugë administrative dhe gjyqësore. Kriteri për pranueshmëri është parapar edhe në nenin 35 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në kuptimin e parashtruesit të kërkesës duhet t' i shterin mjetet juridike vendëse që janë në dispozicion.

Por siç argumenton Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rregulli i shterjes nuk është as absolut as në gjendje të zbatohet në mënyrë automatike dhe me rastin e shqyrtimit nëse ai është zbatuar, është me rëndësi të merren parasysh rrethanat e posaçme të secilit rastë individual.¹⁵⁵

Pra, Kushtetutat e vendeve të rajonit si Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Shqipëria, parashohin që pas shterimit të të drejtës së ankesës në vend, pala ka të drejtë në një afat kohor për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut t'i drejtohet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e krijuar me ligj, e cila do të vendos si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e personave jomadhur, ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezomohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

- të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;
- t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

¹⁵⁵ Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017, fq 128-129

- të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
- të pyes dhe të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
- të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.¹⁵⁶

Raste studimi nga Gjykata Evropiane për Drejtat e Njeriut #

Asani kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut, A. Nr 27962/10(CASE of ASANI v THE FORMER YUGOSLAV OF MACEDONIA) ,Aktgjykim i datës 1 shkurt 2018

Faktet : Ankuesit Ramiz dhe Naim Asani, para GJEDNJ kanë theksuar argumente se nuk kanë qenë në mundësi që ti marrin në pyetje dëshmitarët kryesorë në lidhje me gjykimin e tyre për vepër penale – vrasje.

Ata kanë qenë të privuar nga liria gjatë viti 2007, në lidhje me incidentin ka ndodhur gjatë vitit 2006 para internet – kafesë, ku gjatë shkrepjes nga arma e zjarrit kanë humbur jetën tre fëmijë të moshës së mitur, kurse gjashtë persona tjerë kanë qenë rëndë të plagosur.

Gjatë procedurës vendore kundër tyre, gjatë së cilës janë shpallur si fajtorë dhe janë përcaktuar dënimet me burgim të përjetshëm nga ana e dy dëshmitarëve të mbrojtur me identitet të fshehur, të cilët kanë fituar statusin e tillë për shkak të frikës për sigurinë e tyre. Ankuesit janë identifikuar si shkaktarë të veprës, por gjatë kësaj mbrojtjeje u është lejuar që dëshmitarëve të mbrojtur gjatë gjyimit para gjykatave vendore vetëm të mund t'u parashtrojnë pyetje me shkrim. Gjykata, gjithashtu ka lejuar që si dëshmi të pranohet leximi i deklaratës së dhënë gjatë hetimit nga ana e dëshmitarit tjetër, i cili nuk është paraqitur gjatë gjyimit edhe pse ai ka qenë i ftuar.

E drejta : Në këtë rast , GJEDNJ e zbaton testin e trefishtë të zhvilluar nga praktika gjyqësore dhe në veçanti u fokusua në këto tre çështje vijuese, si gjatë vlerësimit të argumenteve për shkeljen e të drejtave të palës mbrojtëse për shkak të mos marrjes në pyetje të dëshmitarëve anonim, ashtu edhe për nga aspekti i ofrimit si dëshmi të deklaratës së dhënë gjatë hetimeve nga ana e dëshmitarit B.H

¹⁵⁶ Neni 6 i Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore , Romë 04.XI.1950 , https://echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf

I. Provat për shkeljen e të drejtave të mbrojtjes për shkak të mos marrjes në pyetje të dëshmitarëve anonim.

1. Vallë kanë egzistuar shkaqe të qëndrueshme për fshehjen e identitetit të dëshmitarëve?

Për nga aspekti i dëshmitarëve me identitet të fshehur, GJEDNJ mori qëndrimin se të njëjtit kanë qenë anonim me kuptim të praktikës gjyqësore të GJEDNJ, duke pasur parasysh faktin se të dhënat e tyre personale nuk kanë qenë në qasje për të akuzuar dhe për mbrojtjen e tyre dhe se të njëjtit gjatë procedurës gjyqësore shfaqen me pseudonimet „Korabi” dhe „Vodno”.

GJEDNJ konkludoi se shfrytëzimi i dëshmimeve të dhëna nga dëshmitarët anonim në rastin konkret, në mënyrë racionale mund të konsiderohet si e arsyshme, por gjatë kësaj duke i marrë parasysh argumentet e Qeverisë, të dhënë gjatë mbrojtjes dhe faktin se të njëjtat kanë mbetur të pakontestuar nga ana e ankuesve. Prapëseprapë, GJEDNJ përkujton se edhe pse dëshmitarët kanë kërkuar të mbeten anonim për shkak të frikës nga hakmarrja, ndjenja e tyre subjektive nuk mjafton vetvetiu, për faktin se gjykatat vendore janë të obliguar që të konstatojnë dhe të vlerësojnë se vallë në rastin konkretë ekzistojnë shkaqe objektive për frikë dhe se vallë ekzistojnë dëshmi për këto shkaqe, gjë që në rastin konkret nuk është realizuar?

2. Vallë deklaratat e dhëna nga dëshmitarët anonim kanë paraqitur bazën e vetme dhe kryesore për gjykimin e të ankuarve ?

GJEDNJ sajoi konkludimin se deklaratat e dhëna nga dëshmitarët me identitet të fshehur, nuk kanë qenë dëshmi të vetme gjatë procedurës. Prapëseprapë, duke pasur parasysh faktin se „Kobra” dhe „Vodno” kanë qenë dëshmitarët e vetëm okular, të cilët i kanë identifikuar ankuesit si shkaktarë të veprës penale dhe se gjykata gjykuese në bazë të deklaratave të dhëna nga këta dëshmitarë ka konstatuar „praninë e ankuesve në vendin e ngjarjes, zhvillimin dhe dinamikën e ngjarjeve”, GJEDNJ konkludoi se deklaratat e dhëna nga dëshmitarët me identitet të fshehur, kanë qenë me rëndësi të madhe dhe se pa të njëjtit, gjasat për gjykimin e ankuesve do të ishin të zvogluara në masë të konsiderueshme, përkatësisht dëshmitë anonime të dhëna nga „Kobra” dhe „Vodno” duhet të konsiderohen si dëshmi vendimtare në rastin konkret.

3. Vallë kanë ekzistuar faktorë për kundër balancim ose vendosjen për baraspeshën?

Faktorët e baraspeshës duhet të mundësojnë vlerësimin e drejtë dhe të rregullt të besueshmërisë së argumenteve të dhëna nga dëshmitarët anonim. GJEDNJ konkludoi se mundësia e cila iu është ofruar ankuesve që t’u parashtrojnë pyetje me shkrim dëshmitarëve me identitet të fshehur, nuk mund të konsiderohet si masë e mjaftueshme mbrojtëse procedurale për arritjen e baraspeshës së nevojshme për shkak të kufizimeve me të cilat janë ballafaquar të akuzuarit (më vonë të gjykuarit)

gjatë realizimit të të drejtës së tyre të mbrojtjes, në veçanti nëse merren parasysh kushtet e posaçme, në të cilën janë marrë në pyetje dëshmitarët, që ka përfshirë në vete jo vetëm mbrojtjen e tërësishme të anonimitetit të tyre, por edhe përjashtimin e mbrojtjes nga marrja në pyetje të tyre, që përfshin edhe pamundësinë që të kenë qasje deri te materialet e fituara nga pajisjet teknike për bartjen e fotografisë dhe zërit.

II. Pranimi i deklaratës së dhënë nga dëshmitari B.H e dhënë gjatë hetimit

1. Vallë kanë ekzistuar shkaqe të mirëfillta për mungesën e tij?

GJEDNJ konstatoi se në rastin konkretë, gjykatat vendore nuk kanë ofruar arsye solide për mungesën e B.H. gjatë procedurës gjyqësore. Për konkludimet e tilla, GJEDNJ i ka marrë parasysh këto rrethana vijuese: dëshmitari ka qenë dëshmitar okularë i ngjarjes penale – juridike dhe se ai është marrë në pyetje në prani të gjykatësit hetues dhe prokurorit publik, në propozim të prokurorit publikë në fazë të hershme të procedurës; se ankuesit gjatë gjykimit kanë kërkuar marrje në pyetje të tij; se gjykata pa sukses ka bërë orvatje që të sigurojë dëshmitarin; por se ka shprehur besimin ndaj njoftimit nga ana e MPB-së se dëshmitari nuk është në qasje për organet e përndjekjes për shkak të arratisjes dhe se ai kërkohet me fletë arresti ndërkombëtar, gjatë sjelljes së vendimit të pranohet si dëshmi deklarata e tij, e cila është dhënë gjatë hetimit dhe e cila është lexuar gjatë gjykimit. Gjatë vlerësimit, pse vallë në rastin konkretë janë marrë të gjitha masat racionale dhe pozitive nga ana e gjykatave vendore për sigurimin e dëshmitarit, GJEDNJ në veçanti ka marrë parasysh faktin se gjykata vendore ka sjell vendimin që të lexohet deklarata e dhënë nga ana e B.H. tre muaj pas njoftimit nga MPB-ja, pa kurrfarë tentative tjetër për sigurimin e pranisë së tij dhe pa përpjekje që të kontrollohen pohimet e ankuesve të dhënë gjatë fjalimit përfundimtarë në lidhje me atë se dëshmitari B.H. gjendet brenda shtetit dhe se është në duar të policisë, gjoja për shkak të inkriminimit të tij në një vepër penale, qasje të cilën e kanë respektuar edhe instancat tjera më të larta gjyqësore të shtetit, të cilët kanë vendosur në lidhje me këtë lëndë.

2 Vallë dëshmitë kanë qenë të vetme ose vendimtare?

GJEDNJ konstatoi se në deklaratën e tij të dhënë para gjykatësit hetues dhe para gjykimit, deklarata kjo e pranuar në debatin kryesorë gjykues si dëshmi e dhënë, B.H. nuk i ka identifikuar ankuesit si shkaktarë të veprës, por gjykata gjykuese është mbështetur në deklaratën e dhënë nga ana e B.H. që ta konstatojë motivin e veprës penale. Pra këtu, GJEDNJ konstatoi se gjykatat vendore kanë konstatuar një element të rëndësishëm për nga aspekti i përgjegjësisë penale të ankuesve në bazë të dëshmisë së shqyrtuar. Edhe përkaj faktit se kjo nuk ka qenë dëshmi e vetme në këtë drejtim dhe nuk ka pasur rëndësi të drejtpërdrejtë për GJEDNJ si vendimtare ka qenë fakti se kjo

dëshmi ka pasur rëndësi të konsiderueshme gjatë përcaktimit të fajësisë së të akuzuarve, kurse pranimi i deklaratës së tillë si dëshmi, ka mundur të paraqes hendikep për mbrojtjen.

3 Vallë ka pasur faktorë të mjaftueshëm të baraspeshës?

Gjatë vlerësimit të këtij aspekti nga testimi i përcaktuar, GJEDNJ në rastin konkret i ka analizuar kriteret e përcaktuara gjatë praktikës së saj gjyqësore: qasja e gjykatës gjykuese deri te dëshmitë e paverifikuara, disponimi dhe fuqia dëshmuese e dëshmive tjera inkriminuese dhe masat e ndërmarra procedurale që të kompenzohet mungesa e mundësisë që dëshmitarët të merren në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë gjykimit.

GJEDNJ konstatoi se në aktgjykimet e gjykatave vendore, nuk ekziston asgjë prej ku mund të sajohen konkludime se të njëjtit ndaj deklaratës së dhënë nga B.H. janë sjellë me vëmendje të posaçme, e as që mund të vërehet fakti se për shkak se kemi të bëjmë me dëshmitarë që mungojn, se kjo gjë i ka nxitur gjykatat vendore që t'i japin rëndësi më të vogël deklaratës së dhënë nga ana e tij.

Më pas, GJEDNJ ka konstatuar se pavarësisht nga fakti se dëshmia e dhënë nga B.H. ka shërbyer si dëshmi indirekte (duke pasur parasysh faktin se kjo dëshmi nuk ka mundur që të inkriminojë në mënyrë të drejtpërdrejtë asnjërin prej ankuesve), prapëseprapë duke pasur parasysh hendikepin e mbrojtjes në lidhje me të njëjtin, pesha e saj dëshmuese nuk mund të konsiderohet si faktor i mjaftueshëm i baraspeshës.

Përfundimisht, GJEDNJ konstatoi se ankuesit kanë pasur mundësinë që të ofrojnë versionin e tyre në lidhje me ngjarjet dhe ta konstatojnë kredibilitetin e B.H. si dëshmitar identiteti ka qenë i njohur për të njëjtit. Prapëseprapë, mbrojtja nuk ka pasur mundësinë që të marrë në pyetje B.H., gjithashtu edhe gjykata gjykuese nuk ka pasur mundësinë që të vrojtoj sjelljen e tij me qëllim që të bëjë vlerësimet e veta për besueshmërinë e rolit që atij ia ka përcaktuar. Nga mungesa e parashtrësës së qartë nga ankuesit në lidhje me deklaratën e dhënë nga B.H., e cila është lexuar gjatë debatit gjyqësorë, GJEDNJ sajon konkludimin se e njëjta nuk mund të interpretohet si anulim i padyshimt i së drejtës që të merret në pyetje ky dëshmitar.

KONKLUDIM – Kufizimet e së drejtës së mbrojtjes së ankuesve , në lidhje me dëshmitarët që janë me identitet të fshehur dhe të dëshmitarit B.H. kanë qenë në kundërshtim me garancitë e gjykimit të drejtë dhe kanë rezultuar me nenin 6, paragrafi 1 dhe 3 (g) të Konventës- njëzëri.

Gjykata refuzoi kërkesën e ankuesve për kompensim të drejtë juridik të dëmit për shkak të mungesës së lidhjes shkak-pasojë në mes shkaqeve për të cilat kërkohej kompensimi dhe shkeljet e konstatuara të KEDNJ.

Çështja Qama kundër Shqipërisë dhe Italisë, A nr. 4604/2009 (Case QAMA against Albania and Italy), Aktgjykim i datës 8 janar 2013

Faktet : Ankuesi, Flamur Qama i lindur më 1960 me banim në Durrës. Ai ka një djalë, i cili ka lindur më 25 gusht 1994. Në shtator të viti 1999 bashkëshortja e ndjerë e ankuesit, e cila vuante nga një sëmundje e rëndë, së bashku me të birin e saj hyri ilegalisht në Itali që të merrte trajtim mjekësor. Në një datë të pacaktuar ankuesi u bashkua me familjen në Itali. Në gusht apo shtator të viti 2002 pas mosmarrëveshjeve me të afërmit e bashkëshortes, konkretisht motrën, ankuesi u dëbua nga Italia meqenëse nuk kishte leje qëndrimi. Bashkëshortja dhe djali nuk kishin të rregulluar statusin e lejeqendrimit akoma dhe vazhduan të qëndrojnë në Itali. Bashkëshortja i vdiq më 7 tetor 2002.

Pas vdekjes së bashkshortes së tij, kunata e ankuesit depozitoi një padi pranë Gjykatës për të Mitur në Ankona më 17 tetor 2002 ku kërkonte kujdestarinë e djalit të ankuesit. Më 30 dhjetor 2002 një raport i qendrës lokale të kujdesit njofton se fëmija kishte frikë të kthehej dhe të jetonte me babanë për shkak të keqëtrajtimit të tij ndaj nënës së ndjerë. Në raport thuhej se i jati e kishte braktisur të birin dhe bashkëshorten e tij pa i njoftuar për një kohë kur ato më së shumti kishin nevojë për të. Kunatës që parashtroi kërkesë më 4 qershor 2003 ju pranua kërkesa nga Gjykata dhe i besuan kujdestarinë e djalit të ankuesit nën mbykëqirjen e Shërbimit Social të qytetit Senigallias . Më tej ajo caktoi Kryetarin e Bashkisë si kujdestar i përkohshëm i fëmijës(tutore provvisorio). Gjykata pezulloi të drejtat prindërore të prindërve me argumentin se ata kishin lejuar fëmijën të largohet nga Shqipëria pazgjedhur vështirësitë serioze që do të ndeshej djali i tyre më pas dhe ndaloj largimin e fëmijës nga Italia. Ajo caktoi Shërbimin Social Ndërkombëtar („ISS” - një OJQ) të kryente hetime në lidhje me situatën familjare të ankuesit. Babai i fëmijës në bazë të raporteve të kësaj organizate kishte refuzuar të flasë me ta dhe kishte kërkuar që fëmija të kthehet në Shqipëri, mirëpo kjo organizatë kishte kontaktuar edhe me të afërmit e ankuesit dhe kishte marrë informacione se ankuesi ishte i rimartuar dhe se bashkshortja e tij priste një fëmijë, ishte i papunë dhe jetonte me të ardhurat e bashkëshortes.

Më 22 mars 2004 Shërbimi Social në Itali pranë gjykatës paraqiti të dhënat më të fundit për djalin e ankuesit. Deri në atë kohë, statusi i djalit në shtetitin Italian ishte rregulluar dhe situata e tij dukej

se ishte stabile dhe e ekuilibruar. Në prill 2005 Ministria e Drejtësisë Italiane njoftoi ankuesin mbi dispozitat në fuqi të vendimit të datës 4 qershor 2003 dhe i paraqiti të dhënat më të fundit për djalin e tij. Ankuesi i informoi organet Italiane se do të paraqes ankesë kundër këtij vendimi pranë gjykatës me anë të një avokati. Disa vite më vonë më datë 15 janar 2007 fëmija kishte dhënë një deklaratë para gjykatës Italiane dhe ishte shprehur se nuk kishte qenë në kontakt me babin e tij dhe nuk dëshironte të fliste as në telefon pasi pretendonte se në të kaluarën ishte keqtrajtuar nga ai.

Një letër e dërguar rekomande dhe e regjistruar në sekretarinë e gjykatës Italiane më 22 janar 2007 dhe e nënshkruar nga avokati i ankuesit, ku kërkon zbatimin nga ana e autoriteteve Italiane të së drjetës së tij të aksesit ndaj të birit sipas vendimit të 30 qershorit 2006 të Gjykatës së Rrethit të Durrësit. Ankuesi nuk mund të udhëtonte në Itali. Ai i kërkoj Gjykatës Italiane të lejonte të birin të udhëtonte në Shqipëri, siç tregohej në vendimin e Gjykatës së Rrethit të Durrësit. Ankuesi deklaronte se fitonte të ardhura mujore 700 euro dhe banonte në një apartman me sipërfaqe me 70 metra katror që ofronte akomodim për të birin dhe ofronte dëshmi se nuk kishte dosje penale. Ai kërkoi nga autoritet Italiane që kujdestaria e të birit t'ju besohej shërbimeve sociale Italiane, sepse pretendonte se i është rrëmbyer i biri nga të afërmit e bashkëshortes së ndjerë e konkretisht kunatës së tij.

Duke u bazuar në *Konventën e Hagës mbi Aspektet Civile të Rëmbimit Ndërkombëtarë të Fëmijëve*, ankuesi i ka kërkuar Ministrisë së Drejtësisë Italiane fillimin e procedurave për vlefshmërinë e vendimit të Gjykatës Shqiptare të datës 30 qershor 2006 dhe zbatimin e së drejtës së tij për të kontaktuar me të birin.

Paralel me ngjarjet që zhvilloheshin në Itali edhe në Shqipëri, kishte filluar një proces gjyqësor , ku ankuesi përpara Gjykatës së Rrethit të Durrësit më datë 27 nëntor kishte ngritur një padi penale dhe kërkonte kthimin e djalit të tij, i cili sipas tij ishte marrë padrejtësisht në Itali. Gjykata vendosi pushimin e çështjes me argumentin se padia e ankuesit ishte e pabazuar në prova. Ankuesi më vonë depozitoi një padi tjetër të bazuar në nenin 127 të Kodit Penal. Më 29 dhjetor 2004 Gjykata e Rrethit shpalli fajtor të afërmit e bashkëshortes së ankuesit sipas akuzës dhe i dënoi ato me gjobë. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.

Pasi që Gjykata e Rrethit kishte vendosur që ankuesi ka të drejtë ta takojë të birin dy herë në vit ndërmjet datave 1 dhe 15 gusht dhe 27 dhjetor dhe 6 janar , mirëpo kjo gjë nuk u realizua.

Më 27 nëntor 2006 u nxorr një urdhër ekzekutimi në lidhje me vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe u caktua që ta zbatojë zyra përmbarese lokale.

Ankuesi u ankua se autoritetet Shqiptare dhe Italiane nuk i kanë siguruar të drejtën e kontaktit me djalin e tij në shkelje të Nenit 6 par. 1 dhe Nenit 8 ¹⁵⁷të Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore. Gjykata konsideron me vend shqyrtimin e ankesave të ankuesit vetëm sipas Nenit 8 të Konventës. Ndërkohë që Neni nuk përmban kërkesa eksplicite procedurale , ai kërkon që procesi i vendimë marrjes që çon në masat e ndërhyrjes të jetë i drejtë dhe t'i sigurohet respekti i duhur i interesave të mbrojtur nga ky Nen. Neni 8 i Konventës parshikon:

E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

- 1) *Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.*
- 2) *Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveç se në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit dhe moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.*¹⁵⁸

Vlerësim i Gjykatës : Gjykata vëren se gëzimi reciprok i prindit dhe fëmijës në shoqërinë e njëri tjetrit përbën elementin thelbësor të „jetës familjare” në kuptim të Nenit 8 të Konventës. Megjithatë objekti kryesor i Nenit 8 është mbrojtja e individit kundër ndërhyrjes së pajustificuar nga autoritetet publike, ekzistojnë, gjithashtu, detyrimet pozitive të qenësishme të respektit efektiv të jetës familjare.

Në zbatimin e këtij ushtrimi balancimi, Gjykata do t'i kushtojë rëndësi të veçantë interesave më të mira të fëmijës, të cilat në varësi të natyrës dhe seriozitetit të tyre, mund të kenë përparësi mbi ato të prindit. Në veçanti një prind nuk mund të gëzojë të drejtën sipas Nenit 8 që të merren masa të tilla që mund të dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës.

Duke u kthyer te faktet e çështjes, më 30 qershor 2006 gjykata shqiptare pranoi kërkesën e ankuesit për të takuar djalin e tij dy herë në vit. Gjykata urdhëroi që të afërmit e bashkëshortes së ndjerë të zbatojnë vendimin e gjykatës dhe është lëshuar urdhër për ekzekutim me përmbarues. Gjykata vëren se, ndërkohë që vendimit të gjykatës shqiptare të datës 30 qershor 2006 i mungonte qartësia në lidhje me modalitetet e kontaktit ndërmjet ankuesit dhe djalit të tij, efektet e këtij vendimi duhet të kuptohen se shtrihen vetëm brenda juridiksionit të Shqipërisë në kuptim të Nenit 1 të Konventës.

¹⁵⁷ Për më shumë shih Nenet 6 dhe 8 të Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore , Romë 04.XI.1950 , https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf

¹⁵⁸ Po aty, citat Nenit 8

Nuk është kundërshtuar nga palët fakti se ankuesi nuk ka mundur të takoj të birin pas dhënies së vendimit të gjykatës Shqiptare. Për rrjedhojë, çështja në rastin konkret, përbën qëllimin e detyrimeve pozitive të autoriteteve shqiptare, nëse ka ndonjë për të zbatuar të drejtën e kontaktit të ankuesit në lidhje me djalin e tij. Në këtë drejtim Gjykata vëren se kujdestaria i është besuar familjarëve të bashkëshortes e konkretisht tezes së djalit të ankuesit, me anë të vendimit të Gjykatës Italiane të vitit 2003. Në asnjë fazë, ankuesi nuk i ka kërkuar Gjykatës Italiane ndryshimin e vendimit të kujdestarisë së vitit 2003, e aq më pak pranimin e të drejtave të tij të kontaktit apo vizitave. Ankuesi nuk pretendon se fëmija është rrëmbyer apo mbajtur në mënyrë të paligjëshme në Itali. Megjithatë gjykatat shqiptare kishin konstatuar se të afërmit e bashkëshortes së ndjerë e konkretisht teza e kishte mbajtur fëmijën në mënyrë të paligjëshme, është e diskutueshme nëse ato vlerësuan natyrën e vërtetë dhe qëllimin e vendimit të kujdestarisë tash më të marrë nga gjykata Italiane , meqenëse në asnjë rast nuk janë referuar këti vendimi.

Në rastet kur fëmija i një ankuesi nuk ishte brenda juridiksionit të Shtetit të paditur, pavarësisht nëse ankuesi kishte filluar procedimet ligjore sipas Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve dhe nëse janë dhënë të drejtat e kujdestarisë, Gjykata ka konstatuar se ankuesit i është kërkuar të paraqesë çështjen për ushtrimin e të drejtave të aksesit, kontaktit ose vizitave të tij në Shtetin e paditur në juridiksionin e të cilit është konstatuar fëmija.

Duke u bazuar në praktikën e deritanishme dhe duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të rastit, Neni 8 nuk mund të kuptohet si zgjerim i detyrimit të një Shtetit të paditur për t'i siguruar ankuesit kontaktin kur fëmija është transferuar në një juridiksion tjetër dhe është jashtë juridiksionit të këtij Shteti. Për më tepër Neni 8 i Konventës i parashikuar në dritën e Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, nuk u cakton autoriteteve kombëtare detyrime pozitive për të siguruar kthimin e fëmijës nëse ankuesi mban vetëm të drejtën e kontaktit ose vizitave.

Konkluzion i Gjykatës : Gjykata konkludon se meqenëse të dy prindërit kanë rënë dakord me dëshirën e tyre për të udhëtuar me fëmijën në Itali dhe meqenëse fëmija mbetet në Itali në bazë të urdhërit të ligjshëm të dhënë nga gjykata Italiane, e cila nuk i njohu ankuesit të drejtat e kujdestarisë, nuk kishte detyrim pozitiv për Shqipërinë për të marrë hapa për të siguruar zbatimin e të drejtave të kontaktit të ankuesit me djalin e tij, siç njihet nëpërmjet vendimit të gjykatës shqiptare. Ankuesi duhet të kishte depozituar padi pranë gjykatës Italiane për të fituar të drejtat e kontaktit ose vizitave në lidhje me djalin e tij.

Për këtë arye, Gjykata unanimisht vendos:

Ankesën sipas Nenit 8 të Konventës në lidhje me Shqipërinë të pranushme, ndërsa pjesën e mbetur të kërkesës në lidhje me Italinë të papranueshme.

1. Gjykon se nuk ka pasur shkelje të Nenit 8 të Konventës në lidhje me Shqipërinë.¹⁵⁹

¹⁵⁹ Aktgjykimi është i arritshëm në wëp. faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetues të Shqipëris në linkun : <http://www.gjk.gov.al/>

KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

Në kontekstin e demokracisë kushtetuese moderne, roli i gjyqësorit kushtetues reformohet vazhdimisht në kuptimin që gjyqësori kushtetues nuk është vetëm një aktor i kontrollit normativ abstrakt, por edhe një gjykatë e qytetarëve që mund të apelojnë lirshëm në gjykatën kushtetuese për të mbrojtur të drejtat e tyre kushtetuese. Gjithashtu, kjo gjykatë nuk është më vetëm një ligjvënës negativ, por edhe një ligjvënës pozitiv, d.m.th. krijues i normave të përgjithshme juridike. Këto dy dimensione nuk ishin pjesë e shtjellimit fillestar shkencor të themeluesit të gjyqësorit kushtetues, prof. Hans Kelzen, por siç thuhet zakonisht: "Ne i kemi borxh shumë Hans Kelzenit, por nuk jemi skllëvër të tij". Kjo gjë për faktin se Gjykata Kushtetuese mund të shndërrohet në një ligjvënës pozitiv, posaçërisht kur vendosë se çfarë është dhe çfarë duhet të jetë kushtetuta, nëse kjo është e nevojshme për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut, dhe ky frymëzim sidomos vjen nga Gjykata Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Çështja kryesore e trajtuar në këtë punim është (jo) funksionimi i mekanizmit për mbrojtjen e drejtpëdrejtë juridike të lirive dhe të drejtave kushtetuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në këtë drejtim, u analizua korniza aktuale kushtetuese për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit përpara Gjykatës Kushtetuese të RMV-së. Në këtë punim, u vërtetua hipoteza gjenerale fillestare se, Gjykata Kushtetuese mund të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, por se në praktikën kushtetuese të RMV-së kjo gjë nuk ndodh pasi numri i ankesave për mbrojtje të lirive dhe të drejtave para Gjykatës Kushtetuese është i papërfillshëm, dhe në të njëjtën kohë situata në lidhje me këtë çështje është regresive. Kjo çështje është mjaft e rëndësishme edhe nga aspekti i procesit të integritetit të RMV-së në Bashkimin Evropian, pra përparimi i mëtutjeshëm i mbrojtjes kushtetuese dhe gjyqësore të lirive dhe të drejtave është i nevojshëm në kontekstin e zbatimit të reformave juridike si pjesë e Kapitullit 23- Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, si një kapitull kryesor në procesin e integritetit evropian.

Ashtu siç u konstatua, në këtë punim, sipas nenit 110 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykata Kushtetuese i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit, që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimeve, bashkimin dhe veprimin politik dhe me ndalimin e diskriminimit në bazë të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë kombëtare, sociale dhe politike. Mirëpo, siç u morr vesh, ankesa kushtetuese gjithëpërfshirëse nuk është e parashikuar në sistemin juridik kushtetues të RMV-së si një mjet juridik për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Pra, Gjykata Kushtetuese e RMV-së prej gjithsej 44 lirive dhe të drejtave personale, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, i mbron vetëm tri prej tyre, edhe atë: lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimeve; bashkimin dhe veprimin politik dhe ndalimin e diskriminimit në bazë të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë kombëtare, sociale dhe politike ndërkaq, mbrojtja e lirive dhe të drejtave të tjera është në kompetencë të gjykatave të zakonshme. Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese bën diferencimin e kompetencës së Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të zakonshme lidhur me mbrojtjen e drejtpëdrejtë të lirive dhe të drejtave të sipërtheksuara. Sipas kësaj Rregulloreje, Gjykata Kushtetuese i mbron drejtpëdrejtë liritë dhe të drejtat e sipërtheksuara, nëse plotësohen dy kushte, edhe atë: i pari, nëse paraprakisht është shteruar mbrojtja juridike e tyre para gjykatave të zakonshme në RMV dhe, i dyti, nëse kërkesa për mbrojtjen e tyre paraqitet në afat prej dy muajsh nga dita e dorëzimit të aktit konkret përfundimtar dhe të plotfuqishëm gjyqësor me të cilin janë cenuar liritë dhe të drejtat e sipërtheksuara. Nga ana tjetër, si objekt i kontrollit në kuadër të kësaj kompetence janë aktet dhe veprimet konkrete (individuale) juridike të organeve të pushtetit publik, për të cilat qytetari konsideron se, i cenojnë ndonjërin prej tri lirive dhe të drejtave të lartpërmendura, me çrast si objekt kontesti paraqiten edhe aktet administrative edhe aktet gjyqësore të cilësdo instance. Megjithatë, në këtë punim në mënyrë empirike, u vërtetuan konstatimet e gjithëpranueshme, se, dobësia kryesore e kësaj kompetence konsiston në kufizimin e saj sepse mbrohen vetëm tri liri dhe të drejta (nga gjithsej 44 sish), si dhe në aktivizmin mjaft të dobët të Gjykatës Kushtetuese lidhur me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit, sepse që nga themelimi i saj në v. 1991 e deri sot (v.2020), në jurisprudencën e saj, vetëm në tri raste kjo Gjykatë ka konstatuar cenimin e ndonjërit prej këtyre tri lirive dhe të drejtave të lartpërmendura, edhe atë:

-Rasti i parë është në v. 2010 (cenimi i lirisë së bashkimit dhe veprimit politik, Vendimi i GJK U/Nr. 84/2009 i 10.02.2010);

-Rasti i dytë, është i v. 2017 (cenimi i lirisë së mendimit dhe shprehjes publike të mendimit si dhe diskriminimi mbi bazën e përkatësisë politike, Vendimi i GJK U/Nr. 116/2017 i 27.06.2018 dhe,

-Rasti i tretë dhe i fundit është në v. 2019 (cenimi i lirisë së mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, Vendimi i GJK U/Nr. 57/2019 i 29.05.2019).

Me rëndësi për idenë themelore të këtij punimi, është rasti i tretë dhe i fundit i v. 2019. Në këtë rast, nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, avokatët Pavlina Zefiç dhe Pançe Toshkovski, të dy nga Shkupi, bazuar në nenin 110 të Kushtetutës, paraqitën një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për mbrojtjen e lirisë së mendimit dhe shprehjes publike të mendimit në mbështetje

të nenit 16 të Kushtetutës. Sipas pretendimeve në kërkesë, liria e tyre e garantuar me kushtetutë është shkelur me vendimet e Gjykatës Themelore Shkupi 1 i 16.10.2018 dhe me vendimin e Gjykatës së Apelit Shkup të 17.12.2018. Si mbrojtës të njërit prej të pandehurve për krimin nga neni 313 i Kodit Penal, "Rrezikimi terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë në RMV", dhe me rastin e ngjarjeve të 27 Prillit 2017 në Parlamentin e RMV, në procedurën para Gjykatës Themelore Shkupi 1 në njërën nga seancat dëgjimore kryesore avokatët në fjalë, shprehën pakënaqësi për kushtet e përshtatshme për të dëgjuar dëshmitarin e mbrojtur, përkatësisht, për shkak të problemeve me teknikën, seanca në vend të ndërtesës së re të Gjykatës Themelore Shkupi 1 u vendos që të mbahej në sallën e gjyqit të ndërtesës së vjetër të gjykatës. Në këtë sallë të gjyqit nuk kishte kushte, dmth tavolina për të gjithë avokatët dhe të pandehurit të lejohen të shkruajnë dhe të shënojnë, për shkak të të cilave pati një reagim nga avokatët. Ata së pari iu drejtuan trupit gjykues me një kërkesë verbale për të siguruar kushte të përshtatshme. Pas refuzimit të kërkesës së tillë nga trupi gjykues, në shenjë revolte dhe pakënaqësie, të gjithë avokatët ngriten nga vendet e tyre dhe qëndruan në këmbë derisa përfundoi seanca. Për shkak të këtij gjesti, ata u paralajmëruan dhe më pas, u ndëshkuan menjëherë për prishjen e rendit në sallën e gjyqit. Kështu, sipas nenit 361 të Ligjit për Procedurën Penale me vendime individuale të Gjykatës Themelore Shkupi 1 të 16.10.2018, të gjithë avokatët, u gjobitën me 1.000 euro. Vendimet u ankimuan në afatin e duhur. Gjykata e Apelit në Shkup, me rastin e ankesave të paraqitura, me vendimin e saj të 17.12.2018, i miratoi pjesërisht ankesat dhe i uli gjobat nga 1.000 në 500 euro. Pas kësaj, avokatët në fjalë, paraqitën një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese, me rastin e kërkesës së avokatëve në fjalë, me vendimin e saj të 29.05.2019, përcaktoi shkelje të lirisë së mendimit dhe shprehjes publike të mendimit me vendimet e mësipërme gjyqësore. Gjykata Kushtetuese argumentoi se në rastin konkret, nuk kishte arsye për të kufizuar lirinë e shprehjes sepse avokatët kishin bërë kritika legjitime ndaj gjykatës në lidhje me faktin se nuk kishte kushte të përshtatshme për seancën kryesore, veçanërisht pasi vetë gjykata kishte kontribuar në reagimin e avokatëve. Mënyra në të cilën revolta dhe kritika u shprehën nga avokatët, duke qëndruar në këmbë në sallën e gjyqit, nuk ishte fyese dhe as nuk cenoi autoritetin e gjykatës, por ishte brenda kufijve të kritikës së pranueshme legjitime sipas nenit 10 të KEDNJ-së që garanton lirinë e shprehjes. Për shkak të gjithë kësaj, gjykata konsideron se shqiptimi i gjobave me vendimet e kontestuara gjyqësore paraqet shkelje të lirisë së shprehjes dhe lirisë së mendimit dhe shprehjes publike të mendimit të avokatëve. Në këtë drejtim, duhet të theksohet se, ky vendim i Gjykatës Kushtetuese është një hap mjaft i rëndësishëm krahasuar me interpretimin e mëparshëm tejet kufizues të juridiksionit të Gjykatës

Kushtetuese, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave. Përkatësisht, me këtë vendim për herë të parë, pas një mohimi të gjatë në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të një mundësie dhe kompetence të tillë, u përcaktua se vendimet e gjykatave të rregullta mund të jenë objekt i procedurës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave para Gjykatës Kushtetuese. Ky qëndrim nënkupton që vendimet gjyqësore bëjnë pjesë në kategorinë e "akteve individuale përfundimtare" të parashikuara në nenin 51 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese. Kjo kompetencë e Gjykatës Kushtetuese është plotësisht në përputhje me nenin 110 të Kushtetutës, duke pasur parasysh se, kjo dispozitë nuk përjashton vendimet gjyqësore, veçanërisht pasi gjyqësori dhe autoritetet e tjera mund të shkelin të drejtat dhe liritë, si në rastin në fjalë. Në këtë mënyrë, Gjykata Kushtetuese siguroi një hapësirë më të gjerë për pasurimin e jurisprudencës së varfër në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, duke pasur parasysh faktin se ky vendim është i pari që konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive me vendimet e gjykatës së rregullt, dhe nga ana tjetër, poashtu, si aspekt pozitiv duhet të theksohet se Gjykata Kushtetuese e mori këtë vendim duke iu referuar KEDNJ-së dhe praktikës së GJEDNJ-së gjë që, si praktikë referimi në këto burime ndërkombëtare është gjithashtu një dukuri e rrallë në jurisprudencën e saj, dhe si e tillë është për t'u përshëndetur.

Pra, zgjerimi i kompetencës së Gjykatës Kushtetuese në raport me vendimet e gjykatave të rregullta, sigurisht që mund të vlerësohet si diç mjaft pozitive në praktikën e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese, sepse në të vërtetë është një ndryshim në praktikën e saj gjyqësore, sepse, në disa raste në të cilat në kërkesat e qytetarëve argumentohej se liritë dhe të drejtat e caktuara kushtetuese ishin shkelur me vendime gjyqësore të plotëfuqishme, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se, nuk është kompetente për të vlerësuar ligjshmërinë e procedurave gjyqësore dhe të lëshohet në vendosjen mbi të drejtat konkrete të palëve në lëndë konkrete që janë në kompetencë të gjykatave të rregullta, si për shembull rastet: U.Nr.1/2016-31.05.2016; U.Nr.90/2014-25.11.2014; U.Nr.105/2013-12.02.2014; etj. Megjithëse, nuk lejohet që gjykatat kushtetuese të devijojnë dhe ta ndryshojnë praktikën e tyre të mëparshme shumëvjeçare gjyqësore, për të ruajtur autoritetin dhe besueshmërinë e këtij institucioni, si dhe sigurinë juridike të qytetarëve, Gjykata Kushtetuese gjithmonë duhet të ofrojë një arsyetim gjithëpërfshirës se përse ndryshohet apo devijohet nga praktika e mëparshme gjyqësore. Sidoqoftë, në vendimin e mësipërm të v.2019, nuk ka asnjë arsyetim gjithëpërfshirës për braktisjen dhe ndryshimin e praktikës së mëparshme shumëvjeçare kushtetuese-gjyqësore, prandaj, nuk është e qartë se cila është saktësisht kompetenca e Gjykatës Kushtetuese në procedurën për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit përkitazi me vendimet dhe procedurat e gjykatave të rregullta. Mirëpo, një gjë është e qartë,

Gjykata Kushtetuese ka kompetencë ekskluzivisht në lidhje me çështjen nëse veprimet, vendimet apo procedurat e gjykatave të rregullta kanë shkelur të drejtat dhe liritë e caktuara kushtetuese, por jo edhe vendosjen meritore të lëndëve që janë në kompetencë të gjykatave të rregullta e aq më pak vërtetimin e gjendjes faktike.

Prandaj, duke pasur parasysh konstatimet e mësipërme, sidomos, faktin se, numri i kërkesave të paraqitura për mbrojtje të lirive dhe të drejtave përpara Gjykatës Kushtetuese është në rënie të vazhdueshme, si rekomandim kryesor i këtij punimi është mundësia e inkorporimit të ankesës kushtetuese, mirëpo, futja e këtij mjeti juridik në sistemin kushtetues të RMV-së kërkon një parapërgatitje serioze, për sa i përket debatit të gjerë publik dhe profesional, të mbështetur nga hulumtimet gjithëpërfshirëse sepse logjika e futjes së këtij mjeti juridik konsiston në, sigurimin e mbrojtjes më të mirë dhe më efikase të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të qytetarit në RMV, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, në mënyrë që nëse ky mjet juridik inkorporohet atëherë duhet të jetë efektiv dhe jo vetëm edhe një instancë tjetër e katërt gjyqësore, si një rrethanë rënduese në lidhje me mundësinë e paraqitjes së ankesës para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila në shumë raste është shpresa e fundit për drejtësi për qytetarët e Maqedonisë së Veriut.

Gjykata Kushtetuese prej kohësh nuk është një organ klasik me autoritetin të jetë vetëm bartës sovran i së drejtës për të zbatuar kontrollin normativ abstrakt që do të vlerësojë vlefshmërinë kushtetuese të akteve juridike që janë inferiorë ndaj normës themelore kushtetuese. Për më shumë se pesëdhjetë vjet, Gjykata Kushtetuese është njohur si një organ kushtetues që është gjithashtu në dispozicion të qytetarëve, pra në teori gjithnjë e më tepër, përcaktohet si, gjykatë e "qytetarëve të rëndomtë". Ky epitaf i ri, është pasojë e faktit se, në punën e saj themelore u krijua një kompetencë e re, një mjet i ri juridik, një kontakt i drejtpërdrejtë i qytetarëve me Gjykatën Kushtetuese: ankesa kushtetuese. Ideja themelore ishte që përmes këtij mjeti juridik për t'i siguruar çdo qytetari mbrojtje juridike të të drejtave të njeriut të përcaktuara me Kushtetutë. Ankesa kushtetuese ngadalë por, sigurtë mori hovin e punës së gjyqësisë kushtetuese. Nga perspektiva e sotme, pavarësisht nga sistemi juridik, konstatohet se ankesa kushtetuese është deri tani kompetenca më e shfrytëzuar e gjykatave kushtetuese, megjithëse shumica e ankesave të paraqitura kushtetuese janë refuzuar nga gjykatat kushtetuese për shkak të kërkesave të gabuara të bëra në ankesë. Vihet re se aplikantët/ankuesit shpesh kërkojnë të shqyrtohet ligjshmëria e vendimeve gjyqësore. Sidoqoftë, kjo kërkesë nuk është në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese sepse ajo, nuk është një gjykatë supreme që ka të drejtë të vlerësojë ligjshmërinë e vendimeve

gjqësore ose ta zëvendësojë një vendim gjyqësor me vendimin e vetë meqë kompetenca e saj është e kufizuar. Gjykata Kushtetuese vetëm përmes prizmit të normave kushtetuese përcakton nëse është kryer shkelje e një të drejte të garantuar me Kushtetutë gjatë procedurës gjyqësore, por nuk ka juridiksion që të ndërhyjë në mënyrë thelbësore në aktgjykimin e gjykatës së rregullt duke analizuar nëse juridiksioni i gjykatës ka përcaktuar saktë gjendjen faktike të çështjes apo nëse është zbatuar drejtë ligji material.

SHTOJCA

Në këtë pjesë kam paraqitur terkin e Kërkesës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të nenit 110 alinea 3 dhe Iniciativën për vlerësimin e Kushtetushmëri dhe ligjshmëris të përkthyer :

Deri te :

**GJYKATA KUSHTETUESE E
REPUBLIKËS SË MAQEDONIS SË VERIUT**

rr. Kej „Dimitar Vllahov“ nr.19

- Shkup

K Ë R K E S

**për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të nenit 110 alinea 3
e Kushtetutës së Republikës së Maqedonis së Veriut**

I. TË DHËNAT E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Person fizik			
Emri:		Mbiemri:	
Adresa e banimit	Rruga		Numri
	Vendi	Komuna	
Telefoni për kontaktë:			
Të dhënat e përfaqësuesit (në qoftë se parashtruesi ka përfaqësues)*			
* VËREJTJE: Autorizimi duhet patjetër të dërzohet origjinal			
Emri dhe mbiemri			

Adresa	
Telefoni për kontaktë:	

II.LËNDA E KËRKESËS

Kërkesë për mbrojtje e të drejtave dhe lirive në bazë të nenit 110 al. 3 të Kushtetutës (lira e besimit, ndërgjegjes ; medimit dhe shprehjes publike të mendimit, shoqata dhe veprimarti politike dhe ndalimi i diskriminimit të qytetarëve në bazë të gjinisë, racës , religjionit përkatësis kombëtare dhe fetare , shoqërore dhe politike)

Dëmtuar nga :

A. akt individual ose përfundimtar dhe i plotfuqishëm , ose

B. me veprim

** Nëse dëmtimi është kryer me akt individual ju plotësonë pjesën A*

A. Akt individual ose përfundimtar dhe i plotfuqishëm

Emërtimi i aktit	
Sjellës i aktit	
Numëri i aktit dhe data e sjelljes	
Data e pranimi	

Data kur akti individual është bërë përfundimtar apo i plotëfuqshëm	
* Nëse dëmtimi është shkaktuar nga një veprim ju plotësone pjesën B	
B. Veprimi nga të cilën është bërë dëmtimi	
(përkthyer veprimin nga të cilët është kryer dëmtimi, specifikoni datën kur është marrë dhe ditën e gjetjes së veprimit)	

III. ARSYETIM

Faktet dhe provat në të cilën bazohet kërkesa
Arsye përse kërkohet mbrojtje

IV. Propozimet për Vendim

Propozim për vendosjen e kërkesës për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave	
Propozim special (masë e përkohshme)	<i>*Fakultativ</i>
Duke pas parasysh se kryerja e veprimeve dhe veprave individuale mund të rezultoj në pasoja të pakthieshme ose të pa riparueshme _____ (shpjegoni arsyen) proponoj që Gjykata Kushtetuese të marrë një vendim për të ndaluar ekzekutimin	

(specifikoni aktin ose veprimin individual)

deri sa të marrë një veprim të formës së prerë

V. SHTOJCË ME KËRKESËN

Kërkuesi

Nënshkrimi ¹⁶⁰

INICIATIVË

për vlerësimin e kushtetutshmëris dhe/ose ligjshmëris

I. TË DHËNAT E PARASHTRUESIT TË KËRKESËS

Person fizik			
Emri:		Mbiemri:	
Adresa e banimit:	Rruga		Numër
	Vendi	Komuna	

¹⁶⁰ http://ustavensud.mk/?page_id=5668

Telefoni për kontakt	
----------------------	--

Të dhënat e përfaqësuesit (në qoftë se parashtruesi ka përfaqësues)*	
* VËREJTJE: <i>Autorizimi duhet patjetër të dëryohet origjinal</i>	
Emri dhe mbiemri	
Adresa	
Telefon për kontakt	

Person juridik	
Emëri	
Adresa	
Telefoni për kontakt	
Përfaqësues ligjor	

II. LËNDA E INICIATIVËS

Precizimi i aktit apo dispozitës kontestuese

--

Dispozita kushtetuese ose ligjore* për të cilën parashtruesi konsideron se është dëmtuar nga akti/dispozita kontestuese:

--

** Nëse kontestohet një aktë nënligjor ose akt tjetër i përgjithshëm juridik (rregullore)*

Propozim deri tek Gjykata Kushtetuese (shembull: të filloj procedura , të anuloj , të abrogoj):

--

Propozim special (masë e përkohshme)

--

III. SHTOJCAT

Me iniciativën janë të bashkangjitura

Parshtruesi

Nënshkrimi 161

¹⁶¹ http://ustavensud.mk/?page_id=5666

BIBLIOGRAFIA

I. TEKSTE UNIVERSITARE, KOMENTARE, RAPORTE DHE PUBLIKIME

1. Bajrami, Dr., Arsim ; Muçaj, Mr., Florent; E drejta kushtetuese, Fakulteti Juridik, Univerziteti i Prishtinës „ Hasan Prishtina”, Prishtinë, 2018.
2. Biba, D. , Akti normative me fuqinë e ligjit – në këndvështrimin e së drejtës kushtetuese të krahasuar, Botuar në Revistën – E drejta parlamentare dhe politikat ligjore , Numri XXIX, viti 2006.
3. Enver Hasani & Ivan Čukalović, Komentar, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2013
4. Morina, Visar, Gjyqësia Kushtetuese (Shqyrtime teorike dhe krahasimore), Prishtinë, 2017.
5. Morina, Visar, The Legal Prospective Force of Constitutional Courts Decisions: Reflections from the Constitutional Jurisprudence of Kosovo and beyond”, Nottingham L.J. 2016. Mushkolaj, Gjyljeta; Morina, Visar; Johan van Lamoen, PhD., Commentary LCC Law on the Constitutional Court of the Republic of Kosovo, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) Pristina, 2014.
6. Omari, L., Shteti i së drejtës, Tiranë 2002,
7. Omari,L & Anastasi.,A, E drejta Kushtetuese, 2010, Shtëpia Botuese ABC.
8. Paladin, L. , Gjykata Kushtetuese dhe parimi i përgjithshëm i barazisë, botuar në Jurispodenca Kushtetutes, 1984.
9. Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Tiranë 2010, botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare.
10. Reforma në drejtësi MODUL TRAJNIMI PËR STUDENTËT JURIST DHE AKTIVIST TË SHOQËRIS CIVILE , Konrad Adenauer Stiftung
11. Sadushi, S. , Drejtësia Kushtetuese në zhvillim, Botimet Toena , Tiranë 2012
12. Sadushi, S. , Kontrolli Kushtetues, BOTIMPEX, Tiranë 2004.

13. Sadushi, S. , Sfidat e Gjykatës Kushtetuese përballë legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit, refruar me rastin e 20 vjetorit të Gjykatës Kushtetuese, Tiranë, qershor 2012
14. Saliu, Dr. Kurtesh, E drejta kushtetuese , Libri I, (Botimi i katërt), Prishtinë, 2004.
15. Shasivari, Jeton, ,, The Role of the Constitutional Court of th RM in the Practical Implementation of the Fundamental Constitutional Principles in View of its Judicial Practice”, SGEM, Vienna, Austria, 2017.
16. Shasivari, Jeton, E DREJTA KUSHTETUESE , Shkup, 2020
17. Shasivari, Jeton, Restricted Judicial Activism of Constitutional Court of the Republic of North Macedonia Regarding Protection of Human Rights and Freedoms, Acta Universitatis Danubias, Juridica, Vol. 15, No. 1, 2019, Danubius University, Galati, Romania.
18. Traja, K. , Drejtësia Kushtetuese , Shtëpia botuese – Luarasi, Tiranë 2000.
19. Vendime të Përzgjedhuara të Gjykatës Kushteutese Fedrale Gjermane, Botime Jubilare, 2010
20. Zagonjari, Xh. , Anastasi A. , Cani (Methasani) E. , Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2010.
21. Денковска, Рената, ,, Уставниот суд во РМ: Предлози за реформа”, Зборник на трудови од меѓународен симпозиум, Скопје, 2014.
22. Ђузепе Верготини, Упоредно уставно право, Београд, 2015.
23. Пешова, Денис, ,, Уставниот Суд изгубен во суските реформи “ , Фондација Конрад Аденауер во Република Македонија Институт за демократија ,, Социетас Цивилис”- Скопје, 2018.
24. Шкариќ, Светомир и Давкова-Сиљановска, Гордана, Уставно право (Второ дополнително и изменето издание), Скопје, 2009.

II. BURIME JURIDIKE

25. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991
26. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008
27. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998
28. Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, 1992, e plotësuar ndryshuar më 03.10.2019
29. Rregullorja për organizimin e brendshëm të shërbimit profesional të Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, dhjetor 2012
30. Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, NR 03/L-121
31. Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, NR 01/2008
32. Ligji për organizimi dhe funksionim të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, 10.02.2000
33. Rregullorja procedurale mbi gjykimin kushtetues të Republikës së Shqipërisë, 15.06.2009

III. BURIME NGA INTERNETI

34. Faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut <http://ustavensud.mk/>
35. Faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës <https://gjk-ks.org/>
36. Faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë <http://www.gjk.gov.al/>
37. <https://www.koha.net/veshtrime/216843/mbi-lojalitetin-kushtetues/>
38. <https://www.dw.com/sq/presidenti-sejdiu-jep-dor%C3%ABheqjen/a-6049627>
39. <https://www.evropaelire.org/a/2169631.html>

